


lavdie leka

(212)

novelë

BIBLIOTEKA
E
814-32
L 45
SHITIT
GJIROKASTËR



erdhi një vajzë

8P1. P83 - 32

S.

L45

LAVDIE LEKA

ERDHI NJË VAJZË

(Novelë)

~~53737~~ 1870

LIBRARI E SHKOLLËS
SHKOLLËS E SHKOLLËS

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Atë mbrëmje nuk po e njihja tim kushëri. S'më kish qëlluar asnjëherë ta shihja aq të preokupuar. Përkundrazi, sa herë takonte që bisedoja me të, ai ma priste shkurt:

— Ç'ke, moj, ç'ke? S'u çlirove një herë nga përkujdesitë e tepërta.

Dhe niste ndonjë muhabet tjetër që s'kish fare lidhje me bisedën tonë. Unë tundja kokën duke menduar se ai e merrte fare lehtë jetën.

— Kam dëshirë të të dëgjoj të flasësh një herë mbarë. — i thosha.

— E po njeriu s'do rrijë çdo çast serioz e me gjymtyrë të ngrira. Njeriu ka nevojë dhe të qeshë. Apo jo, kushërirë?

— Ja, — shtonte ai buzagaz, — ti a s'je dakord se po ju japim më tepër të drejta se sa ju takojnë juve grave dhe vajzave?

E dija që nuk e kish seriozisht, prandaj hesh-tja. Kurse ai përsëri vazhdonte e tregohej tepër mospërfillës për atë që thoshte.

Atëhere i kthehesha unë. I tregoja se nuk ishte në rregull. Po bëhej njëzet e shtatë vjeç e akoma s'po e mblidhte mendjen.

— Mos e ke fjalën për t'u martuar? — më pyeste, — mos më ke gjetur dhe ti ndonjë? — dhe qeshte. Vija dhe unë buzën në gaz.

E dija se sa herë do të vinte në Tiranë Sa-

miu, jo vetëm nënë Fatua, e ëma, por edhe tetot, hallat e kushërirat do t'i propozonin nga një nuse. Kisha vënë re me sa neveri dëgjonte ai. Isha një ditë aty, kur xhaxhesha i tha: «Të kam gjetur një! Veç ta shikosh!», kurse ai, i habitur, e pyeti:

— Ku? Në rrugë?

Unë qesha. Xhaxhesha u zemërua. Samiu më tha:

— Mos ke ndër mend dhe ti të më gjesh ndo-një?

Dhe e tha sikur t'i vinte keq për të gjitha këto «ndonjëra» që prisnin vetëm aprovimin e tij.

— Jo — iu përgjegja. — Ti ke aq mend sa mund ta gjesh vetë.

— Por kur s'kam ndër mend fare për t'u martuar?

S'ishte hera e parë që fliste kështu... Dhe shtonte se martesë ishte një marrëzi, sidomos për moshën e tij.

— Tashti që jam i ri, që kam një pasion, që kam mundësi të jap e të shkëlqej, përse të vë një barrë mbi vete? Për t'u ndalur nga kjo rrugë? — përsëriste.

Kurse unë i thosha se ai s'dinte ç'ishte familja, se kishte mendime të gabuara. E filloja t'i flisja për familjen e re socialiste.

Pikërisht në një ditë të tillë, kur, siç më thoshte, po «i shisja moral», ai, në vënd që të më përgjigjej, më pyeti:

— Kur fillojnë vajzat... dua të di në ç'moshë fillojnë të interesohen për veten... .

Nuk iu përgjigja, por ai më vështronte sikur priste vetëm fjalën time.

— Vërtet ke qejf ta dish? — i thashë duke u hequr se nuk e kisha kuptuar që po shtirej.

— E di si është puna? — foli ai po me atë seriozitet. — Si the dhe vetë... Duhet vendosur, apo jo?

Dhe, për të më nxehur, vazhdoi:

— Sepse ka rëndësi kjo, kushërirë. Se duhet zgjedhur një moshë, kur vajzat akoma s'kanë filluar të interesohen për veten. Ashtu janë, si të them, më naturale.

Heshti, pastaj qeshi me të madhe.

— Bukur e thashë, «naturele».

Unë përsëri tunda kokën.

— Se kur do të vesh mend as unë s'e di. Dhe si ja arrin të bësh ato racionalizimet e tua me këtë kokë që ke!

— Hë pra!

Kur e dëgjoje që fliste aq i qetë, duke thithur lehtë cigaren me filtër, të dukej se ishte njeriu më i kënaqur, më i lumtur në botë.

Atë mbrëmje tek e shihja të preokupuar, u hutova. Sikur s'ishte Samiu para meje. Në mes të bisedës ia nguli vështrimin tavolinës e u shqetësua, sepse aty mungonte një gotë.

— Ju thashë, — thirri, — do të vinë pesëmbëdhjetë vetë. — Mua më hypi gazi. S'e kisha parë asnjëherë aq nervoz.

— E punë e madhe, — i thashë: — Njëri le të rrijë pa pirë.

Por ai rrëmbeu gotën nga duart e mia, rregulloi pecetën te cepi i tavolinës dhe, sikur të më jepte urdhër më tha:

— Hë se s'të thirra kot, si të duket tavolina?

— Për bukuri! Po përse gjithë këto telashe? Ishit mbledhur në një lokal e mbaroi.

Sikur të mos e kish dëgjuar fare vërejtjen time, ai shkoi e sakaq u kthye me një vazo plot lule të freskëta.

— Për bukuri, thua! Dhe harrove më kryesoren, — murmuriti duke vënë lulet në tavolinë. Sa për lokalin që përmende, një herë tjetër do ta kemi parasysh. Sot do të mblidhemi këtu.

Dy ditë më parë në një mbledhje të madhe, në sallën e re të qytetit, brigadës së tyre i kishin dorëzuar flamurin e garave socialiste. Kishte ardhur një i deleguar nga Tirana, ishte bërë një mbledhje tamam si një miting. Ata të pesëmbëdhjetët e brigadës kishin kaluar çaste të mëdha gëzimi e emocioni. Ishin përqafuar me njeri-tjetrin dhe kur kish mbaruar mbledhja, tërë rrugës deri në kantier, ku edhe banonin, kishin bërë si fëmijët. Kishin kënduar këngët e dynjasë. Të gjitha këto m'i tregoi Samiu mbrëmë. Pastaj dikujt i kishte shkrepur që ditën e dielë të shkonin të shihnin ekspozitën e re që ishte hapur në Tiranë. Samiu, që deri atëhere kish heshtur, u kish thënë se pikërisht të djelën ai kishte ditëlindjen, ndaj i ftonte të gjithë në shtëpinë e tij në Tiranë. Aty ai kish nënën e një motër më të vogël.

Për një moment të gjithëve u ishte dukur e lehtë kjo bile njeri nga shokët, Bardhi, sikur ta kish pasur në majë të gjuhës, kishte propozuar gjithë listën e mezeve dhe të pijeve. Një vajzë ish kujtuar për buqetën me lule, kurse Esati, hamësi i brigadës, kish thirrur:

— Po bukën, more, bukën e harruat?

— Bukën, thotë. Po ju harruat më kryesoret,

— ishte hedhur njera nga vajzat, — e para, harruat se duhet rregulluar turni për të hënën, dhe, e dyta, maqina. Me se do të udhëtojmë, me këmbët e Janit?

Po bënë si bënë dhe të gjitha i rregulluan, dhe maqinën, dhe turnin. S'lanë asgjë nga mënyja e propozuar, dhe ajo që më çuditi më tepër, ishte se kishin gjetur edhe zëmbakë. E si i kishin gjetur? Dy ditë më parë ku s'kërkova dhe s'gjeta një degë për të uruar një shoqe për ditëlindje, kurse në tavolinën e rregulluar për mrekulli, ashtu si di vetëm teto Fatua, ata zëmbakë të bardhë ishin si një ëndërr e dëshëruar.

Ora po afronte shtatë. Samiun s'e mbante vendi. Për një çast më nevríkosi ajo ecë e jakë e tij, vërejtjet e sugjerimet që bënte.

— A s'bën mirë të dalësh pak? — i thashë. — Freskohu ca! Sikur është hera e parë që merremi me të tilla gjëra!

— Ahu, dhe ti! — dhe përsëri se për çfarë filloj t'i ankohej s'ëmës.

Po mendoja se si mund të ndryshojë njeriu kështu për një kohë të shkurtër. Dhe s'mendoja kot. Po më habiste Samiu. Herahere më dukej se kisha njeri tjetër pranë.

— Më duket se po vijnë! — thirri ai duke hyrë nga ballkoni. — Hiqni këpucët nga korridori.

Buzëqesha. Ky Samiu sikur ish mbytur nga preokupimet. Ç'të kish ndodhur vallë? Më lindi një farë dyshimi që pak nga pak po më forcohej, e m'u duk se çdo gjë ishte e kuartë aty nga ora shtatë e gjysëm, kur në tavolinë mungonin vetëm tre veta. Të tjerët kishin zënë vend pranë pjatave, që të hapnin oreksin. Vetëm Samiu rrinte në këmbë dhe

buzëqeshte, kur shokët e thërrisnin të ulej. Unë i bëra me shenjë dhe i thashë t'u mbushte gotat.

— Dale, të presim dhe ca. Ne jemi kompaktë — tha ai si pa të keq.

Por ai më bullafiqi që kishte zënë vend në krye, kërkoi të pinte.

— Ata që vonohen, të pinë më pak. Si dënim! — tha.

— Po vijnë, — lajmërova unë. — Dëgjohet zhurmë në shkallë.

Samiu në çast u gjend te dera. Sytë i shkëlqenin.

— Është Niku me Lumen, — tha me përtesë, — i njoha nga të qeshurit. — Dhe s'gaboi.

— Po ajo? — thirri bullafiqi.

Ai sikur të mos e kish dëgjuar këtë pyetje, shkoi në kuzhinë.

— A erdhën të gjithë? — e pyeta. — Është mirë të filloni.

— Besoj se erdhën, — tha dhe hodhi në sobë bishtin e cigares. Doli dhe një herë në ballkon e pastaj zuri vend andej nga fundi i tavolinës.

— Çfarë thotë Esati? — pyeti.

— Se emancipimi ua ka mbledhur burrave. E ç'të mbledhur se!

— He, se keni avokate të fortë këtu — u tha Samiu tri vajzave, që prisnin të heshtura. — Si-domos për emancipimin — shtoi, e vështroi nga unë. Në çast trokitën në derë. Trokitën lehtë dhe vetëm një herë.

— Erdhi, — thashë unë.

— Erdhi! — thirrën të gjithë.

— Patjetër do të vinte — tha Jani.

Samiu u ngrit sikur ta kish shtyrë njeri nga

vendi. Unë zgjata dorën, ngrita pirunin që rrëzoi dhe dola pas tij.

Një vajzë e gjatë po hiqte trikon në korridor. Flokët i kish të zeze e të lëshuar mbi shpinë. Korridori u mbush me aromën «sekret i dashurisë».

— Thashë se s'do të vije! — dëgjova Samiun të fliste ngadalë.

— E si do të ndahesha nga shokët! — Ajo buzëqeshi, pastaj m'u drejtua mua e më përshëndeti.

Nga dhoma po ngrinin dolli për të. E quanin Diana. Unë ja qepa sytë e vrisja mendjen të gjeja se ku e kisha parë atë fytyrë aq tërheqëse, ata sy me bisht, që nxinin e shkëlqenin. Dukej e shkathët, por edhe tepër serioze për moshën që kishte. I lëshuan vend në krye, por ajo s'pranoi e u ul përballë meje. Pranë saj tërhoqi karrigën Samiu.

— Ngatërrova shtëpinë — tha. — Po ju të kishit filluar.

— E ç'të filluar sel! — ja priti Esati. — Ja, t'u shkrep edhe s'erdhe, apo s'të shkrepet ty, ndo-njëherë!

Qeshi dhe Samiu me të tjerë. Në dorë mbante cigaren e ndezur. Dukej tepër i gëzuar. Unë ja ngula sytë, por ai mbase kish harruar fare që ndodhesha aty. Diç i tha Dianës ngadalë, dhe ajo buzëqeshi.

Sepse, papritur, ajo vajzë me sytë si xhixhë, me të qeshurit e saj të përmbajtur më ngjalli një kureshtje të madhe.

— Se ku ju kam parë — i thashë.

Ajo buzëqeshi në atë mënyrën e saj e tha me një zë të këndshëm.

— Kurse unë ju mbaj mend. Kanë kaluar vi-

te, që atëhere. Punoja në uzinën gjeologjike në Tiranë. Ju erdhët tek ne për të shkruar. Ishim fare pak shoqe... A ju kujtohet?

Por s'më la ai që rrinte në krahë të bullafiqit të ndillja kujtimet.

— Ç'temë interesante për të shkruar — thirrri. — Dhe unë që s'jam gazetar do ta kisha qarë fare!.. Vitet kalojnë, njerëzit rriten. Diana u shkëput nga puna, vazhdoi shkollën, doli teknike e mesme, punoi disa kohë në prodhim dhe kërkoi vullnetarisht të punonte në një nga frontet e vështira në kantierin tonë! Bukur, apo jo? Po ne këtë t'i kishim thënë shokut tonë, korrespondent të radios, atë ditë, more! — përfundoi ai.

Të gjithë qeshën. Qeshi dhe Samiu e shikoi nga ajo. Unë i tunda kokën kur ndesha në vështrimin e tij të lumtur.

Pak më vonë në kuzhinë ai më pyeti.

— Hë?... A depërtove thellë në shpirtrat njerëzorë? Unë e dashuroj atë. Po ajo vallë?

Nga dhoma erdhi melodia e një kënge popullore për partinë. Këndonte një burrë, një vajzë ja mbante. Dikush i binte fizarmonikës.

Vonë natën, kur të gjithë u shpërndanë, e pyeta Samiun:

— E pse këceve vetëm një herë më të — dhe qesha kur pashë si u ngrysën vetullat e tij.

— Ç'ke? — më tha.

— Më pëlqen.

— Çfarë të pëlqen?

— Si të të them!.. Kjo e gjitha... Vështrimi yt... Diana. Duhet të jetë e fortë. Apo jo?..

Ai s'm'u përgjegj menjëherë. Shtypi me nervozizëm cigaren mbi paqetën e duhanit e tha:

— Sidoqoftë, as ajo nuk ishte e qetë. Dukej qartë që nuk ishte...

Heshti për një çast, pastaj vazhdoi:

— Dhe nesër kështu do ta heq veten. Por unë e di që ajo nuk është e qetë... Po... Po... Kështu u tregua dhe atëhere...

Dhe ai nisi të tregonte; mua m'u duk sikur po kujtonte një ëndërr që e kish parë e i ishte dukur shumë e bukur. Sytë i shkëlqenin.

Kur heshti, iu luta të më tregonte akoma, të futej në hollësira. Më tha se kjo ishte një histori e gjatë, se ishte e lidhur me jetën e punën e të gjithë atyre të pesëmbëdhjetëve e se fillonte në ditët e dhjetorit, kur ai kishte ardhur në Tiranë për të dhënë provimet, kur në kantierin e tyre kishin filluar të vinin vullnetarët e parë nga rrethet më të largëta.

KAPITULLI I

Mensa përherë në orën tre ishte plot. Sa hyje te dera e saj, të godiste një valë e ngrohtë e të dukej se një murmuritje e çuditshme, e pakuptueshme, ku përziheshin biseda të çiltra, të qeshura punëtorësh e shakara të rastit, priste të dilte nga dera.

Sidomos ditën e rrogave ishte vështirë të gjeje vend bosh, se punëtorët qerasnin njëri-tjetrin, pa ja shtronin me birrë e verë dhe muhabeti shkonte që ç'ke me të.

— Ç'milet jemi ne! Sikur lekët s'janë përditë në xhepin tonë. Do t'ja shtrojmë që do t'ja shtrojmë si duhet dy herë në muaj, — u thosh Jani shokëve të tavolinës. Askush nuk iu përgjigj. Esati e Bardhi tërë vemendjen e kishin përqëndruar te mënyja, Niku i thërriste kamarjerit. Kur ky erdhi dhe me keqardhje lajmëroi se birrat ishin mbaruar, Jani u rruadh i tëri në fytyrë, shau nëpër gojë shokët që kishin ecur si breshkat, pastaj çfryu kundër kamarierit që sakaq u ndodh në tavolinën pranë.

Në atë kohë Bardhi e nduku nga krahu dhe i bëri me shënjë të vështronte nga dera, ku sapo kishin

hyrë një grup të rinjsh të shoqëruar nga Gimi, sekretari i rinisë.

— Ndonjë delegacion punëtorësh, — tha Bardhi.

Jani ia nguli sytë një djali zeshkan, me flokët kaçurrela që i jepnin tamam pamjen e një cigani, pastaj vështrimi erdh e iu përqëndrua te një vajzë e gjatë, me kominoshe jeshile, me një trup të lidhur.

— Ç'të jenë? — pyeti Bardhi.

Por Jani s'e dëgjoi.

— Shih, shih, — tha ngadalë e buzëqeshi. E harroi zemërimin. Sytë ia nguli përsëri kamarierit, Nexhipit, që duke buzëqeshur e duke tundur kokën, po bisedonte me Gimin e me të rinjtë. Pas pak kamarieri duke hedhur pecetën mbi supe, çau përmes tavolinave.

— Nexhip, o Nexhip! — i thërrisnin nga të gjitha anët, por ai pa u shqetësuar fare, u kthehej klientëve e u thosh të prisnin; nuk e shihnin? Kishin ardhur mysafirë! Punëtorët që e pyesnin ç'ishin këta mysafirë ai i dëgjonte me një habi të tillë sikur ata të ishin prapa botës që s'dinin lajmin më të rëndësishëm të ditës. Pastaj duke u drejtuar nga ata që kishin mbaruar së ngrëni, u thosh të shpejtonin se vullnetarët s'duhej t'i linin te dera.

— Vullnetarë? Si the, Nexhip?

— Po vullnetarë.

Ai shkundëte ngadalë mbulesat e bardha të tavolinave, e vazhdonte të fliste:

— E si s'e ditkeni? Kërkon uzina fuqi punëto-re? Kërkon. Kështu që do të vinë dhe vullnetarë.

Jani ndiqte çdo lëvizje të tij e ish gati t'ja plaste gazit.

— Shikoje! Shikoje, — i thosh Bardhit, që ia

kish mbërthyer sytë vajzës me flokë të lidhura bishtalec.

— Po ajo? — pyeti Bardhi.

— Edhe ajo! — tha Jani tërë gaz.

— Si edhe ajo?

Të katër djemtë e vajza, që ishte me ta, zunë vend në tavolinën përballë Bardhit e Janit. Jani e harroi fare birrën. Filloi të hajë me oreks makaronat me kimë e me zë të ulët i tha Bardhit se vajza dukej simpatike.

Pastaj pa pritur ia plasi të qeshurit. Vështronte tavolinë më tavolinë e s'mund të përmbante gazin.

— Sikur të mos u vinte zor, besa të gjithë do ta intervistonin këtë vajzë. Shikoni, shikoni Nurçen si e vështro! Ja dhe ai tjetri, ja edhe në këtë tavolinë, sikur ua lexoj mendimet njerëzve. Duket se thonë: «Ç'do kjo vajzë?» «Ç'është kjo vajzë?!...» «E ç'di të bëjë ajo?»

— Ti je gjeni, Jani! Dhe gjenitë nuk flasin kurrë kot, — i tha Bardhi.

Por Jani s'arriti t'i përgjigjej. Dikush u zgjat nga tavolina pranë, futi kokën midis tyre e pyeti me zë të ulët pikërisht për vajzën. Dhe tha: «Në administratë do të punojë?»

Të gjithë sa ishin në tavolinë ja dhanë gazit, por heshtën menjëherë. Vajza me kominoshe jeshile kish hedhur sytë e trembur nga ata. Pastaj diçka i kish thënë Gimit.

— S'është mirë të qeshim — tha Esati, duke u përtypur. — Pastaj ç'ka për të qeshur?

Por vërejtja e Esatit vlejti për aq kohë sa duhej të haheshin kafshatat e fundit të bukës, sepse,

sa dolën jashtë, filluan sërish pyetjet, shakatë e diskutimet.

Jo vetëm në oborrin e Ndërtesave (kështu quhej vendi ku banonin punëtorët), por edhe në dhomat, hidhej fjala për vajzën me kominoshe jeshile dhe sy të zez, por pak të trembur.

— Po djemtë përse s'ju bëjnë përshtypje, — u tha Jani Nurçes e disa të tjerëve.

Dhe aty përpara çezmës disa thanë se «djemtë si djemtë, zanatin do ta merrnin shpejt. Po ajo? Përse të vinte kaq larg? Të ish puna se do të bënte një mrekulli, po mirë. Po ajo ç'di të bëjë?»

Pati nga ata që i kundërshtonin këto mendime, i quajtën të prapambetura, pati dhe asish që hidhnin nga një fjalë sa për të ndezur diskutimin e pastaj rrinin e dëgjonin plot kënaqësi. Pikërisht këtë rol filloi të luante edhe Bardhi. S'i thosh më kot Jani atij: «Ti s'di punë tjetër veçse të ndezësh urët.» Këtë herë ai ish ulur në krevat e vështronte herë Janin, herë Nikun, që flisnin tamam sikur ziheshin. Hekurani ishte shtrirë e mund të kujtoje se s'do të trazohej fare në atë muhabet. Krevati i Samiut ishte ashtu siç e kish lënë ai dhjetë ditë më parë kur kish shkuar për të dhënë provime.

Janit i shkëlqenin sytë e vegjël jeshilë, vetullat e zeza e të holla, si të një vajze, i ishin bashkuar nga inati.

— Eh, vëlla! — i thosh ai Nikut. — Ti s'je fare i qartë. Bile ky është gabim i rëndë. Sipas teje, socializmin do ta ndërtojnë njerëz të jashtëzakonshëm?

— Ajo le ta ndërtojë aty ku mundet, kurse këtu, njerëzit duhet t'ja thonë.

— Gabim, gabim — përsëriste Jani. — Kushdo mund të vijë këtu. Dhe po s'diti gjithçka sot, do të mësojë, do të dijë nesër. Ne kemi nevojë për fuqi punëtore. Pastaj, pse jep çmim për të pa ja parë punën?

Niku seç murmuriti e qeshi me të madhe. kurse Janit nga inati iu muar goja.

— Ti je anadollak — thirri ai.

— Mirë thotë, anadollak... — tha Bardhi nëpër buzë. Por Nikut aq i bëri se ç'tha Jani e ç'përsëriti Bardhi. Nisi të fliste përsëri, këtë radhë më me pasion, më i prerë në atë që thosh.

— Sidoqoftë — thosh ai — unë.. si të them, mua s'më pëlqen që vajza të lërë shtëpinë e të syrgjynoset, kurse ti, me sa duket, je tjetër tip. Ty ky akt të frymëzon! Kështu, shoku Jani?

Jani vuri veglat e rrojes mbi parmakun e dritares e nisi të fërshëllente.

— Jani ka të drejtë — tha përsëri Bardhi, duke i buzëqeshur Nikut, — s'është gjë e vogël. Një vajzë ka kërkuar vetë dhe ka ardhur në uzinën tonë. Ka udhëtuar. Sa orë, Jani, ka udhëtuar? Sa kilometra mban Tirana?

Niku ja dha gazit. Këtë herë qeshi dhe Hekurani ndërsa Jani shkumëzoi furçen, e kaloi mbi faqe dhe s'u përgjegj.

—Ka mbaruar teknikumin, — tha Bardhi.

— Qoftë shëndoshë me gjithë të — ja priti me përtim Hekurani.

— E... e di pse flet kështu. Sidoqoftë mua ky fakt i sotshëm më bën përshtypje.

Jani vështroi shokët.

— Ja që më bën. Kisha dëgjuar e kisha le-

xuar se mjaft vajza delnin vullnetare, venin e shkonin sa nga një vend në tjetrin, kurse tashti e pashë vetë me sytë e mi. Ajo kërkoi dhe erdhi në qytetin tonë. Ja kjo më pëlqen, kurse juve s'ju bën përshtypje. Varet nga njeriu.

Ai i shkoi dhe një herë shkumë fytyrës dhe ashtu me briskun në dorë u kthye nga Niku.

— Akoma zgërdhihesh? Ç'pësove?

— Më mallëngjeve, Jani? Po më bie të fikët. Po emrin a ja mësove?

Jani s'ju përgjegj fare.

— Brixhida, — thirri Hekurani.

— Esmeralda — pasoi Niku.

Bardhi qeshte. I la dhe ca kohë ata të dy të thoshin sa e sa emra, pastaj tha prerë:

— Gaboni, shokë. E quajnë Diana.

Kaq u desh. Niku tha se do të shkruante një vjershë për perëndeshën e pyjeve, për Janin e entuziazmuar, për kominoshet jeshile. Pastaj diç i tha Hekuranit në vesh e që të dy i a krisën të qeshurit. Jani kish shpëlarë fytyrën, kish marrë gazetën e ishte shtrirë në krevat, mbi batanie. Po nuk lexonte. Iu duk sikur sytë e zinj të vajzës së panjohur u trembën sërish. Në çdo fjalë të Nikut ato errësoheshin më tepër. Dhe kominoshet sikur s'kishin ngjyrë. Në fytyrë dalloheshin vetëm sytë. Sytë që errësoheshin. Donte t'i thosh Nikut se ishte prapaniku më i madh i shekullit, por heshti. Më mirë t'i jepte fund bisedës.

— S'ke ç'i bën. Ka dobësi, dobësi për vajzat. Këtu është e gjitha. Ndaj dhe entuziazmohet kaq shpejt, — dëgjoi Hekuranin tek fliste. Dhe s'e përmbajti veten.

LIBRI I SHKURIT
MIRANDA

~~53737~~ 1870

— Kurse ju? — Jani qeshi. — E hiqni veten sikur s'ju bën përshtypje... Ju njoh mirë, ju njoh, shtiruni dhe ca... Mor, po të gjithëve mendja aty ju ka mbetur. Ndryshe s'do ta mbanit në gojë.

Ai qeshi si triumfator.

Por shokët, siç duket, e kishin oreksin të madh dhe gjumë pa tjetër s'kishin, se nuk e lanë fare rehat Janin.

Diana ishte ulur mbi valixhe, pranë derës së klubit. Megjithëse trikon e leshtë ngjyrë arre e kish mbërthyer deri te gryka, përsëri kishte ftohtë. Frynte erë e ftohtë dhe qielli dukej i akullt, i huaj. Ajo kish ngrysur vetullat e vështronte në atë drejtim, nga kishte shkuar sekretari i rinisë. Në një moment iu duk vetja e vetme, fare e vetme, në një vend të huaj, mes njerëzish të panjohur. Vështroi e frikësuar katër shokët, që qëndronin pranë e psherëtiu. Shoqëruesi i ishte dukur djalë shumë i mirë, por dhe pse ishte ai i mirë, diçka sikur nuk po shkonte ashtu si duhej. Ju bë e padurueshme kjo pritje. As që e kish menduar se do të rrinte kështu mbi valixhe. Dhe kodra përballë, vende-vende e çveshur, ju duk si diçka e zbehtë, e ftohtë. Ngriti jakën e trikos e uli vështrimin tek tri shkallët e vetme që të çonin në verandën e klubit, pastaj tek rrëpira që zbriste drejt e te lumi. Dhe sepse i erdhi mirë që dy puntorë flisnin me zë aq të lartë e qeshnin me gjithë shpirt.

«Jam e lodhur, prandaj... — donte të qetëson-te veten. — Pa tjetër që jam e lodhur. E ç'ka për t'u

shqetësuar? Shoqëronjësi ishte djalë i mirë. Ç'ka për t'u shqetësuar?»

Kur babai te salloni i trenit i kishte thënë se uzina kish pak vajza, po ato ishin vajza të mira e ajo duhej të miqësohej me to. Diana sepse e kishte ndjerë veten në mes të tyre, tek ecte, tërë gaz që nga stacioni deri te banesa. Po në të vërtetë gjithçka kishte ndodhur fare natyrshëm.

Ata të pestë kishin zbritur nga autobuzi që kishin marrë në stacion. Sekretari i rinisë së uzinës, që dukej tepër i gëzuar, u kish dhënë dorën, pastaj i kish ftuar të hipnin në një xhips. Rugës u kish treguar uzinën, veprat e tjera që po ndërtoheshin, e kur kishin qëndruar para administratës, u kish thënë: «Ja edhe punëtorët e turnit të parë e kanë mbaruar punën.» Diana kishte parë orën. Ajo shënonte 2.30. Kishin qëndruar buzë rrugës. Ndoshta sekretari i rinisë priste dikë. Njerëzit kalonin pranë tërë zhurmë. Atyre që u bënëin përshtypje valixhet e tyre, kthenin kokën. Kish dhe të tjerë që s'i vinin re fare. Pastaj ata të pestë kishin lënë teshat në klub e ishin nisur për në menci.

«Shumë mirë, — kish menduar Diana. — Janë praktikë, e përse duhen formalitetet? Sa njerëz mund të vijnë në uzinë! Dhe për këtë duhet vënë një shpallje?»

— Mos na harruan? — pyeti njëri nga të rinjtë.

Por askush s'arriti të përgjigjej. U duk shoqëronjësi me dy vajza, që mbanin në duar batanie e çarçafë, dy vajza të qeshura plot fjalë. Njera prej tyre i rrëmbeu valixhen Dianës duke folur me

zë të lartë. Diana as që e kupoi si mbriti te dera ngjyrë bezhë me atë dorezë aq të bukur, veçse dëgjoji vajzën tjetër, një vajzë të hollë, me fytyrë tërheqëse, sikur ta kish pikturuar një dorë e talentuar, tek thosh se kjo ishte dhoma e tyre. Lexoi numrin pesë mbi një tabelë të shndritshme dhe ndjeu diçka të pakuptuar në kraharor. Këto vajza, kjo derë, çelësi që u rrotullua në të, krevati që qëndronte ende i parregulluar, e sollën në vete, i dëbuan përfytyrimet e saj të atyre ditëve të fundit, e shkëputën nga gjithçka që e rrethonte më parë dhe ajo me një farë drithërimi kuptoi se filloi dhe për të një jetë tjetër e re. Që të tria së bashku lëvizën krevatin që ishte në qoshen pranë dritares dhe që ishte i mbuluar vetëm me një baltanie, çpalosën çarçafët e nisën nga rregullimi. Njera nga vajzat, që i kish flokët të prera sipas modës së vjetër, por që kishte një fytyrë të çelur e gazmore filloi të qërtojë veten dhe shoqen tjetër Lumen që akoma s'po i jepnin sapunin e peshqirrin shoqes së tyre të re, e cila vinte nga rruga dhe duhej të pastrohej. Ishin hutuar fare.

Dianës iu duk se do ta kalonte më së miri në këtë ambient të pastër, të ngrohtë e komod. Kur u kthye nga banja, dhoma iu duk më e madhe dhe më me dritë. Ajo u ul mbi krevat, por s'dinte ç'të thosh.

Njera nga vajzat, Lumja, ishte e bukur; ajo një e dy e merrte pasqyrën dhe vështronte flokët. Ishte nga Pogradeci, por kish vjete që kish ardhur e jetonte me një tezen e saj në këtë qytet. Kur kish hyrë në punë në uzinë, për një muaj rresht ajo s'ishte larguar nga tezja, por uzina ishte 7 km. larg nga qyteti. Ish mërzhitur nga ajo ecë e hajde

e përditshme dhe vendosi të qëndrojë në «Ndërtesa».

Bukra, kështu e quanin vajzën tjetër, ishte nga ai qytet. Kish vetëm nënën e një vëlla të martuar. Vëllait i kish ardhur keq kur ajo kish vendosur të banonte në Ndërtesa, por s'kish arritur t'ia kthente dot mendjen. «Unë s'jam më e vogël — i kish thënë ajo vëllait. — Dua të mësohem me jetën». Dhe ai kish heshtur. E kish kuptuar se secili duhet të ecë me këmbët e veta dhe s'ja mori ters Bukrës. — Ka një vit kjo histori, qëkur u ngrit uzina — përfundoi Bukra.

Diana dëgjonte. Herë i bëhej vetja se ishte në ëndërr, se Bukra e Lumja as që ndodheshin afër saj, herë e kish më se të kjartë se ato që i qëndronin pranë ishin shoqet e saj të ardhshme. Me të do të ngryste kushedi sa ditë, do të kalonte një pjesë të jetës së saj. Kur u shtri për t'u çlodhur, ndjeu se i ishte larguar ajo zbrazëtirë që i qe shfaqur papritur. E kuptoi që ishte e gëzuar. Dhe i erdhi mirë që dikush qeshte me të madhe në oborr dhe që ngjitur me dhomën e tyre kishin hapur radion me zë të lartë.

KAPITULLI II

Drejtori i tha:

— Ti s'je dakord?

Ajo u skuq. Uli vështrimin mbi xhamin e zi të tavolinës e nuk u përgjegj me një herë. Jo se nuk donte të pranonte. Por ndruhej. «A do të mundej vallë?» Dhe përsëri iu çfaq e largët, e turbullt frika e së panjohurës. Ajo këtë herë iu bë si një pellg i madh, si një mal i lartë, pastaj mori formën e një rrethi që zgjerohej e zgjerohej. E panjohura s'kishte fund. Ajo fshihej dhe tek ata punëtorët që i kish parë dje në mensë, dhe te dritaret e mëdha nga delnin me bujë tërë ato zhurma metalike dhe te dhoma e saj komode, te shtyllat e larta, dhe tek vetë ajo, te Diana... «A do të mundem vallë?»

Ngriti sytë nga drejtori dhe i tha se në oficinën ku punonte më parë, kish kryer vetëm punën e tornitores. Por menjëherë heshti si fajtorë. Drejtori i kish thënë se kishin nevojë për njerëz, se deri atëhere atë detyrë e kryente një punëtor

i kategorisë së shtatë, i zoti, por që s'i mbushej mendja të vazhdonte shkollën. A e vllente ta zgjaste më këtë punë?

Hodhi pas krahëve bishtalecin e gjatë e sikur me këtë gjest të kish dëbuar gjithë plogështinë që e kish pushtuar, tha duke venë buzën në gaz:

— Do të mundohem.

Salla e repartit, ku do të punonte, iu duk tepër e madhe, e mbushur me torno, freza e maqineri të tjera. Në një qoshe ishte një maqinë prerëse e karshi saj axhusteria. Jo shumë larg ajo pa Bukrën që i buzëqeshte, pa dhe vajza të tjera. Ato kishin lidhur në kokë nga një shami të kaltër trekëndëshe. Dhe që të gjitha buzëqeshnin.

Një tornitore aty pranë i tërhoqi vemendjen me detalin që po pregatiste. Ai detal i zgjoi një ndjenjë të këndshme dhe ajo iu afrua më tepër tornos. Shkëndijat i fluturonin para syve, ashkëlat e imta përdridheshin, ngatërroheshin e binin pa zhurmë. Ajo i tregoi inxhinierit se para katër vjetëve kish punuar në një torno të tillë dhe se shpesh i kish takuar të pregatiste këta detaje.

— Ta provoj dhe unë, -- i tha tornitores.

Vajza ia la vendin. Dhe përsëri zhurma shurdhonyëse, xixat që fluturonin, dhe metali që rrotullohej, sikur të lozte me vështrimin e saj. Ajo ish përqëndruar e tëra në atë metal, në atë rrotullim. Kur mori detalin në dorë, vuri re se ishin afruar tre-katër punëtorë.

— Është teknikja e repartit — e prezantoi inxhinieri. Ajo as vetë nuk e kuptoi përse mblodhi supet, përse ndjeu të skuqej në fytyrë. Punëtorët ia ngulnin sytë me kërshëri e s'dinte ç'ti thoshin.

Më së fundi dikush e theu heshtjen, e pyeti Dianën ku kish punuar më parë. Ajo akoma s'ish çliruar nga ndroja e befasishme që e kish kapur e filloi të përgjigjej, sikur të ishte fajtorë për diçka. Por vështrimet që ata i hidhnin njeri-tjetrit, e sollën në vehte dhe ajo e kuptoi se nuk po vepronte mirë. Filloi të tregojë me ton më të qetë, më me siguri, për oficinën ku kish punuar, për prodhimet e fundit që kishin nxjerrë, pastaj iu drejtua inxhinierit, e pyeti se ç'duhej të bënte ajo. E pas kësaj kaloi së bashku me të nga maqina në maqinë, preku metalin me dorë, diku qëndroi gjatë, sepse duhej montuar diçka, diku u mahnit nga puna e përsosur e ndonjë tornitori. Në këto momente e ndjeu veten sikur të ishte në oficinën e saj.

Megjithatë, kur mbaroi puna, ajo s'e provoi tërësisht atë gëzim që e pushtonte sa herë që bashkë me shokë e shoqe delnin nga dera e oficinës plot fjalë e shakara, plot plane për ditën e nesërme. Fliste me Bukrën, por me mendje donte të hynte brënda në thellësi të shpirtit të saj e të gjente çfarë e shqetësonte; i vinte çudi që Bukra ish aq e çlirët në muhabet, aq gazmore. Mendimet e Dianës mbrinin deri në një pikë e ndaleshin.

Kur u shtri në shtrat ora kish kaluar nga njëmbëdhjeta. Ajo e ndjeu veten të lodhur e gjumi ia mbërtheu sytë. Ëndërra të çuditëshme e zgjuan disa herë me radhë, deri sa ja hoqën gjumin fare. Ajo shikonte errësirën përtej dritares, dëgjonte fërshëllimën e erës, kërcitjen e mërzitshme të një kanati aty pranë. Papritur ndjeu një dëshirë të marrë për të mbledhur plaçkat e për të ikur. Po e

dinte që me të gëdhirë dita, gjithshka do t'i dukej ndryshe.

Babai i kish thënë se s'duhej t'i merrte gjërat lehtë; se aty ku do të shkonte, do të ndeshej me vësh-tirësi, se jeta s'është shesh me lule e se ajo s'duhej të rëmbehej; përherë të maste forcat, të maste hapat., por mos të tërhiqej. E dëgjonte me ëndje babanë. Ashtu e kish dëgjuar gjithnjë. E dëgjonte, por dhe i thosh: «Ti, baba, sikur të step». Ai buzëqeshte... «Jo — i thoshte, — futu më thellë e do ta kuptosh. T'i them këto se s'dua të ndal vrullin tënd, që ti t'i kuptosh drejt çështjet e mos të çorientohesh».

Sikur të ishte dhe këtë herë babai! Ai ndosh-ta do t'i thosh se, dita e parë i kish kaluar tamam si në ofiçinën e Tiranës. Vërtet që s'e kishin thirrur e s'i kishin kërkuar shumë ndihmën, por a s'kishte kaluar ditë të tilla në punën e parë? Babai do t'i kishte thënë dhe ndonjë fjalë tjetër e ajo do të bindej se mërzinë e saj e sillte ndarja nga shokët e vjetër, një mall i pakuptuar, se kështu u ndodhte të gjithëve kur largoheshin. Por babai ishte njëqind e pesëdhjetë km. larg dhe ajo mundohet ta qetësonte veten me mendimin se e nesër-mja do t'i sillte atë që i kish munguar.

Kaluan dy tri ditë. Diana filloi të trembej seriozisht e për një moment të dyshonte se mos nuk ishte e aftë për detyrën që i kishin ngarkuar, mos aty kërkohej me tepër nga ç'dinte ajo. Kjo dukej haptaz nga qëndrimi që mbanin pesë a gjashtë punëtorë. Ata një e dy e shfrynin. Pa e nisur ajo punën, kërkonin që të mbarohej, e ngut-nin e i thoshin: «T'i thërrasim dhe Hekuranit?»

ose «Hekurani është mësuar me këto maqineri». Sidomos andej nga maqina metalprerëse s'donte t'i hidhte sytë. I dukej sikur punëtori akoma thërriste. «Ej, punojmë me norma, shoqe, na latë pa punë. O Hekuran!» Ajo akoma nuk e dinte cili që ky Hekuran, por e kuptoi se duhej të ishte pikërisht ai punëtori i kategorisë VII për të cilin i kish folur drejtori. «Çdo orë që kalonte sikur më tepër ja përmendte atë emër. Ai filloi t'i vriste veshin, t'i dukej antipatik, pastaj kërcënonjës. Pikërisht atëhere ajo u drejtua te Bukra dhe e pyeti kush ishte ai Hekuran, emrin e të cilit e dëgjonte orë e minutë. Bukra nuk ja shqiti sytë dhe pa se si nga balli i saj i lëmuar, te vetullat, në gjithë fytyrën e saj, rrëshqiste një hije shqetësimi.

Tregoi me sy në drejtim të Hekuranit, që kish ngrysur vetullat e me përtim mernte metalin.

Dianës iu duk se ai fshihte një zemërim të madh, se një det i tërë s'mund ta shuante atë zemërim. Dhe i erdhi keq.

— Më parë ai ka qenë në vendin tim? — pyeti sërish dhe donte që shoqja t'i përgjigjej sa më parë e të thoshte «Jo, e ke gabim.»

Bukra, që sakaq kish hyrë në shqetësimin e saj, tha:

— Po, pse pyet?

Diana buzëqeshi hidhur. Gëlltiti pështymën që i ish mbetur në grykë.

— Po e dëgjoj shpesh këtë emër. — Pastaj heshti një copë herë, heshti dhe Bukra që s'po gjente dot një fjalë. Dhe i vinte inat që kjo fjalë, e cila mund të dëbonte shqetësimin e papritur e të

çelte fytyrën e shoqes, s'po i vinte në gojë. Me vete i jepte të drejtë për këtë shqetësim. Në repart sikur endej një pëshpëritje sa herë dëgjohej fjala «shoqja teknike». Dikush edhe qeshte me ironi, edhe hidhte ndonjë thumb. Vërtet Bukra, Jani, Esati e mbi të gjithë Lamja ishin munduar ta stabilizonin gjendjen, por ku përmbahej Ademi me shokë! Sidoqoftë Bukra kishte besim se çdo gjë do të rregullohej, veçse Diana duhej ta tregonte veten. Ndaj asaj i vinte inat që s'po e gjente fjalën e duhur, atë fjalë që duhej të dëbonte dyshimet e shoqes.

Tërë pasditen nuk iu nda Dianës. E mori me vete në klub, në provat e korit, e s'pushonte së foluri, së treguari për shokët, për jetën e tyre. Diana dëgjonte e i pëlqente që pranë saj kish Bukrën e që kjo ishte shumë e qeshur dhe pa ndroje. Tek ecte përkrah shoqes në rrugën që gjarpëronte, mendoi:

«Fundja njerëzit kanë punuar për më tepër se një vit me Hekuranin. janë mësuar me të. Këtu s'ka asgjë për t'u çuditur. Edhe me mua do të mësohen».

Por të nesërmen përsëri iu duk se nuk ishte aq e lehtë të mësoheshin me të. Dhe u trishtua së tepërmi kur e kuptoi shkakun. Në fillim u inatos, pastaj e përmblodhi veten.

Ajo ishte vajzë! Të kish qenë djalë, ndoshta do të mësoheshin më lehtë, por ajo ishte vajzë!

Atë mëngjez që brigadieri i repartit të montimit nuk e përfilli fare, asaj desh iu ndal fryma. Ai përplasi në tokë disa detaje dhe kërkoi teknikun. Diana që mbriti në çast, e pyeti përse e kërkonte,

por brigadieri i hodhi një vështrim indiferent dhe u interesua të dinte se ku ishte inxhinieri. Vajza i tha se mund të merrej vesh me të. Inxhinieri ishte në mbledhje. Por brigadieri nuk e pa të nevojshme t'i përgjigjej. U kthye nga kish ardhur.

— Unë këtu s'rri kot, — i thirri Diana nga pas. — Prandaj mos pengoni punën. Dhe i erdhi çudi që ata sy indiferentë mundën të ndizen, të shkrepëtijnë, të zvogëlohen e përsëri të shkrepëtijnë. Ai rrëmbeu një detal, ia zgjati asaj, duke i thënë me një ton të ashpër se ishin njëzet copë të tilla që nuk montoheshin.

Dianën nuk e stepi mënyra se si fliste ai, as mospërfillja. I kërkoi dikujt skicat e as që i hodhi sytë nga brigadieri, që u mbështet pas një shtylle e nisi të bisedonte me një punëtor! Ajo nuk e bëri veten as kur ai me zë të lartë tha se po humbiste kohën kot, e se detajet duhet t'i shikonte inxhinieri. Mori kalibrin e u përqëndrua e tëra në metal. Por brigadieri ishte kokëfortë.

— Hekurani e di si është puna, — tha përsëri.

Punëtori nuk e la të vazhdonte, i tha se Hekurani punonte në torno, kurse në vendin e tij kish ardhur teknikja e re. Sesi tingëlloi zëri i tij, ndaj Diana ia nguli sytë dhe e ndjeu veten ngushtë. Atë çast ata i shkelën synë njeri tjetrit duke shprehur një farë habie.

— Mirë... S'është keq... Por për vajza... — bëzoi brigadieri nga që s'dinte ç'të thoshte. Buzëqeshi si fajtor e i bëri me shenjë punëtorit të largoj. Kurse Diana me ton serioz, i shpjegoi se filetimi nuk ishte bërë në rregull dhe duhej t'i

sillnin detajet për t'i filetuar sërish. E la aty brigadierin e shkoi pranë tornos që ishte duke rregulluar më parë. Fytyra i digjte, veshët i buçisnin.

«Vajzë... Vajzë!» Kjo na qenka.»

Tornua u ndez, metali u rrotullua, ajo vështronte ashklat, që dukeshin si ferra. Dhe iu bë Hekurani gjemb, ferrë, pastaj gardh, kurse brigadieri mur, mur i lartë e i fortë. Ashklat shtoheshin e gardhi rritej. Por erdhi një punëtor, vuri lopatën nën to e i hodhi në karrocë.

— Pengojnë kur grumbullohen — tha.

Diana e heshtur shkoi te Bukra dhe me një farë nervozizmi i tha se nuk mund të duronte më. Dhe, sikur të ishte shoqja fajtores përgjithshka, nisi të thoshte se s'kish ndodhur kurrë ta fyenin pa të drejtë, se ajo s'mund të lejonte që të talleshin me të, të qeshnin. Fliste e kthyer nga dritarja dhe mundahej të gëlltitëte lotët që ishin gati t'i binin. Por Bukra nuk i dha rëndësi nervozizmit të saj.

— Mund dhe të të fyejnë, por kjo s'do të thotë që ti të ngrysësh vetullat — e qërtoi Dianën kur mbrijtën në dhomën e tyre.

— Po ty si do të dukej. Të pyesësh tjetrin çfarë ka maqina e ai duke qeshur të të thotë... «i dhemb këmba»?

— Të isha unë, s'do ta bëja veten, do të vija buzën në gaz e do t'i thosha «qenke shakaxhi ti, shok».

Diana nuk foli. Shikonte spiralet e prizës elektrike që ishin bërë prush e mendonte: «Kësh-tu do ta ngushëlloja edhe unë atë po të isha në

vendin e saj.» Bukra lëshoi revistën që mbante në dorë, u mbështet më mirë te jastëku dhe pyeti papritur:

— Mos e kishe më lehtë në oficinën tënde?

Diana pohoi me kokë, tjetra ngriti supet e i tha se kishte mendimin që kudo në këto punëra teknike kështu, me mospërfillje, vështronin nga vajzat e gratë. Sa herë rrinte e vriste mendjen për të gjetur përse të ndodhte kështu, mbushej tërë inat me veten e saj e me gjithë vajzat, që akoma s'kishin mundur t'i përmbysnin mendimet konservatore..., kurse Diana thoshte se në Tiranë... Mundet!

— Gjatë teknikumit kreuva praktikën në atë oficinë — vazhdoi Diana. — Shokët më njohën mirë, ma panë punën e më pyetën vetë në doja të mbetesha aty. Pastaj kur ika... Ç'të të them... Ata u mërzitën shumë. Ne ja kalonim shumë mirë.

— Ditët e para kështu e kanë, — ja ktheu Bukra. — Dhe këtu shokët janë të mirë, sa të miqësoheni e çdo gjë do të jetë në rregull. — Dhe ajo i tregoi Dianës si i kishin pritur atë, Lumen e një shoqe tjetër, Rinën një vit e ca më parë.

— Por mua aq më bënte — vazhdonte të tregonte ajo. — Ndoshta natyra ime është e tillë që të mos pyes shumë se ç'thonë të tjerët, ndaj, kur talleshin ata, ua ktheja dhe unë me të tallur. Qeshnin ata, qeshja dhe unë. Kurse Lumja prekej shpejt. Një ditë ajo qau në sy të të gjithëve dhe mua më erdhi turp. «Mbërtheji lotët», e qortova me inat. Pastaj iu drejtova atij që e kish ngacmuar e i thashë të shikonte punën e tij dhe të mos i pengonte të tjerët. Djemtë, si duket, nuk

e prisnin këtë të folur, se më vështruan sikur më shihnin për herë të parë.

— Po, po — vazhdova unë — mos pengoni. — Sa për punë, atë që bëni ju do ta mësojmë edhe ne. — Më pëlqeu që pashë dhe vështrime miqësore në atë sallë. Lamja, ai që punon pranë Rinës, më shtrëngoi dorën. Lamja është anëtar i byrosë së partisë të uzinës. Ai më tha se s'duhej të zemërohesh me djemtë, sa ata ishin djem punëtorë, por ja që kishin parë vetëm burra pranë këtyre maqinerive. E quanin zanat të tyre e s'u besohej se mund ta kapnin femrat. Por do të bindeshin e do të heshtnin. Këtë e tha drejt Lamja. Puna e bind tjetrin.

Diana tundi kokën dhe e shikoi shoqen me admirim. Që ditën e parë asaj i ish mbushur mendja se Bukra gëzonte respektin e dashurinë e të gjithëve, se djemtë e dëshëronin shoqërinë e saj, ja dëgjonin fjalën, e përkrahnin dhe i besonin. Bukra kish ditur të zinte vendin që i takonte. Por si do të bënte ajo?

Hodhi vështrimin tej dritares e pa se gjethet e plepit të vogël përplaseshin njëra me tjetrën, si flamuj të vegjël që valaviten pa pushim.

— Si thua, a dalim? Shkojmë në qytet? — e pyeti Bukra, dhe Diana mendoj se do të ishte më mirë të dilte në ajër të pastër. Ndoshta aty dhe do të çlirohej nga ajo angushti, që e kishte pllakosur.

U vesh thjeshtë, me një xhakëtë lëkure treçerekshë, të dalë boje, me tegela e pulla bojëblu.

Te stacioni i autobuzit gjetën dhe mjaft punëtorë të tjerë, që prisnin të shkonin në qytet. Bukra tërë gaz u përshëndet me ta. Dikujt i prezantoi

shoqen, dikujt tjetër i hoqi vërejtjen sepse bënte sikur nuk shikonte.

Diana vështronte punëtorët, tabelën mbi shtyllë, rrugën e posaasfaltuar e për një moment iu duk vetja se po priste në stacionin e «Librit të Studentit» në Tiranën e re, pranë apartamentit të saj. Por Bukra foli me zë të lartë. Diana vështroi nga ajo dhe u bind se ishte me Bukrën, se fliste Bukra dhe thosh se do të binte shi. Edhe Dianës qielli iu duk pak i ulët dhe i vrenjtur. Megjithatë tha:

— Nuk besoj të bjerë shi. Kur fryn erë thonë se s'bie shi. Sa është e vërtetë, s'e kam vënë re.

Po Bukra, nisi t'i tregonte se era s'do të thoshte gjë, se në kantierin e tyre frynte erë çdo ditë, edhe kur binte shi, dhe kur ishte diell, edhe kur bënte ftohtë. Një vit më parë kish ardhur një i huaj për të parë uzinën. Atë ditë era të grinte. Ai mblidhte supet e thoshte: «Siç duket, këtu qenkan grumbulluar gjithë erërat e Shqipërisë.»

Dy djem erdhën e qëndruan pranë dy shoqëve, i pyetën se ku do të shkonin, dhe në se dëshëronin të venin së bashku në estradë.

Diana s'foli, por as Bukra nuk iu përgjegj menjëherë. — Këta janë shokët e mi më të ngushtë, — i tha ajo Dianës ngadalë. — Kështu që do të jenë dhe shokët e tu.

— Dhe e di? — vazhdoi Bukra. — Më mirë të t'i them të gjitha njëherësh. Ky Jani, që duket kaq i pafajshëm, është gati të zihet me këdo për të mbrojtur të tjerët.

— Në i mbron me të drejtë, është gjë shumë e mirë — tha Diana, duke vështruar nga Jani.

Ky buzëqeshi. Asaj iu kujtua se ai, sa herë e kish parë, i kishte buzëqeshur.

— Për të drejtën duhet të luftojë çdo njeri — tha ai. — Sepse ka njerëz që e shtrembërojnë. E përse ta shtrembërosh kur është e drejtë?

Jani i shkeli synë Bukrës dhe vështroi nga shoku i tij.

— Duhet të jesh i shtrembër që ta shtrembërosh, — tha shoku tjetër, Bardhi.

— Mirë që e ditke! — Jani u shtir sikur habitet. — S'kam thënë kot unë që ti je me orë. Si duket, sot të kanë kapur të mirat.

— S'dihet, akoma s'ka mbaruar dita, — foli Bardhi dhe vështroi tërë gaz nga Diana, që dëgjonte bisedën e djemve dhe mendonte se Bukra kish bërë shumë mirë që e shkëputi nga ambienti i mbyllur i dhomës.

— Ju ku do shkoni? — pyeti Jani përsëri.

Diana mblodhi supet, kurse Bukra tha se do të shëtiste me Dianën, do ta çonte dhe në shtëpinë e saj.

Djemtë përsëri u propozuan të shkonin së bashku në shfaqjen e estradës. Me ta do të vinin dhe Esati e Gimi. Por Bukra u tregua kokëfortë, dhe Diana s'po e kuptonte përse.

Kur autobuzi erdhi e ata zunë vend në ndënjësen e madhe pas shoferit, Bukra tha se në kinema mund të shkonte, ndërsa estrada s'i pëlqente, se do të shihte po ato numra që kishte parë herë tjetër.

Jani bëri sikur s'dëgjoi fare dhe Dianës sepse i erdhi mirë që dhe ai u tregua kapriçoz. Ndaj kur mbetën vetëm me Bukrën, ajo tha:

— Edhe ai, ama, mirë ta punoi!

Mendimi se në repart kishte shokë të mirë e ngrohu së tepërmi, ja zhduku hijen e rëndë që kish dashur ta errësonte.

Vonë, nga ora nëntë e mbrëmjes, u kthyen në «Ndërtesa». Përshtypje të reja kishte sjellë ajo ditë. Kur u shtri në krevat, Diana i solli ndër mend të gjitha këto, po pastaj mendimet sikur erdhën e u përqëndruan aty ku i dhimbe. Ajo deshi të shkëputej prej tyre, por sa kthehej në krahun tjetër, përsëri i dilte përpara Hekurani që kish zënë vend nga fundi i autobusit e s'i ngrinte sytë nga një gazetë që mbante në duar. Ademi sikur i thosh: eh, shoqja teknike...

Ajo lëvizi nga vendi. Donte të shkëputej prej tyre, por përsëri i doli Hekurani. Këtë radhë ai shfrynte, e tregonte me shenjë nga ajo e dukej i pakënaqur. Po Bukra i rrinte pranë e i thosh: «Mund edhe të të fyejnë, por kjo s'do të thotë që ti të ngryshesh vetullat», kurse Jani buzëqeshte: «Njeriu duhet të jetë i drejtë».

Ajo kthehet përsëri, por këtë radhë fliste baba, që e zë prej supesh e i thotë: «E kush fitoi që në hapin e parë, moj bijë?»

Sikur të ish kujtuar për diçka, Diana u ngrit me rrëmbim, këputi fletën e mesit nga një fletore dhe u ul pranë tavolinës, Pesë ditë që ishte ndarë prej prindërve dhe akoma s'u kish shkruar dy fjalë. Stilolapsi filloi të nxinte fletën e bardhë. Ajo mendohej e vazhdonte të shkruante përsëri. «A të kujtohet baba? Për dy ditë unë do të nisesha. Ti u ktheve nga mbledhja e organizatës. Në kuzhinën e ngrohtë ishin mbledhur farefisi. Të gjithë flisnin për mua. Unë i dëgjoja e buzëqeshja.

Dhe ti sa erdhe, ashtu siç e ke zakon, u ambiente menjëherë dhe flisje, qeshje, si gjithë të tjerët. Por unë që në vështrimin e parë e kuptova që diçka të kish ndodhur, diçka që ty të mërzhiste e të gëzonte njëkohësisht. A e mban mend? Kur ikën të gjithë, të pyeta: «U përleshe?» «Me kryeinxhinierin e disa të tjerë» më the. Mamaja tundti kokën. Ti vazhdoje: »... Kur njeriu vështron sedrën personale vështron që mos t'i çiket asnjë qime, ç'duhet bërë? Duhet luftuar bijë. Tekniku i repartit ka menduar një metodë të re për ngjyrosje, që është më e leverdishme, po kryeinxhinieri thotë se «nuk është e ngritur mbi baza shkencore» «e bën presion që tekniku të heqë dorë.» Ti heshte; unë të pyeta:

«Po pastaj? Tekniku fitoi?»

«E kush fitoi që në hapin e parë, moj bijë.»

Ashtu është, baba. Disa thonë: sa të hedhësh hapin e parë! Në të vërtetë është mjaft vështirë që të bësh hapat e tjera. E duhen njerëz si ti që të të lehtësojnë pak. S'di të them a ka në repartin tim të tillë. Po një djalë pothuaj se të ngjan ty. Thonë se dhe ai bëhet copë për të tjerët...»

Ajo e la stilolapsin mbi tavolinë. «Çfarë shkruaj kështu?» — mendoi. I lexoi dhe një herë rreshtat e hedhura nxitimthi dhe nuk u kënaq.

«Babai sa ta lexojë, do të vrapojë këtu e do të më shohë vëngër. Mamaja do t'i thotë: «S'të ngjau ty, jo» e do të psherëtitijë» — thoshte me vete!

E largoi fletën e shkruar, mori një tjetër. Stilolapsi nxiu rreshtat njërin pas tjetrit. Shkruajti se mendonte shpesh për ta, se repartit ku punonte ishte tepër i madh, se do ta kishte vështirë, por

«si thoni ju? A duhet zbrapsur nga vështirësitë? Kam një shoqe të mirë. Kam dhe të tjera, por Bukra është e veçantë. Dhe shokët duken të mirë, megjithqë unë ende s'i njoh të gjithë. Ditën e parë që erdha shikoja një plak me syze, që punonte pa u shkëputur nga tornoja. Mendoja «Kaq plak e të punojë? Vështroja një shoqe, Rinën, që punonte me tranxhën ende të pamekanizuar e s'e kuptoja përse e kishin lënë në atë proces. Që nga ofiçina e dija se ajo punë kërkon një farë force fizike. Dhe ja sot Bukra më tha se ai plaku, xha Ristua ishte pensionist. Por kur filloi punën re-parti mekanik, kish nevojë për fuqi punëtore. Atëhere xha Ristua kërkoi të punonte aq kohë sa të plotësohej kjo fuqi. Dhe punon me mish e me shpirt. U rri mbi kokë të rinjve, s'largohet pa u bindur se ata e kanë kuptuar atë që u ka shpjeguar. Rina, nga ana tjetër, sa herë që punëtori i tranxhës shkon në zbor, punon në atë proces. Tranxha s'mund të heshtë. Dhe punon mirë...»

Diana mbushi katër faqe plot, e kur i lexoi fjalët që kish hedhur në kartë, buzëqeshi. Prindët do t'i gëzonte kjo letër.

KAPITULLI III

Djemtë po bëheshin gati të shkonin në kinemanë e kantierit kur Samiu hapi derën. Tani që erdhi Samiu, s'kish rëndësi as kinemaja edhe pse biletat ishin prerë. I rrëmbyen atij plaçkat nga duart, e ulën, si me detyrim në krevat, e nisën ta pyesnin. Për çfarë s'e pyetën. Jani për bigën «Adem Reka», Bardhi për ndeshjet e fundit. Vetëm Hekurani kish zënë një vend te cepi i krevatit dhe heshte. Kur fjalën përsëri e mori Jani, Bardhi filloi të kontrollonte rrjetat e çantën.

— Salsiçe, more, s'na ke prurë? Po byrek s'na ka bërë nënë Fatua?

Samiu ua vuri përpara ç'kish dhe i porositi të linin dhe për Nikun e Esatin.

— More, a janë të ziera? — pyeti Bardhi duke përtypur një copë të madhe salsiçe.

— Hë se s'pëson gjë ti, edhe të paziera të jenë — i tha Jani.

Samiu i pyeti shokët për të rejat e uzinës, si e kishin kaluar kohën, ç'thuhej, ç'bëhej, u tha se e kish marrë malli.

Dhe ashtu siç ndodh përherë që njeriu kujton

më tepër ngjarjet e ditëve të fundit, i treguan se Niku ishte fejuar me Lumen dhe i kishte lënë të gjithë gojëhapur.

Bardhi priste që Samiu të ngrinte vetullat, të thosh «ju gënjeni», siç bëri dhe Jani kur e dëgjoi, por ai, pa u ngutur, tha se e dinte që do të fejohehin, mbasi Niku i kish thënë diçka.

Jani shtyu letrën me byrek e tërë inat shfryu kundër Nikut.

— I poshtri! Pa do ta shikojë! S'kam për t'ja harruar!

— Hiç mos i thuaj kur të fejoheh! — tha Bardhi plot seriozitet.

Samiu qeshi. Jani, si përgjegje hapi gojën e futi një copë të madhe byrek.

— Do të mbytesh derëzi! Na i hëngre të gjithë, — Bardhi ia mori letrën me byrek e ia vuri Hekuranit mbi komodinë. Por ky i shtyu. Samiu e vështroi me dyshim dhe i shkeli synë.

— Si shumë pasiv po tregohe, — i tha. — S'ka ndodhur ndonjëherë një gjë e tillë.

Hekurani as lëvizi, as foli. Por Bardhi, sikur të ish kujtuar për diçka, tha se Samiu s'dinte gjërat më të rëndësishme, s'dinte se në uzinë kishin ardhur vullnetarë, dhe në repartin e tyre kishin caktuar një vajzë.

— Dëgjon, apo jo? — u drejtua ai nga Samiu që as nuk pyeti, as nuk shfaqti më të voglin interes për vajzën e re të repartit.

— Na ka ardhur një vajzë, — përsëriti Jani. — E dëgjove?

— Shumë mirë ka bërë! Sa vajza mund të vijnë!

Samiu nxori këmishën nga valixha, e spërkati me ujë dhe e futi poshtë jastëkut, «për t'u avulluar», siç shprehej ai.

— Eu, po ajo erdhi nga Tirana, vullnetarisht!

— Bardhi shkeli synë e bëri me shenjë nga Jani.

Samiu në fillim nuk e kuptoi Bardhin. Por kur ai përsëriti «dëgjon, vullnetarisht», qeshi e tha:

— Romantizmi, ç't'i bësh romantizmit?

Jani po mendohej se sa indiferent hiqej ndonjë herë shoku i tij, por më në fund i tha mos vallë dhe ata i kish prurë në këtë kantier romantizmi. Vështrimi i Samiut plot tallje sikur i tha: «e pse e harxhon frymën kot, ore vëlla?»

— Ty d.m.th të ka sjellë pasioni? —

— Po, shoku Jani. Kurse atë... Një femër... Si thua Bardhi, a s'kam të drejtë?

— Po tjetër ç'kemi, pa vajzën lereni në punën e vet, — foli ai me ton serioz. Vuri hekurin në prizë, shtroi një batanie në tavolinë e u ul në krevatin e tij.

— Po dale se s'ti thamë të gjitha...

Bardhi tregoi me kokë nga Hekurani, që rrinte akoma i heshtur dhe i zymtë.

— Atë vajzën, që thua ti — plotësoi Jani, — e vunë në vend të tij. Po kjo të intereson?

Për një moment Samiu nuk deshi t'u besonte atyre që thosh Jani, po vështroi nga Hekurani dhe vetëm atëhere e kuptoi përse shoku i tij s'fliste fare, po heshte e rrinte i mënjanuar.

— Si e hoqën? — thirri. I vështroi shokët të gjithë me radhë dhe padashur sytë iu mbërthyen në fytyrën e qetë të Bardhit.

Askush nuk u përgjegj. Bardhi që e kish pri-

tur këtë shpërthim, shikonte vetëm Janin. Ky hapi radion.

Samiu, tepër nervoz, mbylli radion, e, sikur të ish në një telash të madh, u ul në krevat, tepër i zymtë.

— Ti e dije që një ditë Hekuranin do ta hiqnin — tha Jani si pa të keq. — Vetë ja ke thënë, dhe atij më duket s'i bëri fare përshtypje atëhere.

Samiu e vështroi Janin sikur ai të ish shkaktar i shpërthimit të tij.

— Do ta hiqnin, thotë... Për një vajzë do ta hiqnin? Pse s'e lanë vendin bosh? Fundja të ishte e kuartë për të gjithë që punët do të rëndojnë mbi mua.

Bardhi mblodhi supet.

— E pse do të rëndojnë mbi ty? — tha i pakënaqur Jani.

Samiu as që e dëgjonte.

— Fundja çdo gjë ka kufi. Dhe emancipimi ka kufi. Në përgjegjësi, në përgjegjësi, por në të mirën e punës! — thirri ai.

— Kush tha se kjo është në të keqen e punës? — pyeti Jani.

— Por unë s'pranoj — tha Samiu, sikur të kish gjetur zgjidhjen e problemit. — Le të më heqin dhe mua si shef reparti.

— E pse, më shumë se drejtori e të tjerë e shikon ti të mirën e punës? Tregohu më modest!

Bardhi ndiqte me sy Samiun, që shkonte e vinte sa nga dritarja te krevati e çuditej se si ai akoma s'po i vërsulej Janit e s'po i thoshte ta mbyllte atë gojë. Kurse Janit aq i bënte nëse i përgjigjej apo jo Samiu. Hekurani ishte larguar nga dritarja. Për herë të parë gjatë atyre dhjetë ditëve po

e ndjente veten më të qetë. Vërtet Meti, Ademi e ndonjë tjetër nuk i ishin ndarë, mundoheshin t'ja bënin qejfin por Samiu po e ngushllonte si duhej e po nxirrte në pah meritat e tij. Të tjerët sa i kishin thënë dy-tri fjalë e bashkë me to i kishin përmendur dhe shkollën. «Vetë e ke fajin» kishin shtuar ata. Kurse Samiu as që po ja zinte në gojë atë shkollë të shkretë.

— Unë s'e lë kështu këtë punë — thërriste Samiu.

— Hiç hekurin, se do të përvëlosh batanien — i tha Jani.

Hekurani u largua nga dritarja, u ul në karrigën pranë e, duke i nxjerrë fjalët me përtim, tha:

— E pse do ta lodhësh gojën kot? E para e punës ajo është vajzë! Vajzë, ore, dëgjon? Ç't'i themi emancipimit pastaj? E dyta: — ai thithi bishtin e cigares, — ajo është teknike me shkollë.

Samiu e dëgjoji pa interes, ndërsa me vete mori një vendim.

* * *

Të nesërmen, ndërsa bënin gjimnastikën e mëngjezit, Jani i shkeli synë dhe i tregoi vajzën me kominoshe jeshile.

— E shikon? Ja, ajo aty në mes është teknikja jonë.

Samiu u hoq se nuk e dallonte. Pikërisht në atë kohë Diana diçka i tha Bukrës e po vështronte në drejtim të tyre.

— Ty të buzëqeshi ashtu? — pyeti Samiu.

— Patjetër — u krekos Jani. — E shikon ç'është?

Samiu s'u përgjegj menjëherë, vuri buzën në gaz e i tha të lëvizte duart se do t'i dilte emri për keq.

Dhe me të vërtetë atë çast instruktori i fis-kulturës u tërhoqi vërejtjen të dyve. Samiu u bë menjëherë serioz, kurse Jani qeshi me shpirt:

— Sa m'u bë qejfi — tha nëpër dhëmbë. — Se deshe ta ndaje veten. Por s'i shpëtove këtë radhë syrit të mprehtë të tij. Shtrije, Sami, shtrije kra-hun! Më drejt!

Pastaj u shpërndanë. Vajzat kaluan të parat për në repart. Pas tyre, me hap të ngadaltë, po ecnin djemtë e burrat.

Samiu u shkëput nga shokët. Shkoi te drejtori. Dhe i erdhi të pëlciste kur i thanë se kishte vajtur në Tiranë për një mbledhje. U kthye tërë nerva në repart. Pranë axhusterisë pa vajzën me kominoshe jeshile që po i thosh diçka Janit, Bukrës dhe Gimit. Duke i përshëndetur ftohtë të gjithë, ai u drejtua nga Diana, dhe i kërkoi planin e punës.

— E keni grafikun? — e pyeti. — M'i dorëzo-ni mua.

Diana po e vështronte si e hutuar, sikur ta kishin zënë në befasi. Papritur sytë e trembur të saj u qetësuan. Në ta lodroi një nënqeshje. Ajo vu-ri buzën në gaz, e vështroi Samiun e me mospërfill-je tha:

— Prezantohemi njëherë, shoku... Cili është ky, mor Jani? Unë jam Diana Zeneli.

Dhe buzëqeshi përsëri.

Samiut i erdhi ligsht. S'e priste këtë përgje-gje. Ta zgjate apo mos ta zgjatte dorën? T'ja thosh-te emrin e tij? Ç'ishte kjo vajzë e gjatë me atë vë-shtrim aq hetonjës? Por s'e bëri veten.

— Gëzohem — tha qetë. — Po ju ç'më rrini? Filloni nga puna. Edhe ti — iu drejtua Janit, që kish vënë buzën në gaz dhe e vështronte sikur t'i ishte bërë qejfi.

Kur ra sinjali i mbarimit të turnit, Jani priti te dera e repartit sa të dilte Samiu. Përherë kërkonte të gjente diçka që ta ngacmonte. «Si s't'i ngrita unë, pikërisht personi im, si s't'i ngriti një herë nervat e tua të forta?» — i thosh sa herë. Dhe ja këtë radhë rasti kish ardhur vetiu.

— Oh, sot do të të qeras, Sami. — E mori për krahun dhe e ktheu në klub.

U ulën në një tavolinë, ku dukej se ish më ngrohtë, ndoshta nga që kish shumë tym në atë cep. Për një moment heshtën.

Sytë e Janit shkëlqenin kurse Samiu s'po e kuptonte përse krekosej ai. E pyeti ku ishte shkaku i gjithë atij qejfi që i kish ardhur. Jani e vështroi me habi. Buzëqeshi lehtë e foli me ton të qetë.

— Njerëz jemi — tha. — Gjithmonë ti të rrish kokëllart? Sidoqoftë, duhet ta pranosh, sot s'të eci mbarë. Edhe drejtori, që iku, ta punoi, edhe ajo ta punoi. Ha, ha, ha! Të thashë apo jo? E pe ç'ishte?

Samiu buzëqeshi.

— Një milingonë që të pickon pak, por që shtypet lehtë.

— Patjetër! S'të erdhi mirë, prandaj...

— S'e shikon? Për atë po e vras unë mëndjen.

— E po e di çfarë tha Diana për ty?

Samiu pa si iu tendosën cepat e buzëve Janit tek qeshi.

«E ç'mund të ketë thënë ajo? Po dhe të ketë thënë! Nuk e sheh?! Nuk do të më hahet buka fare!» — mendoj.

— Cila Dianë? — pyeti sikur, të mos e sillte ndër mend.

— Të njoh unë ty mirë. S'e ditke! Po ajo tha fare kjo emrin: Diana Zeneli. Dhe ne ta kemi përsëritur. Sa herë thua?

— Dhe?..

Jani ktheu gllënkën e fundit të birrës, mori pak mish e dy patate e, pasi filloi të përtypej, vazhdoi:

— Ja si tha. Dhe e di kur? Atëhere kur unë të shkela synë e ti ike nga salla.

«Domethënë,» tha ajo, ky qenka Sami Beluli, që fitoi vendin e dytë në konkursin e shpikjeve dhe të racionalizimeve?» Por ç'të them, Sami. Duhet të ishte aty e ta shikoje se si buzëqeshi. Pastaj shtoi:

«Qenka simpatik, por...»

Ajo e zgjati zërin, kurse ne i hapëm sytë.

«Po, si duket, kanë të drejtë njerëzit që flasin»
«Flasin? E ç'flasin?» pytëm ne tërë kureshtje.
«Thonë sikur është mendjemadh. Dhe sikur konkursi ja rriti këtë cilësi.»

Fjalën «cilësi» ajo e theksoi në një mënyrë të veçantë që ne ta kuptonim si duhej.

Jani u ngërdhesh.

«Thonë dhe diçka tjetër...» vazhdoi ajo.

Ne ja ndërpreme fjalën. Ti po vije në drejtimin tonë. «Po vjen» — i thamë asaj.

«Le të vijë. Është mirë ta dëgjojë ç'thuhet për të. Ju mund ta dini më mirë, por thonë që ai shet mend, sepse e mbajnë në pëllëmbë të dorës kur duhet e kur s'duhet.»

Jani heshti. Vështroi Samiun që thithte si pa të keq cigaren dhe buzëqeshi përsëri.

— Ja, këtë tha. Dhe tashti më thuaj a të pëlqen?

— As që të dëgjova se çfarë dërdëllise. Sa për atë milingonë s'do të rri e të vras mëndjen.

Ktheu gotën e birrës, futi në gojë copën e vetme të mishit që i kish mbetur në pjatë dhe u ngrit. Jani shpejtoi të paguante. E arriti Samiun në kohën kur ai shtyri me këmbë tërë inat një lëkurë portokalli që kishin hedhur në rrugë dhe e pyeti ç'e kish nevikosur.

Ai i mbërtheu sytë e turbullt e me një nënqeshje tallëse i tha:

— S'di se ku të shkoj. Në sport, në kinema, apo... — dhe i shkeli synë Janit. — Shiko sa shumë vende kam ku mund të shkoj. Kurse ty as sporti s'të pëlqen, as takimet. Vetëm një kinema të mбетet. E ç'djalë je ti, or vëlla?

Jani s'e vrau mendjen për t'iu përgjegjur. E vështronte Samiun si fitimtar e buzëqeshte. Ai me sa duket, kish filluar kundërsulmin. Sa mirë që u kish vajtur kjo vajzë me sy të zez dhe ja kish ngritur nervat Samiut!

—E ç'ke që m'i zbardh dhëmbët? Sa të bukurra që m'i ke!

— Mirupafshim, Sami. Po të më këtë zënë gjumi kur të kthehesh në shtëpi, do të të shoh në ëndërr. Patjetër do të të shoh.

Samiut gjithë atë ditë s'iu hoq nga mendtë vështrimi hetues i vajzës zeshkane. Dhe i erdhi më tepër inat që atë e kishin caktuar në repartin e tij. Deshi të ngushillonte veten duke thënë se vajzat aq mend kanë sa të flasin pa kuptim; e kush i vë re se ç'thonë! Por të nesërmen, kur ndeshi me

vështrimin e saj, ndjeu përsëri se u inatos. Ajo mbante një letër të madhe në dorë! I erdhi në zyrë e i tha se dëshironte të fliste me të, kish disa çështje të punës.

— Po të dëgjoj — u përgjegj ai, pa e vështruar, për të treguar se nuk u jepte rëndësi fjalëve të saj. Dhe ajo nuk e hapi gojën, i zgjati një fletë, ku kish hedhur ca shënime dhe ja vuri përpara, pranë fletores së tij. Ai e shikoi sikur donte ta pyeste se ç'ishte ajo letër.

— Lexojeni një herë, pa pastaj dhe bisedojmë — tha ajo prerë.

Samiu u hodhi një sy shënimeve të shkruara me stilolaps, pastaj i lexoi me vëmendje të madhe. Në një moment ngriti sytë dhe e shikoi si i trembur Dianën, që dukej tepër e qetë.

— E lexova. — Ai u tregua se s'i kishte kuptuar krejtësisht ato shkrime.

— Dhe ç'do të bëni tashti? — pyeti vajza.

— Detyra juaj është të më sinjalizoni e të më tregoni frutin e punës. Se ç'do të bëj, është puna ime.

Ajo s'u përgjegj menjëherë. I hodhi një sy zyrës së vogël të pasuvatuar mirë e nuk i pëlqeu asgjë në atë kthinë.

— Sidoqoftë, ju gaboni, shoku Sami. Ju mua as që më keni ngarkuar për të mbajtur një informacion të tillë. Është kështu? Dhe unë e bëra këtë punë se kam një mendim. — Ajo qeshi në një mënyrë sikur donte të thoshte «sa s'të kuptojnë njerëzit!» pastaj vazhdoi: — Në asnjë mënyrë nuk e bëra për t'ju informuar, ndryshe veja te drejtori. Po të doja veja, apo jo?

— Në rast se ju lind ndonjë mendim, mund të më thërrisni, — shtoi Diana.

Kur iku ajo, Samiu u hodhi edhe një vështrim shënimeve të saj. Ju duk se në ato shënime fshihej një farë ligësie. Dhe për çudi përbri emrit të Hekuranit ishte shënuar një shifër që të habiste. Ai mos ta kish plotësuar normën? Pa le Ademi? Dhe Metit dhe Lumes i kish shënuar mjaft orë të pashfrytëzuara. Kurse Dhorit skarcitete të shumta.

— Duhet të jetë ndonjë kjo — mendoi Samiu dhe vendosi të bisedonte me të, t'ja thoshte haptas se s'u besonte atyre zhgaravinave, se ajo patjetër kish gabuar. S'kish ndodhur asnjëherë një gjë e tillë? Punëtorët i kish të mirë.

Disa minuta para se të mbaronte turni, ai e thirri në zyrë. I tha mendimet e tija.

Ajo u mundua ta përmbajë veten e ta dëgjojë e qetë. Ndërsa ai s'pushonte së foluri për ata të repartit, ajo nuk mund të kuptonte përse ai ish treguar aq i cekët dhe mendoi se kishte ndonjë ligësi në këtë mes. Ç'do të bëhej sikur të gjithë në çdo veprim të njerëzve të mundoheshin të kërkonin vetëm anën e ligë. Kur Samiu mbaroi, asaj s'ju durua:

— Mbaruat? — e pyeti.

Po sytë s'ja shqiti për asnjë çast.

— Po.

— Një gjë dua ta keni të qartë, shoku Sami! Asnjëherë nuk mendoj për tjetrin «ç'interes ka ky person që veproi kështu», por shoh anën e mirë, e, pikërisht, sa na vlen ne, shoqërisë, punës, ky veprim. Kurse ju, me sa shoh unë...

Ajo tundi kokën, mori letrën mbi tavolinë e iku pa i lënë kohë atij të merrte vesh se ç'tha. Ho-

dhi një breshëri të tërë në dhomën e tij të vogël dhe iku përmes repartit.

Disa punëtorë e ndoqën me vështrim. Bukra e pyeti se ç'kish, por ajo doli nga dera e jashtme. Iu duk se Samiu e kish ofenduar rëndë. «Këta sho-kë emrat e të cilit i ke nënvizuar, janë ata që s'kanë pyetur për orar, kur ka qenë nevoja, që kanë punuar në çdo proces dhe që e kanë nxjerrë faqebardhë repartin në prak të Kongresit të Partisë... Nuk u besoj shënimeve të tua... Të presim të kthehet nga zbori edhe normisti».

Kish thënë edhe të tjera dhe kish folur fare pa takt.

Aty në repartin e vogël ku punohej kryesisht për ekspeditën gjeologjike të rrethit, me duart që i dridheshin nga inati, ajo s'ishte në gjendje të kontrollonte llampat e karbitit.

«Sidoqoftë kjo është e vërtetë — thosh me vete. — Ndoshta nga që mungonte Samiu, apo nga që s'kam unë takt, por fakti është që s'kanë punuar të gjithë si duhet. Unë thashë një të vërtetë».

— Por së vërtetës s'duhet t'i trembesh — i tha Bukra kur e mësoi çështjen. Pse zgjodhe këtë rrugë për të mbrojtur të vërtetën?

Dhe ajo në çdo minutë që kalonte, po e kuptonte se nuk kish vepruar si duhej. Ajo kish folur prapa kurrizit të shokëve dhe kjo s'e linte të qetë. Ajo s'duhej ta bënte këtë gabim. Përse të ngutej? Për t'i treguar Samiut se aq i bënte mospërfillja e tij, se dhe ajo nuk rrinte kot në atë vend? Përse të ngutej?

Atë i thosh dhe babai në letër. «M'u duke e shqetësuar bijë! Nga gjithë letra kuptohej se ishe e

shqetësuar... Duhet ta marrësh qetë çdo gjë, dëgjon? qetë... pa u ngutur e do ta kuptosh se njeriu është në gjendje të bëjë të pamundurën...» Kurse ajo ish ngutur, Bukra kish të drejtë që fliste ashtu. Së vërtetës duhet t'i dalësh ballëhapur. Jo për të mbrojtur sedrën tënde. Duhet lënë mënjanë sedra. Edhe një ditë më parë ajo kish folur sepse ish prekur. Kishte dashur të shpërblente mospërfilljen e tij e kish nxjerrë gjithë ato fjalë për Samiun. Kish thënë një të vërtetë, atë që pëshpëritej në rrethet teknike, por përsëri e kish thënë prapa krahëve. Bukra kish të drejtë. Së vërtetës s'duhet t'i trembesh.

* * *

Kur Samiu u afrua pranë punëtorëve aty te çesma pas repartit, Bardhi e pyeti përse ish revoltuar aq tepër Diana.

— Ti liro çesmën, atë bëj! — i tha Samiu. — Më jepni pak tallash. Jam nxirë fare sot, — dhe i kërkoi sapunin Nikut.

— Vërtet ç'pati ajo? — pyeti edhe Niku.

Samiu e vështroi sikur t'i thosh «po ty ç'të duhet?» Po Niku, s'e bëri veten. Sikur të ish kujtuar për diçka, filloi:

— Ti s'e di si ja punoi një ditë Hekurani asaj. — I tha këto fjalë e qeshi. Esati ja priti rëndë:

— E ç'ka për të qeshur? Trego më mirë si ja punoi ajo Hekuranit. Apo jo, djema? Po ti, Hekuran, si thua?

Hekurani, që ishte hequr si mënjanë, ja nguli sytë i inatosur. Por Esati, kur fillonte, zor të mbaronte.

— Ç'ke? Si të vjen? — i tha.

— Ashtu si të vjen ty.

— Mua? Për të qeshur.

— Bravo Esat, — tha Bardhi. — Dhe jotja. Hekuran është për të qeshur, si ja punove, po edhe ajo, ama! Numra, ç'të dëgjosh, Sami!

Lamja, që po shplante duart, qëndroi pranë Bardhit.

— Pa na i trego edhe një herë ato numrat. Të qeshim të gjithë, o Bardhi!

Por nga toni kuptohej se Lamja s'qeshte. Dhe nuk vështronte as Bardhin. Ja nguli sytë Hekuranit, që kish filluar të vrejtej e tha:

— Më vjen keq për ty. S'je djalë i keq, por ke sedër të sëmurë, dhe Niku e Bardhi bëjnë gabim që qeshin.

Samiu, që deri atëhere nuk kish nxjerrë asnjë fjalë, pyeti si ishte puna. Lamja e priti deri sa ai lau duart, e zuri për krahu e u nis me të drejt stacionit.

Një copë herë ecën pa folur. Pastaj u ndalën te streha e një barake, ku shiteshin libra e gazeta. Që andej panë si u nis autobusi.

— Të pres sa të vijë tjetri — tha Lamja. —
— Po, ç'erë që fryn! Dje thamë se do të binte borë, sot ja dha thëllimi.

Samiu e kish mendjen te fjalët që Lamja ja kish thënë aq prerë Hekuranit dhe e hodhi fjalën tek ai.

— I bie më qafë asaj, bashkë me disa të tjerë — tha Lamja që po bëhej gati ta hapte këtë bisedë.

Samiu nxitoi të thoshte mendimin e tij. Lamja e vështroi si i habitur.

— Ty të duket se ajo hahet me Hekuranin?

Samiu i tregoi për shënimet e saj «plot ligësi», siç tha ai!

— Dhe mirë ka bërë, shumë mirë bile. Ndoshta duhej vepruar ndryshe, por më pëlqen që i ka mbajtur ato shënime. Dhe ne të tjerët i kemi regjistruar këtu. — Ai tregoi me dorë kokën.

Samiu, sikur t'i kish mbaruar gjithë fjalët, vetëm dëgjonte.

Lamja bëri sikur s'e vuri re autobusin, që u mbush plot me njerëz e u largua rëndë, mospërfillës.

— Kështu është puna — vazhdoi ai, — pa le ç'thonë pesë a gjashtë. Por edhe ata s'duhet të thonë asgjë. Vajza duket e mirë.

Samiu s'dinte ç'të thoshte. Por erdhi autobusi tjetër.

— Do të të lërë edhe ky — i tha Lames. I bëri me shenjë shoferit që po tërhiqte derën dhe nuk lëvizi nga vendi deri sa Lamja u zhduk bashkë me grumbullin që përriu autobusi. Pastaj mori rrugën për nga «Ndërtesat».

Ai zakonisht e hiqte veten si indiferent, si njeri që s'i bënte përshtypje ç'thoshin e ç'nuk thoshin të tjerët, por ndonjëherë edhe fjala më e vogël s'e linte të qetë. Qëllonte që kur i bënin ndonjë vërejtje për punën, për repartin, ai përgjigjej me qetësi: «Do ta shohim, mund të jetë kështu», por ama për një kohë i dukej sikur ndjente akoma dhimbjen e goditjes që i kishin dhënë ca më parë. Kështu dhe këtë herë me Lamën. E kuptoi se biseda e tij nuk erdhi rastësisht. Aq më tepër që ishte i bindur se çdo bisedë duhej të përmbante në vetëvete një qëllim. Vërtet Lamja ja kish thënë të gjitha, urtë e butë, por kështu ishte natyra e tij. Ai s'dinte të rrëmbehej; sikur thosh diçka të za-

konshme, e sillte fjalën aty ku dhimbte më shumë dhe, pa e fyer tjetrin, e bindte se s'kish vepruar drejt. Duke i folur për Hekuranin, Samiut i dukej sikur në fund të çdo fraze i thosh: «Po ti sot mos gabove?» Dhe nuk i erdhi mirë që ishte nxituar e i kish thënë Dianës se nuk u besonte shënimeve të saj. «Fare pa takt, fare» — mendoi.

E pa Dianën tek po kalonte aty pranë me Bukrën. Deshi t'i ndalte vajzat, por ato diçka bisedonin me zë të ulët. Diana dukej e mërzhitur. Kish ngritur jakën e xhaketës, dhe me njerën dorë mbante flokët. Gjithë ecja e saj e mënyra si fliste e mbrohej iu dukën Samiut sikur thoshin: «Ç'është kjo erë?»

Ai iku në drejtimin tjetër, por ktheu kokën në çast. Bukra që, siç dukej, e kishte vënë re, i thirri. Vajzat ecën në drejtim të tij. Një xhips u kaloi pranë me rrëmbim. Ato qëndruan dhe e ndoqën me sy deri sa xhipsi u kthye rrëzë kodrës.

— Shiko sa bukur duket lumi? Të jep përshlytjen se duhet të zbresësh njëqind shkallë për të shkuar aty poshtë. Apo jo? Kurse zbritet fare lehtë.

Samiu u afrua si me përtim, i pyeti se ç'donin. Po Diana e vështronte ftohtë.

— A s'është mirë të bëjmë një mbledhje? — i tha ajo. — T'i bisedojmë bashkarisht me shokët ata shënimet e mia.

— Edhe mund ta bëjmë — u përgjegj ai, duke u hequr i qetë. — Keq s'do të na bëjë, veç mirë.

Bukra ndiqte me sy njerëzit që kalonin pranë, sikur të mos interesohej fare për atë që bisedonin ata të dy. Kur e pa se ata s'kishin më ç'të bisedonin, i tha Dianës të iknin.

«Dreq o punë, mendonte Samiu. Vetë dua, vetë s'dua. Mirë thotë Jani; kontradiktor. Në çast mendoj t'u flas, pastaj mezi e nxjerr fjalën. S'ka faj Jani, jo».

Të nesërmen në mëngjez, kur Diana i dorëzoi planin, ai i tha se duhej të uleshin e të mendonin bashkarisht në mund të bënin ndonjë organizim të ri të punës. Ja tha këto fjalë qetë, sikur të mos kish ndodhur asgjë. U mundua edhe të buzëqeshte. Veçse nga sytë s'qe e mundur t'i largohej ajo ftohësi që e kish ndjerë gjithë ato ditë.

— Më mirë presim dhe normistin — i tha ajo me qëllim.

Dhe përsëri ai e ndjeu se s'iu përgjegj si duhej.

— Mund të presim —

Kur ajo u nis të ikte, ai sikur të qortonte dhe veten dhe atë, thirri me zë të lartë se ata mund të prisnin, por puna nuk mund të priste. Përsëri u mundua të tregohej i qetë, vuri buzën në gaz, por kësaj radhe Dianës s'i bëri përshtypje asgjë, as sytë e tij që dukeshin të akullt.

— Më thërrisni kur të mblidheni — foli ngadalë dhe iku.

* * *

Ishte e shtunë. Disa minuta para se të mbaronte puna, Samiu shkoi në zyrën e byrosë teknike dhe u hëngër me inxhinier Petron, i tha se do ta çonte te drejtori për zvarritjen që i bënte shqyrtimit të propozimit që kish paraqitur. Inxhinier Petrua, fare i qetë, iu përgjegj se nuk ishte vetëm një

Sami që bënte propozime, se kish dhe të tjerë. Kur ti vinte radha, do ta shihnin dhe atë. Samiu përplasi derën e doli tërë inat në oborr, ku e priste Jani.

— Nursëzi i dreqit — shfryu ai, — ka inat, prandaj. — Jani e dëgjoji në heshtje ankimin e tij, pastaj i tha se ishte nxehur kot. Inxhinieri nuk kishte thënë ndonjë gjë të madhe.

— Gjeta dhe unë me kë të flas — tha tërë inat Samiu dhe nuk e hapi më gojën.

Pasi hëngrën bukë, shkuan në drejtim të klubit. Ecnin ngadalë. Koha ishte e bukur, jo sikur të ishte ditë janari. Dhe erë kish pak. Fishkëllima e tornove, zhurma shurdhonyjëse e maqinerive ndihej e largët dhe e mbytur. Ata hynë në klub dhe u habitën kur e gjetën bosh.

— Mos ka ndonjë mbledhje? Sikur shumë qe-tësi ka përreth.

— Hekurosen djemtë — tha Jani. — Kemi mbrëmje sonte. Harrove?

Samiu tundi kokën. Një copë herë qëndruan pa folur. Dëgjonin tringëllimën e enëve që laheshin në kuzhinë. Pranë banakut vështronin Demushin, punëtorin më të ri të uzinës, që diçka i thosh kamarierit, ndërsa ai i hidhte birrën në një vazo.

— Shiko, shiko, ç'e do atë birrë, o Demush?

Djaloshi, që e thërrisnin Demush, iu afrua Janit e buzagaz i përshpëriti në vesh. Jani ngriti vetullat i habitur.

— Vajzat? E ç'e duan birrën vajzat?

— Është sekret, por mua ma thanë.

Demushi përsëri diçka i pëshpëriti dhe sikur të ish bërë pishman për fjalët që nxori, ja kujtoi edhe një herë se ai duhej të heshtte.

Jani buzëqeshi.

— Flokët the? E si do t'i bëjnë flokët me birrë? Djaloshi vuri gishtin në buzë, e përsëri e porositi të heshte.

— Po përgatiten edhe vajzat për mbrëmje, — tha Samiu me një shprehje të tillë, sikur ta kishin zgjuar nga një gjumë i rëndë.

— Prandaj zhduki mendimet e zymta dhe hajt të hekurosim këmishët, — ja ktheu Jani.

Kur trokitën të dera e vajzave dhe u kërkuan hekurin, Diana po qeshte me të madhe. Lumja thirri të prisnin jashtë e mos të kërkonin sqarime. Në dhomë ishte një çrregullim i paparë deri atëhere. Lumja kish hapur fundin terital mbi krevat dhe i çapte palat. Diana rregullonte jakën e fustanit, kurse Bukra fshinte këpucët e diçka thosh me zë të trashë.

Pesë minuta më parë, kur Demushi solli birrën, ato kishin nisur një diskutim.

Bukra nuk donte në asnjë mënyrë të vinte bikutinat.

— E pse të sajohem? — përsëriste.

Po Diana s'i shqitej.

— E pse do të sajohesh? Ti do të rregullosh flokët e tu.

— Ashtu siç janë i dua. S'u jap rëndësi këtyre gjërave.

Lumja, që nga nxitimi shpoi dhe dorën, tha:

— Ohu! E do t'ja mbushësh mendjen Bukrës ti? E di ç'më thoshte kur vishesha? «E pse ndërton lëkurën për ditë? Rroba s'e bën njeriun.» Dhe unë ja prisja: «S'e bën, por lot një rol». Po ti, Diana, si thua?

— Punë e ngatërruar kjo — tha Diana. — Si-

doqoftë, lot një rol Çehovi thotë se tek njeriu gjithshka duhet të jetë e bukur, edhe fytyra, edhe mendimet...

— Edhe fustanet, — shtoi Bukra me të tallur.

— Epo dil ti ashtu siç rri në dhomë, hiqi dhe dy herë krehër flokëve para pasqyrës, ec si e shastisur dhe...

— Dhe s'ke për të gjetur burrë kurrë, këtu e ka fjalën Lumja — tha Bukra. — Ma ka përsëritur disa herë këtë...

— S'është puna te burri, Lume, — u hodh Diana. — Ne flasim në tërësi, për gjithë jetën tonë. Nuk zbukurohemi për të gjetur një burrë. Ja, sot më pëlqen të vishem më mirë, të krihem bukur, por jo se dua të gjej një burrë. Është një kërkesë që e ndjen njeriu në vetëvete, për t'ju përshtatur ambientit.

-- Po unë po them edhe sa ndikon edhe paraqitja në afrimin e vajzës e të djalit. Dhe qëndroj në timen, them se luan rol. Kurse Bukra s'e pranon në asnjë mënyrë. E di si më tha një herë? «Ja, unë kështu do të rri. Po të duan le të më pëlqejnë. Kurse ti ndërro bluzat e shko kërko dashurinë».

Lumja qeshi.

— Hë, Bukra, e gjeta apo s'e gjeta. Ti do ta presësh? Kujton se do të vijë vetë?

— Por s'do ta kërkoj, veç — u hodh Bukra. — Dhe s'do të pispillosem që ajo të vijë vetë. Por askush nuk mund ta mohojë se ajo nuk mund të vijë në rast se unë rri dhe kështu siç jam.

— Me sa duhet, paskam rënë në dhomë me dy ekstremiste. Pa le ti — Diana u drejtua nga Bukra. — E ke dhe emrin Bukuri, e megjithatë e mohon fare. S'e kam fjalën se ajo është kryesorja, por unë mendoj se e bukra duhet të endet kudo

në jetën tonë të përditshme. Sikur të shfletosh albumin e një piktori, unë vë dorën në zjarr po të mos soditësh me ëndje atë çka është më e bukur. Pastaj, moj Bukra, për çfarë përpiqemi ne? Për ku synojmë të gjithë? Ta bëjmë jetesën tonë të bukur, qytetet e gjithshka që na rrethon t'i bëjmë të bukura. Dhe veten tonë. Dhe kjo bëhet jo duke u sajuar, por duke u veshur mirë e pastër, duke qenë e rregullt, duke zgjedhur atë që të shkon.

Bukrës s'i mbushej mendja.

— Për mua s'ka fare rëndësi veshja e njeriut.

— Më tepër e thua nga kokëfortësia — ja kthente Lumja. — Pa më thuaj, atë ditë që bleve stofën për fustan pse shkove në të dy dyqanet? Pse s'bleve atë që të zuri syri më parë?

— Tjetër stofa, tjetër ajo që them unë.

Biseda zgjati shumë, por vajzat bënë si bënë dhe ja vunë Bukrës bikutinat në kokë, u lanë e u hekurosën, u bënë krëk, si i thonë një fjale, e filluan të pregatiteshin për mbrëmje.

Ndërsa rrinte para pasqyrës e Diana ja gufonte flokët, Bukrës iu duk se kish vënë një kapele të madhe në kokë, i ngjante vetja si një fqinja e saj.

— E sheh se ç'dukesh? — i tha Lumja.

Diana heshtte.

— Pa t'i provojmë një herë ndryshe — tha ajo.

Bukra s'fliste. Ajo e la Dianën të bënte ç'të donte. Më vete mori një vendim: para se të nise-shin, t'u shkonte dy-tri herë krehrin me ujë flokëve e t'i sillte në vete.

— Shiko sa mirë — u entuziazmua më në fund Diana. — Dhe dëgjo, vish trikon time.

Këtë herë edhe Bukrës iu duk vetja e mirë, por

sidoqoftë ajo do të vinte në jetë vendimin e saj. Dhe ashtu bëri. Kur po bëheshin gati të vishnin palltot, ajo erdhi nga banja me flokë të shtruar.

— E ç'ke që u vrëjte? — i thosh Dianës tërë rrugës. — Mua se si më dukej vetja, prandaj i prissha. Dhe në mbrëmje s'do t'ja kaloja mirë, do fshihesha prapa teje. Ashtu dhe sytë do t'i hidhja me frikë sa te njëri te tjetri. Kurse kështu do të jem e lirë.

— E pse?

— Ku e di unë? Dhe s'do të kërceja. E di? Janë ftuar edhe vajzat e teknikumit — tha për të ndërruar bisedë.

Vonë natën, kur po ktheheshin në shtëpi, Diana s'e hapi gojën gjithë rrugës. Jo se ishte e mër-zitur. Ajo kish qeshur e kënduar, kish kërcyer me shokë të repartit dhe me të tjerë që s'i njihte fare, ishte shkruirë në tërë atë atmosferë të gëzuar, por në gëzimin që ndjente, sikur depëronte një hije fare e zbetë, e pakapshme, një hije që herë zhdukej, herë shfaqej papritur dhe e vinte në mendime.

Kur ranë të flinin, solli në mend çastin kur hyri në sallë, emocionin që ndjeu kur kuptoi se shumica e atyre, që ishin brenda, ja ngulën vësh-trimet. Ajo eci serbes. E dinte se fustani që kish veshur i rrinte mjaft bukur dhe i jepte një ngjyrë gruri si në lila fytyrës së saj ezmere. Sa herë në Tiranë i kishin thënë se ai fustan e tregonte të mrekullueshme. S'e kish veshur më kot atë fustan. Kish një dëshirë të dukej e mirë atë mbrëmje.

Jani, Esati, Bardhi i përshëndetën vajzat nga larg, u thanë të venin pranë tyre, por ato bënë me kokë nga Rina, që u kish zënë vendet.

Pastaj muzika, spikeri, Ana, recituesja e uzi-

nës. Ishin kënaqur. Tashti, e shtrirë në krevat, ajo s'po e kuptonte përse i erdhi mirë, kur, pas gjysmë ore si kish filluar mbrëmja, kish parë Samiun të hynte në sallë. Kishte rregulluar flokët me dorë e se çfarë kish filluar t'u tregonte shoqeve tërë gaz. Të thuash se i pëlqente ai njeri dhe u gëzua që e pa. Vetëm kjo s'mund të mendohej. Sa herë gjatë atyre ditëve kish provuar dëshirën të kacafytej me të! Kur ishte në Tiranë e kish dëgjuar se racionalizatori më i mirë i konkursit të fundit, Sami Beluli, punonte në uzinën, ku ajo kish shfaqur dëshirën të shkonte, asaj i kish ardhur mirë e me mburrje u kish folur për të shoqeve. Njëra prej tyre i kish thënë se ai ishte njeri i zgjuar e simpatik, por mjaft mendjemadh e mospërfillës. Dhe kish treguar se kur e kish prezantuar një kushëri i saj me të, ai vetëm sa i kish zgjatur dorën, pastaj gjithë kohës ishte sjellë me një mënyrë sikur ajo mos të ish fare aty. Fjalët e shoqes i ngjallën Dianës kureshtjen për ta njohur këtë njeri. Bile atë kohë kish menduar se çfarë qëndrimi do të mbante ajo sikur ai të tregohej mendjemadh e mospërfillës dhe me të. Por ndryshe kur mendon e ndryshe kur vepron. Kur Samiu aq papritur e pa u prezantuar i kish kërkuar planin e punës, ajo ishte hutuar, me vështirësi e kishte mbledhur veten e kishte nxjerrë ato dy fjalë. Samiu ishte vërtet mospërfillës. Dhe ajo kish menduar se gjëja më e mirë për të thyer atë qëndrim prej mendjemadhi ishte që dhe ajo t'i përgjigjej me mospërfillje. Ndaj atë natë, në mbrëmjen kur ajo ishte bërë aq tërheqëse, mospërfillja e saj kish një farë rëndësie.

Kur ishin ulur, Samiu kishte vështruar nga ato. Diana me bisht të syrit kishte dalluar se si ja kish

qepur vështrimin ai. Po ajo provoi një zhgënjim. Samiu u afrua drejt tyre dhe u duk se do të mernte atë për të këcyer. Por ai me shkathësi të madhe u gjend përpara Bukrës dhe i tha se donte të kërcente me të pa i hedhur fare sytë nga Diana. Të mos kishte qenë ky zhgënjim, dhe gjumi do ta kish zënë më shpejt Dianën. «Mendjemadhi, mirë thonë,» — tha ajo duke u kthyer nga krahu tjetër.

Samiu në atë çast mendonte: «Dhe bëra mirë që s'këceva me të».

Në të vërtetë ai ishte nisur drejt saj. Dontë ta zbutte tërë atë atmosferë të rëndë që ish krijuar ato ditët e fundit, por kur po i afrohej asaj, se si i shkoi mendja te Bardhi që s'do ta linte rehat duke e ngacmuar dhe ai arriti ta luante rolin në mënyrë të shkëlqyer, e të mos i hidhte fare sytë nga Diana.

KAPITULLI IV

Pas bisedës që kish bërë me Lamën, Samiu filloi të kuptonte se mbante përgjegjësi për çdo gjë që mund të ndodhte në repart, jo vetëm se ai përgjigjej për prodhimin, por se duhej të kujdesej edhe për çdo shqetësim të punëtorëve... I kishin besuar një repart e duhej ta justifikonte këtë besim. Dhe që të nesërmen, pa filluar punën, ai i kishte tërhequr vërejtjen Ademit e Metit. I kishte folur dhe Hekuranit. I kishte thënë se binte në sy për të keq, se pengonte punën duke u sorollatur maqinë më maqinë, se përderisa në repart ishte Diana, ai s'duhej të fuste hundët në punët e saj. Hekurani, i prekur, i kish thënë se s'kish për të lëvizur më nga vendi, sikur edhe bota të përmysej. Që nga ajo ditë ai vështronte vetëm punën e tij, u përgjigjej rëndë shokëve kur e thërrisnin për t'i ndihmuar dhe seç murmuriste nëpër dhëmbë. Diana s'mund ta mendonte se ç'mëri të madhe mbante me vete Hekurani. Vetëm një ditë që u përlesh keq me të kuptoi shumë gjëra.

Ajo ishte tepër e zënë me montimin e një freze, kur u afrua Hekurani dhe i tha se i kish ngelur maqina.

— Ti mund ta rregullosh vetë — ja ktheu ajo,
— s'është nevoja të vij unë.

— Ti je teknikja, — i u përgjigj ai thatë e, duke ikur, shtoi se e priste. Dhe qëndroi pranë dritares deri sa Diana u lirua nga puna që kishte në dorë.

Ajo u drejtua te tornua e tij. Nuk la pa i thënë se nuk vepronte mirë, se kjo gjë që bënte ai ish në dëm të punës. Pa i vënë vesh murmuritjes së tij, kontrolloi tornon. Difehti ishte tepër i vogël, nuk iu desh as tri minuta për ta rregulluar. Kur mori darën për të shtrënguar një vidë, erdhi Samiu. Ai dukej i qeshur. E pyeti Dianën ç'thoshin djemtë, por, kur ajo ngriti kokën, dalloj një zemërim të madh në sytë e saj.

— Punojnë sipas qejfit — tha ajo ashpër dhe i erdhi mirë që ja tha këto fjalë pikërisht atij.

Hekurani takoi tornon, lëvizti thikën e diçka tha nëpër buzë.

— Si është puna? — pyeti Samiu me ton serioz.

Diana e vështroi sikur ta kish me të inatit e i tha se Hekurani s'kish për ta realizuar normën atë ditë as 90%, se ai ishte njeri me sedër të sëmurë.

Hekurani stakoi tornon e pa të keq pyeti:

— E pse, punën tuaj do të bëj unë, shoqja teknike? Një herë hiqeni e pakënaqur, pastaj, kur e shihni që s'ju del gjë, kërkoni t'ju lehtësojnë.

— Jo, shoku Hekuran. S'dua të më lehtësoni, por të shtoni prodhimin. Dhe këtë duhet ta kuptoni mirë ju.

Por Hekurani s'donte ta jepte veten, sidomos para Samiut.

— Ç'janë këto fjalë që bëni? Flitet kështu? —
ndërhyri Samiu.

Hekuranit iu duk se e muarën në mbrojtje.

— Nuk e sheh? — tha — E paska zënë me të
gjithë. Epo ne kështu jemi. Do të na bëjë ajo ndryshe?

Diana buzëqeshi me djallëzi.

— E di unë si je ti, Hekuran. Më kanë treguar.
Dhe e di pse bën kështu. Po ti duhet ta kuptosh
mirë se unë kryej një detyrë që më kanë caktuar
e do ta kryej ndershmërisht.

— Nderimet e mia, atëhere, zonjushë, — tha
ai plot ironi duke bërë një reverancë të vogël.

Diana u largua. Sakaqë pranë tornos së Heku-
ranit ishin alruar disa punëtorë, midis të cilëve
edhe Jani.

— Më vjen keq, o Hekuran, — tha ky, — po
5 me 0 në favor të saj. Ajo ka të drejtë, kurse ti
s'po vepron fare mirë. Të kam thënë dhe tjetër herë
si shok, por ti s'po dëgjon. Ashtu dhe Dhori. Dhe
Meti. Do të t'i numëroj? Sa erdhi Diana dy cigare
i pive me Dhorin. Po ai, sidoqoftë, nuk e shojti ma-
qinën.

— I ulet tetëmijsi — tha Hekurani.

— Edhe pse s'e shojti, do t'i ulet — shtoi
Lamja që sapo ish afruar. — Shikoni, i sollën prapë
skarcitetet e tij. Kurse ti?... Vazhdo, Jani, e nise
mirë.

— Pse, mor, kaq shpejt e harrove zanatin ti?
Por dhe ajo ç'ta punoi!

— Po këto minutat e tua pse s'i llogarit — u
hodh Hekurani. — Mos na lërë pa punë.

— Ke të drejtë, mor djalë, — tha xha Ristua

— por duhen biseduar këto gjëra. Nuk janë të hijshme dhe na dëmtojnë. Duhet biseduar.

Kur u shpërndanë punëtorët, Samiu shkoi te Diana që të merrte vesh si kish ndodhur gjithë ajo shamatë. Kjo s'priti të pyesë ai, i tha hijerëndë:

— E patët të vështirë kur filluat punën këtu? Çfarë ju shqetësonte më shumë?

Samiu s'po e kuptonte se ku donte të dilte; iu përgjegj prerë.

— Jam mësuar me punë. Njeriu s'duhet të mendohet për vështirësitë.

— Por s'duhet ta marrë çdo gjë lehtë — ja priti ajo. — Unë e kam të vështirë. Si mendoni, a s'do të jetë më mirë të largohem prej këndeje? Ndoshta jam unë shkaktarja e këtyre fjalëve, dhe fjalët sjellin çrregullime.

Samiu s'iu përgjegj pyetjes së saj. Në atë kohë ai mendonte se do të ishte shumë mirë sikur ajo të largohej. Tjetër punë që e kish shkëlur ato ditë Hekurani, po me të, jo Dianën, por as dy femra bashkë s'vinte Samiu.

Vajza e kuptoi ç'bluante në kokë dhe u inatos më tepër. La limën që mbante në dorë dhe iku me rrëmbim nga reparti.

* * *

Ndërsa Diana e Hekurani grindeshin, Bukra që punonte pranë Hekuranit mendohej të kapte vështrimin e shoqes e t'i thoshte të heshte. «Këto punë nuk zgjidhen me të zënë» — mendonte Bukra. Pastaj kish ardhur Samiu, kishin ardhur dhe të tjerët dhe Bukrës i erdhi mirë që shokët kishin marrë

anën e Dianës dhe po u jepnin një dru të mirë Hekuranit e të tjerëve. Këtë priste dhe Bukra, ndaj e ndjeu veten të gëzuar, por do ti? Pikërisht në këtë moment kur çështja po zgjidhej në favor të Dianës ajo vetë me një shqelm i hedh të gjitha poshtë, si ai lojtari i mirë që fiton gjithë simpantinë e sportdashësve me lojën e bukur që bën, por që pastaj nga padurimi rrëmbehet dhe hedh një gol në portën e tij. Bukrës sikur t'i kishin rënë me grusht në atë kohë. Ajo u vështrua sy më sy me Janin dhe mblodhi supet.

Pas pune u lajmëruan të gjithë të qëndronin për mbledhje.

Diana rrinte kokë ulur, vetullat i kish mbledhur sikur donte të fshihte sytë e zez. Megjithëse para ca minutash kish menduar të deklaronte para të gjithëve se s'do të punonte më aty, tashti i vinte turp që kish ikur si frikacake. Por shokët nuk u treguan të rreptë. Diskutimet e tyre ishin përqëndruar te Hekurani, te Ademi, te Dhori e te Meti. Për Dianën nuk po flisnin. Ajo dëgjonte dhe sikur çlirohej nga ai afsh, që i kish mbuluar tërë trupin, që i kish skuqur fytyrën. Ngaqë askush s'po e kujtonte gjestin e saj të rrëmbyer, për një moment mendoi se ndoshta kish bërë mirë që kish vepruar ashtu. Përndryshe s'do të ishte zhvilluar as kjo mbledhje dhe, ajo që kish më tepër rëndësi, s'do të viheshin gjërat se cila në vendin e tyre. Duke mendur kështu, priste që dikush të ngrihej e të fliste haptas, pa dorashka për mendimet e gabuara që kishin disa shokë në repart për punën e femrave. Jani, e preku edhe këtë çështje, dhe dikush tjetër e zuri në gojë, por jo me atë forcë që deshi Diana. Dhe u çudit më tepër sidomos kur Bukra, u

ngrit e foli vetëm për ndërgjegjen në punë, pastaj heshti. «Përse hesht, Bukra?» donte të thërriste Diana. Lamja diskutoi gjatë. Në fund tha se në repart mund të kishin lindur disa kontradikta të vogla «por gjithmonë — tha kur hyn e reja, do të lindin kontradikta, prandaj s'duhet të trembemi prej tyre. Ato do të zhduken. Sigurisht jo vetiu. Kolektivtë ynë, si gjithmonë do të luftojë për zhdukjen e tyre».

Diana nuk i ngriti sytë. Një tog arësytimesh vlonin në mendjen e saj. Iu duk se tërthorazi Lamja e të tjerë po i thoshin: «Nuk është rrugë zgjidhje ajo që bëre ti, Dianë». Dhe heshtja e Bukrës këtë donte të thosh. Heshtja e Bukrës ishte shumë e rëndë.

Kushedi sa herë gjatë asaj dite u bë gati ta pyeste shoqen por për çudi, sa hapte gojën të fliste, niste një bisedë tjetër. Dhe e ndjente veten të lehtësuar, kur shihte që shoqja vinte buzën në gaz apo përgjigjej me shaka. Në mbrëmje, ndërsa dëgjonin Radio-postën, Bukra e hapi vetë bisedën:

— E di? Për pak desh të kritikova në mbledhje. E do të të kritikojë rëndë. Por vendosa, që meqënëse është hera e parë, të ta them veças. Kur vrapove nga salla, m'u bëre si një Dianë tjetër dhe jo si ajo që njoh unë, si një Dianë, që vështron vetëm sedrën e saj.

— S'është punë sedre — u hodh Diana.

— Po çfarë? Unë e kam pasur më vështirë, por s'kam ikur. Ti e bëre si Lumja, dhe mua më erdhi keq, të të them të drejtën më erdhi rëndë.

Pasi tha këto, heshti. Dhe Diana rrinte e heshtur. Jashtë frynte e binte shi. Pikat përplaseshin me forcë në xham. Diana mendonte për kontradiktat që kishte përmendur Lamja. Dhe ajo këtë kërkonte të zhdukeshin këto kontradikta. Por du-

het të kishte durim, të mos rrëmbehej. Këtu qëndronte gabimi i saj. Babai ja kish thënë: «E kush fitoi që në hapin e parë?»

«Kurse unë dua t'i zgjidh të gjitha njëherësh, sa hap e mbyll sytë. Dhe Lamja, pa tjetër, këtë desh të thoshte» — tha më në fund me vete.

Papritmas e pushtoi një mall i madh për shtëpinë, për nënën, për babanë, për apartamentin e saj pranë stacionit të autobusit, për bulevardin, për mbrëmjet e bukura midis shoqesh e shokësh. Dhe iu duk se kish bërë një gabim të madh. Me dashje ish larguar, nga ëndrrat e saj, nga synimet, nga gjithshka e mirë. Përse?

«Njeriun e udhëheq një ideal në jetë. Dhe sa mirë që ti ke ideale., Dianë... Po më kujton rininë time...» Kështu i kish thënë nëna atë natë, kur ajo u kish treguar vendimin që kish marrë. Dhe një orë të tërë nëna kish kujtuar si kish dalë partizane dhe si dëshira e saj për liri nuk kish pyetur as për një pengesë, as për një vështirësi...

Përse?

Sa pa kuptim iu duk Dianës kjo pyetje. Ajo nderi dorën mori portokallen që i zgjaste Bukra. Buzëqeshi. Edhe këtu shokët ishin të mirë.



Vonë, kur errësira pllakosi dhomën, Hekuranit iu duk se nata s'do të mbaronte kurrë. Mendimet i vinin e i shkonin me një shpejtësi të çuditshme. Dhe gjithmonë po ato mendime «Unë i pandërgjegjshëm! Po Samiu ç'të folur bëri? Pse s'tregoi si kam punuar? Unë i pandërgjegjshëm, kurse

ajo... U ngrit e foli. Qortoi dhe veten... Ademi u lëkund. Jo kështu, jo ashtu. Domethënë unë qenkam më keq nga Ademi. Ula planin. I pandërgjegjshëm... Dhe Samiu... në vend që të thosh atë që duhej!... Mirë thotë Meti: «Shiko punën tënde. E pse të hysh në telashe?»

Ai u rrotullua disa herë nga njëri krah në tjetrin, por mendimet i riktheheshin. Sytë i mbante hapur. Që nga dritarja shihte qiellin që nxinte dhe i vinte inat që s'kishte asnjë yll...

Atë natë Hekurani mori një vendim: të shikonte vetëm punën e tij.

KAPITULLI V

Diana veshi pallton me shpejtësi se do të shkonte me shoqet në kinema, por vrapoi Demushi e i tha se dikush e kërkonte. Kish ardhur një makinë para klubit, kish zbritur prej saj një burrë i gjatë me kasketë dhe kërkonte Dianën. Asaj i rrahu zemra fort. Mos vallë babai? Vrapoi dhe u çel e tëra tek e pa. Në çast harroi edhe Bukrën, harroi që nxitonte për në kinema, iu hodh të atit në qafë e zuri për krahu e i bëri njëzet pyetje menjëherë. Sa fillonte ai të përgjigjej, ajo e pyeste për diçka tjetër.

U ulën në një tavolinë në klub. Porositën kafe, kakao, një pastë për Dianën. Babai tha se ajo ishte hequr pak, por dukej më e rritur. Dhe s'dukej keq. Diana buzëqeshte vazhdimisht, e shikonte të atin në sy e buzëqeshte.

— A ju merr malli?

— Sidomos mamanë.

— Është e mërzitur?

— E pse, moj Dianë? Tashti u mësua.

— Këtu jam mirë, baba.

Ajo nuk i tregoi për telashet që kish kaluar,

i tha vetëm se, para disa ditësh, kishin bërë një mbledhje të gjallë, ashtu si i pëlqente atij dhe kishin vënë në vend disa gjëra që duheshin vënë. Pastaj i foli për Bukrën, për Lamën, për Janin, për xha Riston e të tjerë.

— Nëna të priti, kur u martua Vali. Tetua u zemërua. «E ka harruar fare» — tha. — Kur, do ti? Vjen telegrami e vjen tamam në kohën që ne u ulën në tavolinë e do të ngrinin dollinë.

— Dhe mamaja qau?

— E si flet kështu për mamanë? Po t'ja them këto fjalë, do të zemërohet. Ti e di, ajo ishte shtatë vjet më e re se ti kur shkoi partizane. Mamaja është pak sentimentale, por ta dish, ajo të mban në gojë. Të gjithëve u tregon se vajza e vetme i ka shkuar vullnetare. Dhe atë natë, mburrej mamaja me ty.

Diana buzëqeshi. Për një çast e ndjeu veten midis njerëzve të saj të dashur.

— Të gjithë janë mirë? — pyeti dhe një herë.

— Ti, po deshe, hajde për festat e 1 Majit — i tha i ati. Ajo s'dinte ç't'i thoshte.

Shëtitën dy orë rrugëve të shkurtëra të qytetit të ri. Diana e çoi te «Ndërtesat», i tregoi dhomën, e deshi që babait t'i dukej sa më e mirë e s'dinte si t'ja mbushte mendjen se ajo ishte e mirë, por shoqet kishin shpejtuar për në kinema dhe e kishin lënë rrëmujë.

— Ja dhe fotografitë tuaja ku i kam vënë!...

Pastaj e çoi në sallën ku kalonin kohën e lirë. I tha se kish mësuar të luante tenis, se shkonte dhe në stadium. Esati, një shok i repartit, e hiqte zvarrë bashkë me shoqet, po të mos shkonte.

Erdhën shoqet. Babai fliste e qeshte me to.

Dukej i lumtur dhe Dianës s'i besohej se kish ardhur ato ditë që ajo ta bënte aq të lumtur babanë.

Pasi e përcolli të jatin, Diana u kthye me sy të gëzuar, të qeshur në dhomë me një ndjenjë që s'e kish provuar kurrë. Hyri tërë bujë, duke kënduar një melodi nga të festivalit, por shoqet i thanë të heshte. Ato ishin mbledhur kokë më kokë te radiua e dëgjonin me vëmendje të madhe. Sytë u shkëlqenin, kurse spikeri fliste me zë të plotë, të sigurtë.

* * *

Filloi puna, por dhe Diana e kish mendjen te fjala e shokut Enver që ishte dhënë natën e kaluar në radio, e iu duk se përsëri dëgjoji Bukrën tek i thosh: «A s'ngjan me ato thirrjet e zjarra që i bënte partia popullit në kohën e luftës?» Sa biseda kish hapur ky fjalim! E çukej sikur ato s'kishin të sosur.

Në pushimin e mëngjezit, të rinjtë, që e kishin marrë bukën me vete, u ulën mbi tubat përpara repartit. Dielli ishte i ngrohtë, i shkëlqyeshëm dhe i kish dhënë një pamje tjetër uzinës, oborrit. Dukej sikur gjithshka qeshte rreth e qark.

Bukra vështroi Esatin që futi një copë bukë të madhe në gojë dhe qeshi.

— Ç'ke? — i tha ai. — Jeni në qejf, ë? Por po ta kesh dëgjuar me vëmendje fjalimin, duhet të kesh kuptuar se dhe ju mbronte, por dhe ju kritikonte...

— Kush tha se nuk e kemi kuptuar?

— S'është puna vetëm ta kuptoni — tha dikush, — por...

— Lexojeni, lexojeni dhe një herë — tha Esati.

— Kurse ju duhet ta lexoni tri herë, — tha Rina, që ishte ulur në një qoshe e dukej sikur s'dëgjonte fare ç'thuhej rreth e qark. Bukra qeshi.

— E di ç'bënte një komshiu ynë? Në çdo mbledhje ngrihej e fliste me zjarr, se si duhet të bëjmë këtë e atë, të mos kursehemi, me një fjalë. Por kur vinte puna që ne të tjerët me kazma e lopata dilnim për punë vullnetare, ai rrëmbente dosjen, e vinte nën sqetull dhe me hap serioz kalonte para nesh. Aty ku ishte grumbulli më i madh, ja hidhte sytë ndonjërit, i buzëqeshte e i thosh: «S'na lënë një ditë punët rehat» dhe me sy tregonte dosjen. Kështu dhe ju. Po flisni për të tjerët, po veten tuaj pse s'e shihni, siç thotë shoku Enver, në pasqyrë?

— Këta janë të përsosur — tha Rina me ironi.

— Epo njeriu e ka më të lehtë të flasë për të tjerët — tha një punëtor — pa dhe ne plot huqejemi.

— Na i ka lënë Turqia...

— Ç'turqi, mor derëzi, vetë i lëmë brez pas brezi...

— Shumë mirë e the, Nurçe, — tha Lamja. — Vetë i lëmë, apo jo? Edhe kur e kuptojmë se s'janë të mira, prapë i lëmë. Ju kujtohet xha Dinua, kur martoi djalin e vet? «S'ja kam ngenë — thosh — të bëj dasmë, por ç't'u bëj njerëzve». Dhe nga që s'donte ta mbanin nëpër gojë, bëri dasmë të madhe. Dhe sa gjëra të tjera të tilla gjen!

Diana dëgjonte e heshtur. Ju duk sikur ishte në mbledhje dhe shokët po diskutonin njëri pas tjetrit.

— Sidoqoftë — tha ajo, — lufta me zakonet,

me mentalitetet është e vështirë. Një objekt, kur s'të duhet, kur të pengon, e merr dhe e përplas në tokë e e bën copa-copa. Po pa hajde zhduk zakonet? Është një luftë e vështirë, e pandërprerë...

— Kur heshti, iu duk se i vuri shokët në mendime.

«Mos kujtuan se e hodha fjalën për veten time?» — i shkoi në mendje. Kjo disi e hutoi, por më vonë e qetësoi. «Edhe t'u jetë dukur, ç'të keqe ka? Unë thashë një të vërtetë».

Atë mbrëmje, para se të flinin, i tha Bukrës:

— Si ndodhet ndonjëherë njeriu bosh, fare bosh. A të kujtohet ajo ditë kur u rrëmbeva ashtu? Tash-ti më vjen turp ta kujtoj. Të ka qëlluar ty, Bukra. Që pas disa kohësh t'i thuash vetes! «Si e bëra këtë?» Kështu më ndodhi dhe mua. S'di sepse atëhere më dukej e errët çdo gjë. Shokët janë kaq të mirë... kurse unë...

Ajo heshti. Bukra kish hedhur vështrimin jashtë e shihte murin e një ndërtese, që lartësohej çdo ditë. Nga dritarja pak e hapur vinte një zhurmë metalike e largët, e mbytur.

— Sepse kërkoj të rregullohen të gjitha njëherësh. Se mos është puna se pritët një urdhër. Dhe këtu ke të bësh me zakone, mbeturina. E thashë dhe një herë se ato nuk shkulen lehtë.

— Nuk shkulen lehtë, por duhet luftuar për t'i shkukur. Ti fillove luftën. Kishe të drejtë. Vec që u tregove ca e rrëmbyer. Por po s'luftuam kundër zakoneve të vjetra, pa dashje i përhapim. E di? Kur punoja në artizanat, dëgjoja vajzat tek flisnin për copat që blenin, për ato që qëndisnin, për kuvertat, me një fjalë për pajën. Qëllonte që për një

çast më lindte dhe mua dëshira të grumbulloja diçka... Por ky çast kalonte shpejt. E thosha: — Eh, këto zakone, janë si sëmundje ngjitëse. Shumë shpejt infektohesh. Apo jo, Dianë?

Diana dëgjonte e mbytur në mendime.

— Dhe këta tanët e zunë me ty se s'kanë parë ndonjëherë që t'i mësojë një vajzë, sidomos në punë që deri para disa vjetësh kanë qenë vetëm të burrave. Përsëri zakoni do të thuash ti. Këtu e kam edhe unë fjalën. Ky zakon duhet luftuar. Mos kujton se me disa mbledhje e luftuam?

Bukra qeshi.

— E kemi goditur pak. Por do ta shembim.

— Po mua sepse më duket sikur e kemi fshehur dhe ai rri i heshtur.

Asaj iu kujtua heshtja e Hekuranit, buzëqeshja artificiale e Samiut.

— Jo, e kemi goditur — tha Bukra me ton të prerë.

Nata kish rënë me kohë. Frynte erë por qielli ish plot me yje.

KAPITULLI VI

Punët në repart shkonin mirë. Atë pasdite që grafiku u ngrit mjaft, Diana i foli me entuziazëm Bukrës për shokët e repartit. Kjo ja ktheu se ashtu kishte qenë përherë, se njerëzit vazhdimisht kishin punuar mirë, se punën nuk duhet ta matësh me sjelljen e dy apo tre njerëzve, se një pakicë e vogël nuk mund të errësojë sa e sa të tjerë.

Diana e dëgjonte Bukrën me qejf dhe i vinte mirë që ajo përherë dinte të gjykonte drejt e të vinte çdo gjë në vendin e vet. Bukra shkollën nuk e kish mbaruar, vazhdonte klasën e dhjetë natën, por lexonte shumë, lexonte çdo libër e revistë që i binte në dorë, dhe kjo e kish ndihmuar së tepërmi në formimin e saj.

Po të kish vazhduar universitetin, Bukra do të ishte bërë një inxhinierë e mirë, e aftë. Këtë mendim ja thoshte gjithnjë Diana. Bukra heshte. Një herë i tha se e kishte lënë shkollën e kish hyrë në punë sepse i vinte rëndë t'i bëhej barrë vëllait. Tashti do ta vazhdonte, patjetër do ta vazhdonte. Megjithatë sa herë niste e qortonte Diana, ajo hi-

dhej në një bisedë tjetër, apo bënte sikur i kujtohej diçka e derdhte një lumë fjalësh.

Dhe këtë radhë, sa nisi t'i thotë Diana «S'kam thënë kot unë, inxhinieri, avokate, çfarë s'mund të bëhesh», ajo ktheu kokën nga tornua e Hekuranit dhe i shkeli synë Dianës. Aty ishte dhe Samiu, që se ç'i thosh Hekuranit; ky nuk e ngriti kokën. Samiu me sa dukej, priste përgjegjen e tij, po Hekurani heshte e vazhdonte të punonte.

Që nga ajo ditë e mbledhjes ai nuk ja zgjaste askujt. S'bisedonte me askënd gjatë kohës së punës, s'lëviste nga vendi. Kur bëhej pushimi, më të rrallë thoshte ndonjë fjalë. Edhe në dhomë fliste pak.

— Mor, po ty sikur të janë mbaruar fjalët — i thosh Jani. Bardhi ja priste:

— Eh, s'e dini ju. Hekurani ka dëgjuar se njeriu fjalët i ka të numëruara. Dhe që të rrojë më gjatë nga të gjithë, i përdor me kursim. Njeri me mend, jo si unë llafazani.

Hekurani as në këto raste nuk përgjigjej. Por kjo gjendje nuk i kënaqte ata të repartit, aq më tepër e brengoste Dianën. Kur kalonte pranë tornos së tij, ai e ulte më tepër kokën, tërë kaçurrela të zeza, mbi metalin që rrotullohej. Asaj atë çast i dukej se një gozhdë e ngulur prej kohe në krahëror i lëviste dhe e lëndonte. Megjithatë, një ditë mposhti çdo mendim që mund ta ndalte dhe vajti pranë tij, e pyeti si i kish punët. Dëgjoi vetëm një murmëritje dhe pa si u përkul ai mbi hekurishtet aty pranë. Për një moment Diana u pendua që kish vajtur, por e mblodhi veten. Hodhi vështrimin përreth e dalloi fytyra të djersitura, vështrime të përqëndruara mbi metalet që rrotulloheshin, që shkëlqenin.

I foli përsëri Hekuranit. Ai s'iu përgjegj, u hoq se nuk e dëgjoi.

Një herë tjetër ajo dërgoi tek ai Demushin për ta thirrur që ta ndihmonte në montimin e një freze. Hekurani as nuk u përgjegj, as lëvizi nga vendi. Jani kur ndeshi vështrimin e tij, tundi kokën sikur donte t'i thoshte «hajde, hajde, vëlla». Pastaj gjatë pushimit e qortoi. «Ajo s'të thirri në arë të babait». Hekurani s'foli. Në dhomë ja përsëritën dhe të tjerë vërejtjen e Janit. Ai, i ngrysur, u përgjegj:

— E ndjen që është fajtores ndaj meje. Dhe s'ka si ta lajë këtë faj, veçse duke u shtirë se kërkon ndihmën time. As që dua të më flasë me gojë.

Shokët nuk e lanë të vazhdonte. I thanë se fliste pa menduar. Dhe, për çudinë e të gjithëve. Niku, që s'e kish thënë kurrë një fjalë të mirë për Dianën, këtë herë mbajti anën e saj.

— Sa për këtë, s'ke të drejtë, Hekuran. Ajo konsultohet me njerëzit, të pyet për çdo gjë e të kërkon ndihmë, s'është mëndjemadhe. Është e lidhur me punëtorët.

Hekurani u tregua se nuk i bënte përshtypje asgjë nga ato që thoshin shokët por në vetëvete e kuptonte se s'kishte shumë të drejtë. Dy-tri ditët e para pas mbledhjes e ndjente veten mjaft të fyer, ishte tepër i zemëruar me shokët. I dukej se i kishin ngrënë hakën, se nuk ja çmonin më punën e kryer për më se një vit në uzinë. Ai përherë kish menduar se kishte punuar mirë, nuk ishte kursyer, s'kishte pyetur për lodhje. Të gjitha këto duhej të kishin rënë në sy të shokëve. Po ja që ata tani e kishin quajtur të pandërgjegj-

shëm. Sa kujtonte këtë fjalë, ai ndjente një dritërimë në vetvete rrëmbehej e s'duronte t'i hidhte sytë asnjërit. «I pandërgjegjshëm» dhe ata kishin heshtur të gjithë. E pse? Ç'kish bërë ai? Kërkonin shokët ndihmë dhe ai shkonte. Ç'kish bërë tjetër? E kjo qenkish në dëm të punës? Po ky zemërim i ditëve të para u shua. Shokët, si më parë nuk iu ndanë. Vështrimet e tyre ishin po aqë miqësore sa dhe para mbledhjes. Fjalët «nuk duhet të rrëmbehesh, Hekuran» që sa herë ja përsërisnin e bënë të pyeste veten: «Jam rrëmbyer apo kam të drejtë?» Dhe kur rrinte dhe analizonte këtë, dilte dhe me faj dhe pa faj.» Mua s'më çmuan, thosh, sikur prisnin sa të vinte një vajzë e të më tregonte vendin. Dhe unë jam njeri, njeri me nerva, me sedër, se kam punuar pa hile. A kam faj?»

«Po edhe ke» — sikur i fliste një zë. Zëri vazhdonte akoma dhe i thosh:

«Ti këtë e prisje, në mos Diana një tjetër do të vinte në vendin tënd. Dhe pse do vinte, ti duhej t'i bëheshe **barrikadë?**»

«Po. Fundja dhe unë njeri jam, m'u duk se më poshtëruan.»

«Ty të kishin thënë sa herë për shkollën!»

«Po sedra, sedra ime?»

Dhe zërat vinin e përziheshin, e bënin me faj, e nxirrnin të pafaj, e revoltounin kur i thoshin «i pandërgjegjshëm», e qetësonin kur i kujtonin se njerëzit, kur s'thellohen, dhe mund të gabojnë, por kjo s'do të thotë se ata nuk i duhen shoqërisë. Jani përherë ja kujtonte këtë gjë.

Fletërrufetë, që po viheshin çdo ditë e më shumë në stendën e madhe në hyrje të uzinës e që kritikonin kryeinxhinierin, shefin e repartit të monti-

mit, i cili ishte një punëtor mjaft i mirë, apo shefin e prodhimit e sa e sa të tjerë, e vunë më tepër në mendime Hekuranin. Ato fletërrufe çdo mëngjez i ngjanin si pikëpyetje e i thoshin: «Hë, Hekuran, mos e ke dhe ti gabim?» Dhe sa më tepër ditë kalonin, aq më shumë ai i jepte të drejtë Janit. Vërtet kur Diana, Samiu e ndonjë tjetër vinin e bisedonin me të për punën, me vështirësi e ngrinte vështrimin nga tornua, po në vetëvete ndjente se i vinte mirë, ardhja e tyre ja zvogëlonte fyerjen që i kishin bërë. E megjithatë e kish të vështirë të bënte hapin e parë, të linte mënjanë sedrën e sëmurë.

Një ditë i vajti pranë Diana. Në dorë mbante një detal. Priti sa ai largoi thikën nga metali dhe i tha ta shihnin bashkë atë detal, me që dyshonte se mos ai ish shkaktar i difekteve të vazhdueshme të maqinës metalprerëse

Hekurani mblodhi supet. Por dhe Diana u tregua kokëfortë.

— Ja, — tha — pa u tërhequr, — shiko, është konsumuar kjo pjesë.

Ai zgjati dorën, por mendoi se do t'i ndalej zemra, aq të vështirë e pati. E vështroi detalin.

— Ka mundësi — tha me gjysmë zëri dhe e la mbi torno. Diana s'levizi nga vendi.

Përsëri ai e pati të vështirë, por mundi ta detyronte veten. Tha:

— Hajde ta shikojmë. — Shkoi bashkë me të duke menduar se fundja kryente një detyrë, kurse Dianës iu duk se gozhda e lëndonte më pak. Ajo e dinte se edhe pas buzëqeshjes së Samiut, apo përsëndetjes së Demit, fshihej diçka si e ftohtë, e akullt. Por, sidoqoftë lëkundja kish filluar.

Në sallë hyri Demushi tërë gaz e tha se nga reparti i montimit u dërgonin përshëndetje revolucionare.

—E dini si e bënë ata? Si ylberi pas shtrëngatës!
— tha Samiu.

Deri dje brigadieri i montimit u ish kërcënuar se do ta shtronte çeshtjen në kolektiv, në rast se reparti mekanik nuk e dorëzonte porosinë brenda ditës. Ata të mekanikës kishin punuar gjithë pasditen. Dhe ja tashti dëgjonin përshëndetjet revolucionare të atyre të montimit.

Niku filloi të shfrente e të thoshte se mirë ua bënëin deri sa kishin arritur t'i trembnin, por Samiu i tha se po gabonte. Nëse kishin dërsitur, këtë e kish kërkuar puna dhe jo kërcënimi. Puna duhej kryer. «S'ke ç'i bën. Pa dërsitje s'ka kënaqësi» kësh-tu tha Samiu dhe i bëri me shenjë Janit ta ngac-monte Nikun. Vetë u nis për në drejtori. Pastruesja i tha se e kërkonte drejtori. U nis pa qejf; i kish marrë inat mbledhjet. Sidomos kur zgjatëshin.

Drejtori ishte në qejf. I shtrëngoi dorën Samiut dhe i tregoi karrigën.

— Punët shkojnë mirë, apo jo? — i tha.

Samiut iu duk sikur dëgjoi t'i thosh «S'dyshoj asnjëherë se mund të shkojnë keq». E dinte se drejtori kish shumë besim tek ai. Këtë e kishin kuptuar dhe të tjerë. Në prak të Kongresit, kur Samiu diti të organizonte njerëzit, t'i mobilizonte për të punuar pa u kursyer e të dilnin faqebardhë, drej-tori në mbledhjen e organizatës ishte shprehur se ai i kish shokët të rrallë.

— Veç atij mos ja thoni — i tha me takt Lamja. — Ç'është e vërteta, i pëlqen pak vetja...

— Njeri pa të meta s'gjen, të metat do t'ja luftojmë, se për aftësitë e tij s'ke se ç'thua! — nguli këmbë drejtori.

Por vërejtjen e Lames e pati parasysht. Ay nuk i tha asgjë Samiut, por mënyra si i fliste, si i rrihte krahët, pyetjet që i bënte, tregonin qartë konsideratën që kish. Dhe Samiu mundohej me çdo mënyrë mos ta humbte këtë konsideratë dhe s'kursehej. Ku t'i thoshin shkonte për të ndihmuar, punonte me orar e pa orar.

Ra zilja e telefonit.

— Mirë, mirë, Todi. Si thua?

Drejtori i bëri me shenjë Samiut që të mos mërzitej.

Këtij iu kujtua Bukra, që në një mbledhje të rinisë, kish thënë fare pa ndroje. «Dhe përkëdheljet e drejtorit apo të ndonjë tjetri nuk i bëjnë mirë Samiut».

— Epo me të ai s'shet mend — ish hedhur dikush — dhe drejtori e di se Samiu është i përsosur nga çdo anë, si shpikjet që bën.

Disa kishin qeshur. Samiu ishte ngritur me rrëmbim e kish thënë se shokët ngatërronin dy gjëra: përgjegjësinë me fodullëkun. Ai ishte përgjegjës i repartit dhe Esati duhej ta dëgjonte.

— Por urdhëri yt nuk ishte i drejtë, ish në dëm të punës. Po ti s'deshe të na përfillje. Do të bëhet si them unë, the. Ç'do të thotë kjo?

— Të biesh në dashuri me veten — kish thënë një i ri, ngadalë.

Samiut s'i kishte ardhur mirë që i riu e kishte vështruar drejt e në sy sikur t'i thoshte «e ç'ke?»

Dhe të gjithë sikur donin t'i thoshin: «S'ke të drejtë, Sami».

Drejtori uli receptorin.

— E di, — tha duke u drejtuar nga Samiu, — na kërkoni një porosi urgjente. Sigurisht plani, plan. Ti e kupton. Por... sidomos në këtë kohë, kur anëmbanë Shqipërisë premtojnë e zotohen, ne a duhet të mbetemi pas?

Që t'i thoshte jo, këtë s'e bënte Samiu, t'i përgjigjej se do ta bisedonte me shokët, sesi iu duk.

— Do të mundohemi — tha dhe mendoi se dhe copë të bëhej vetë, fjalën s'mund t'ja kthente.

— Uh, harrova — tha drejtori.

Samiu pa si i shkëlqyen sytë dhe dëshëroi të ish ai shkaktari i atij gëzimi që u shfaq papritur te drejtori. «Mos vallë e kanë parë propozimin tim?» mendoi. Por drejtori i tha se ata të ekipit gjeologjik kishin mbetur tepër të kënaqur nga shokët e repartit, që kishin mundur t'i nxjerrin nga një hall i madh duke prodhuar një detal të pazëvendësueshëm.

Samiu nuk e dha veten, por i tha drejtorit se ai detal i kish futur në siklet. Ishte një detal i ri për të cilin gjeologët kishin shumë nevojë. Punëtorët entuziastë siç ishin kishin vendosur ta provonin. Një pasdite të tërë, tre-katër veta ishin marrë me atë punë.

Kur iku nga drejtori, i vinte inat me veten që s'ja zuri në gojë çështjen e propozimit të tij. Shkoi në byronë teknike, por i thanë se inxhinieri, Petrua, kishte shkuar në repart. E gjeti duke biseduar me Dianën, që se ç'i thoshte plot gjallëri. Samiu s'u foli fare. Dhe Petrua bëri sikur s'e pa. Ndoshta për inat të Samiut, ai seç i përshpëriti Dianës e ata qe-

shën të dy. Pastaj Diana iku me hap të shpejtë, duke thënë:

— Lashë Janin pa punë.

Që nga axhusteria Samiu vuri re se si ajo bashkë me Janin jepte e merrte për të ngritur një trup maqine. I erdhi mirë që e kish lënë inxhinierin në atë mënyrë e ndoshta për këtë arsye shkoi pranë tyre dhe u ndihmoi. Kur trupi lëvizti e ata po fërkonin duart, ai sikur të fliste për diçka të zakonshme, tha se gjeologët ishin të kënaqur prej tyre.

— E ç'ma shqyen atë gojë si çorape — iu drejtua Janit me të qeshur. — S'duhet të dehemi nga sukseset.

— Për vete e ke të qartë këtë? — ja priti Jani. — Po ta kesh, je i fituar. — E thuajse të ishte kujtuar për diçka, e zuri Samiun prej mënge.

— More, tallesh me mua ti?

— Mos je bërë për t'u tallur? — pyeti ai dhe nisi të ikte.

Diana e Jani i shtrënguan duart njëri-tjetrit, sepse edhe ata kishin punuar për atë detal. Dikush u kish thënë se bënin punë të kotë, se ajo që po bënin do t'u thyhej menjëherë gjeologëve, por ata s'ishin tërhequr. Kishin dy ditë që prisnin me frikë e plot dyshim të dëgjonin një fjalë për detalin që kishin prodhuar. Herë u dukej se ishin turpëruar, herë se s'kishin punuar kot. Atë çast që Demushi kish prurë përshëndetjet e repartit tjetër, ata kishin kujtuar se u kish ardhur ndonjë lajm nga gjeologët. Dhe ja Samiu u vjen e, sikur të thosh gjënë më të zakonshme, tregon se gjeologët ishin të kënaqur.

— Dëgjuat apo jo? — thirri Jani. — Gjeologët na përshëndesin. Detali hyri në punë.

Pastruesja me fshesën e hekurt në dorë grumbullonte mbeturinat e thosh: « Eh, ç'djema që kam unë!»

— Dhe vajza, nënë Hurma! — i tha Jani.

— U të keqen nëna! — tha ajo. — Na është mësuar goja.

Jani mori lopatën nga karroca që shtynte ajo.

— Të të ndihmoj se është e rëndë, nënë Hurma.

Lopata mbushej me ato hekura pa vlerë e Diana shihte si, një pjesë e tyre, hidhej në karrocë. Nga anët rrëzoheshin copa të ndryshme metali e binin mbi grumbullin që po pakësohej. Lopata i rrëmbente përsëri dhe prapë nga anët binin copa me shkëlqime të ndryshme e tërë ndryshk.

Diana kish humbur në mendime.

— Ç'ke kështu? — pyeti Jani që ish me qejf.

— Shikoi ato. Mbeturinat... ti i rrëmben me lopatë por ato s'të binden, bien prapë. Dhe ti përsëri i rrëmben, e përsëri...

— Po ja, do të vijë fundi e s'do të mbetet asgjë — tha Jani tërë gaz.

— Pa fshesë s'vjen dot fundi. Dhe shiko si janë, ka të ndryshkura, ka të shkëlqyeshme...

— Të ndryshkurat bëjnë «mu-u». Por dhe këto të ndritshmet do t'i marr. Mbeturina janë. E di? Erdhi një vizitor një ditë në repartin tonë. «Sa bukur duken këto ashkla si ngjyrë qehlibari» — tha. E mori një prej tyre në dorë. Dhe nuk e bëri veten. Ashklën e lëshoi përtokë, kurse dorën që iu pre e fshehu në xhep. Unë e pashë e qesha. E bukur por të ther, apo jo, Dianë?

KAPITULLI VII

Kur vajzat po bëheshin gati të pushonin, erdhi Jani dhe u tha se i ftonte të gjitha sa ishin në kinema. Shfaqej një film që të shkulte së qeshuri. Ai fillonte në orën 5.30, prandaj ato duhej të bëheshin gati.

Lumja në atë kohë po pastronte çizmet në banjë. Kur shoqet i thanë të vishej, ajo deklaroi se i dhimbte koka e se do të rrinte shtrirë.

Diana e Bukra shikuan njëra-tjetrën dhe u ngrysen.

— Do të pish një aspirin e koka do të të shkojë — i tha Bukra pas pak.

— Nuk mundem — ngulte këmbë Lumja. — Nuk jam mirë. — Hoqi çorapet e u bë gati të futej në krevat. Në derë u duk Rina.

— Ç'më rrini kështu? — u tha ajo vajzave, që ishin ulur e heshtnin. — Hajde shpejt se do të kthehem dhe pak në dyqan. Po ti ç'ke? — i tha Lumea, që u shtri në krevat.

— Ç'ka? E ç'të ketë? Mbeturina në kokë dhe ajo i dhemb. Hajde të shkojmë. I pëlqen të flejë, le të flejë — tha Bukra e u ngrit me inat.

Kur dolën jashtë, Bukra, pa nguruar fare tha se Lumja s'vinte në kinema nga që kish frikë nga Niku. Ai kish shkuar në zbor dhe kushedi ç'porosira i kish dhënë. Bukra sa s'po hante veten nga inati. I shfryu dhe Janit, ai dhe ata të dhomës së tij nuk ishin shokë të mirë, përderisa Niku ish i mbytur nga mbeturinat.

Bukra kish vendosur t'u propozonte djemve që, pas filmit, të mblidheshin në sallë e të këndonin ndërsa Esati do t'i binte fizarmonikës, por ja prishi planin Lumja. Vendosën të ktheheshin e t'ja tregonin qejfin asaj, por, kur hapën derën, e gjetën duke qarë. Vajzat ngritën supet e u ulën pranë saj. S'dinin ç't'i thoshin. Pritën mes ajo vetë u hapej, por Lumja, me sytë mbi batanije, i pyeti në u pëlqeu filmi.

Ato iu përgjegjën shkurt se u kishte pëlqyer. Ra përsëri heshtja, që e mërzi të së tepërmi Bukrën.

— Epo na thuaj, de, ç'pret, të t'i nxjerrim me darë?

Në atë kohë dikush trokiti vetëm një herë dhe e hapi derën me forcë. Vajzat panë Nikun me vetulla të ngrysura, me vështrim të rreptë, që qëndroi te dera, si i kapur në befasi. Pa i përshëndetur, i tha Lumes të dilte jashtë se kish pak punë me të.

Dianën dhe Bukrën e hutoi jo vetëm shfaqja e tij e papritur, qëndrimi i ftohtë që mbajti ndaj tyre, por edhe toni me të cilin fliste. Ato për një moment pritën që Lumja të ngrihej, por s'ndodhi kështu. Lumja as që ja hodhi sytë. Atëhere ato të dyja muarën frymë lirisht.

— Po të pres jashtë — tha Niku përsëri ashpër.

Lumja nuk foli. Para se të mbyllej dera e jash-
tme, i tha që të mos e priste.

Ai mbeti në mes të korridorit. U afrua te dera
e dhomës. Sytë iu errësuan, si qielli me stuhi. E
përmbajti veten dhe me zë të plotë gërthiti.

— Hajde, dëgjo ç'të thonë!

— Nuk vij — përsëriti ajo.

Ai e lëshoi dorezën.

— Si?

— Nuk vjen! — thanë me një gojë vajzat, që
kishin marrë zemër nga përgjegjja e Lumes.

Pas kësaj u dëgjua një përplasje e fortë, hapa
të rëndë në korridor e një përplasje tjetër e portës
së jashtme.

— Ç'ja punove! — thiri Bukra. — Shiko, s'ma
mbushje synë, por... Bukur ja punove, se është bërë
kaposh fare, si një pronar me shkop në dorë,

— Kështu janë gjithë burrat, — tha Rina.

Lumja ishte bërë dyllë e verdhë në fytyrë.

— Mos është më mirë të shkoj... kushedi... —
tha me zë të ulët.

Bukra mezi e mbajti veten.

— U trembe! E ç'do të të bëjë? Do të të lërë?
Po pati atë kokë, ç'të duhet edhe ty. Prapa djellit
të shkojë.

— Pa prit — i tha Diana, — në rast se kjo ka
faj, të shkojë. Kokëfortësia në të tilla raste s'është
e mirë.

— Sikur s'e njeh atë ti!... E ç'faj të ketë kjo?

Lumja heshtte. Kur Rina u largua, ajo, duke i
mbajtur me zor lotët e duk kafshuar buzën, sikur
të copëtonte me dhëmbë një hidhërim të thellë, u
tregoi se Niku e kish fyer, ai e kish akuzuar sikur
ajo e kish kurdisur tërë punën e kinemasë, se ajo

i kish degdisur shoqet që të mbetej vetëm... Duke u ktnyer nga zbori kish parë Sokolin në oborr e ish bërë si i tërbuar. «Pranoje që e keni bërë me fjalë — i thosh. — O pranoje, o s'ka».

Lumja heshti. Vajzave thujse u kish ngrirë vështrimi në fytyrën e saj.

— E ç'jam unë? — vazhdoi Lumja me zë të mekur. — Si mund t'i shkojë mendja kaq për keq?..

Ajo mezi i nxirrte fjalët. Dukej sikur do t'i zihej fryma.

Pastaj heshti dhe mendoi se do të kish bërë mirë po të kish shkuar me shoqet në kinema. Ai do t'i kish bërtitur, por s'do ta kish fyer në atë mënyrë.

Diana dëgjonte Lumen. Si ishte kjo punë! Përse djemtë kishin kaq të drejta mbi vajzat? Përse ata kapeshin pas çdo hollësie të së kaluarës dhe e përmendin atë orë e pa kohë, kurse vajzat... Jo, ajo s'kish dëgjuar ndonjë vajzë të fejuar që të rrinte e t'i kërkonte llogari të fejuarit. Kish të drejtë Rina që thosh «s'kuptojnë se kemi të njëjtat të drejta».

Para se të vinte në uzinë, Lumja ishte ngatërruar me Sokolin, që tashti punonte si normist në një repart tjetër. I kish pëlqyer ai si njeri gazmor që ishte, por dashuria e tyre s'pati jetë të gjatë. Sokoli mezi priste të takohej me të, i shkëlqenin sytë kur e shihte, por në çdo takim ai ja pëlçiste zemrën vajzës, i thosh se ajo s'dinte të dashuronte.

Lumja heshte. E kuptonte se ç'kërkonte ai, por nuk e bënte veten dhe i thosh se ajo ashtu ishte. Në çdo takim e shoqëronte një frikë e një dyshim. Një ditë, për ta provuar i tha atij të bënte jetën e

tij, kurse ajo ish gati ta priste. Kur të donte ai, le ta kërkonte për t'u fejuar. Dhe kish shtuar:

— Në rast se ti më do, atëhere dhe do të më kërkoksh — Ajo nuk ja tha të gjitha fjalët që kish menduar sa e sa herë se Sokoli ja dha gazit.

— Sa kalama — tha ai. — Dhe çudi, kështu s'të jep përshtypjen! Vërtet, Lume, të mos kesh dashuruar ndonjëherë tjetër ti?

Vajzës i ngriu vështrimi.

Ai vuri buzën në gaz:

— S'qenkemi për njëri-tjetrin, Lumel!.

Ajo e kish vështruar me shpresë, por kish dalluar një ftohtësi që s'e kish vënë re asnjëherë në fytyrën e tij. Pas kësaj prapë kish shpresuar se mos ai e kërkonte, por shpejt e kish kuptuar se priste më kot. Për dashurinë e tyre askush nuk kish ditur gjë. Po Lumja ishte e sinqertë. Që ditët e para të fejesës, si shumica e djemve, edhe Niku e pyeti Lumen nëse kish dashuruar ndonjë tjetër. Dhe ajo ja tregoi gjithë historinë. Ai kish ngrysur sytë. Ish hequr si i mërzitur. «Përse, sikur kushedi ç'kam bërë» i tha ajo Bukrës atë mbrëmje. Bukra ja preu shkurt:

— Patjetër do të ngrysej. Le të ketë bërë vetë sa të dojë, përsëri do të ngrysej. Kështu janë djemtë, prandaj hiç mos të të vijë keq. — Por Lumja kish tjetër natyrë. Dhe sa herë Niku ngrysej, errësohej e gjëmonte si moti me shi, asaj i humbiste shkëlqimi i syve. Niku ishte i pamëshirshëm dhe i dukej se çdo gjë Lumja e bënte për Sokolin. Për të vishej, për të krihej, për të hidhte vështrimet andej-këndeje. Prandaj ajo duhej të ecte drejt, s'duhej të shikonte andej nga ishte Sokoli. Një ditë Niku bile e akuzoi se duhej të kish pasur marëdhënje dhe me

ndonjë tjetër dhe s'deshi ta dëgjonte fare kur iu betua se rasti me Sokolin kishte qenë i vetmi.

— Ti mos bëj kështu — i tha Diana. — Po dridhesh e tëra. Kur ai ka faj, mirë bërë që s'shko-ve. Që të verë mend!

— S'është kollaj... Ja, më la...

Diana lexoi një frikë të madhe në sytë e shoqes. U mendua ta qetësonte, i tha se Niku s'ishte i tillë. Por dhe në rast se e linte, udhë e mbarë i goftë. Jeta është e gjatë. Sa njerëz të mirë ka për-reth. **Përse ta ngushtonte kaq shumë jetën?**

— Të isha unë, e kisha lënë vetë — tha Bukra.
— Nuk e sheh? Ja burrë, ja s'ka!..

Diana e kundërshtoi. I tha se s'duhej të ishte kaq e prerë, se në jetë do të ketë dhe mosmarrë-veshje dhe se për zgjidhjen e tyre duhej gjetur një rrugë. Bukra i tha se ishte kundër kompromisit.

— S'është puna për kompromis, por për sheshimin e këtyre mosmarrëveshjeve — ja priti Diana

— Mirë kur ato janë të imta, si grimca rëre... Por, po t'i ngjajnë shkëmbinjve me gurë...

— Edhe guri lëviz, Bukra.

— Pra ti thua, Dianë, që të durosh e të nën-shtrohesh?

— Jo, e pse të durosh? Të mbash qëndrimin që duhet. Unë s'jam kategorikisht kundër ndarjeve, por s'pajtohem me ty që thua: «Kaq të më thotë burri, unë e le». Po a ka mundësi që dy njerëz mos t'i thonë kaq njëri-tjetrit? Ja, shoqe jemi e po hahemi.

— Sa për mua a, që kam për t'u martuar. Ohu, duhen vite që mos të ndihet pushteti i burrit! Unë s'dua t'i nënshtrohem kërkujt. E urrej nënshttrimin, e kupton?

— Oh, kjo koka jote krenare — tha Diana me të qeshur — do të vuajë ca!..

Në dhomë ra sërish heshtja. Dikush këndonte nga jashtë e melodia gazmore s'pajtohej gjëkund me atë atmosferë të nderur. Diana atë kohë e kup-toi se i ish larguar ajo ndjenjë e hareshme e gëzu-ar që kish provuar gjatë mëngjezit.

«Ky fanatizëm! Këto zakone!» — mendoj «Dhe sa kohë duhet që të çrrënjosen?» Dhe, sikur të ishte kujtuar për diçka, iu drejtua Bukrës që dukej te-për serioze e i tha se ajo ishte kontradiktore.

Tjetra vrejti vetullat, Diana vazhdoi:

— A të kujtohet si më qortove atë ditë? Dhe unë e pranoj. Bëra gabim që s'e përmbajta veten e ika nga reparti. Ti më ktheve e në darkë më qor-tove. Me të drejtë. Unë s'desha të më fyenin, të nën-shtrohesha, kurse ti më the se ajo që bëja unë ishte tërhqje. Po kjo tjetra nuk është tërheqje?

— S'po të kuptoj plotësisht.

— Po ja, në këtë rast ti pranon largimin nga fronti i mos marrëveshjeve.

Bukra vuri buzën në gaz.

— Tjetër kjo, tjetër ajo. Këto janë çështje personale, ato të përgjithshme, kështu që zgjidhen në mënyra të ndryshme. Pastaj, se harrova... Në rastin tënd do të isha e ofenduar, e nënshtruar, po të ikja. Mua kështu më duket... Atëhere do të thoshin njerëzit «S'ja doli dot», kurse në këtë rast do të thonë: «Ajo ja del dhe vetë». Dy gjëra që s'mund t'i vësh në një kandar.

— Sidoqoftë, të ndahesh për gjëra të vogla... Si të të them, Bukra. Jam kundër.

— Për të vogla, thotë! Kush thotë për të vogla?

Por kur burri do të të bëjë urë, ku do të shkelë këmba e tij, siç thonë këndeј nga ne, dhe nuk bën asnjë tërheqje, atëhere të lutem... E si t'i bindesh?

— Unë s'them që t'i bindesh, por të bindësh atë që s'ka të drejtë.

— Po ja që ai s'bindet — nxitoi Bukra të flasë.
— Vajza duhet të durojë?

Diana për një çast s'diti ç'të thoshte. Mblodhi supet, pastaj foli:

— Varet nga vajza.

— E po për atë them dhe unë. Se, fundja, kur djali e shikon se mbetet vetëm rruga e ndarjes për të zgjidhur mosmarrëveshjen, në rast se të dashuron, e vë gishtin në kokë.

Ky mendim e ngrohu Lumen. Ajo i dha të drejtë Bukrës. Në rast se Niku e donte, s'kish si ta linte. Dhe ajo ishte e bindur se ai e donte.

Gjithë atë natë mendoi veç për këtë: si do të vinte e nesërmja dhe ajo do të kalonte pranë tij pa e kthyer kokën. Kur ai ta ndalte, do t'i thosh... Por si do t'ja thosh që ajo s'i duronte akuzat e tij, se kish vendosur të ndaheј? Ç'do të bënte Niku? Deri këtu ndaleshin mendimet e Lumes.

KAPITULLI VIII

Xhipsi frenoi mu te shkallët e godinës së stacionit të trenit. Diana rrëmbeu borsën, përshëndeti shoferin e vrapoi për në biletari. Donte dhe pesë minuta që të nisej treni, por ajo arriti të zinte një vend të mirë në vagonin e dytë midis disa vajzave e djemve. I kishin dhënë katër ditë leje e ajo kish vendosur t'i kalonte me prindërit. Kur përpara saj filluan të fluturonin fushat e kodrinat, të vraponin shtyllat e pemët tërë gjelbërim, iu kujtua ajo ditë dimri me erë e të ftohtë kur udhëtonte me një vagon si ky bashkë me katër shokët e tjerë vullnetarë. Njëri nga ata i binte kitarës. Ajo qeshte e këndonte. Në vagonin e tyre vajtën dhe të tjerë, dëgjonin këngën e të rinjve, këndonin bashkë me ta. Diana ishte aq e gëzuar, tamam si në ato çaste në aksion kur kompania do të merrte flamurin... Një copë herë ajo kish dëgjuar tingujt e ëmbël të kitarës, zërin e plotë të shokëve e, duke vështruar panoramën, që ndërronte çdo minutë, ëndërronte shokët e ardhshëm, uzinën, jetën që do të kalonte. Tashiti i vinte për të qeshur tek i kujtonte ato ëndrra dhe i dukej vetja si të kish qenë një çupë e vogël

E ulur në kolltukun e trenit, me vështrimin tretur në hapësirë, ajo po e kuptonte se s'kish pasur kohë të mendonte për ditët që po jetonte, për ditët që iknin dhe gjithmonë sillnin diçka të re. Diana mendoi se sa boshe do t'i dukej jeta sikur çdo gjë të arrihej lehtë e lehtë. Po të arrihej çdo gjë lehtë, sdo të kish as synime në jetë. Këto arësytetime e kthyen te një mendim, që kish filluar t'i lëvrinte kohët e fundit dhe s'po e linte të qetë. Ishte një ide që i kish lindur ashtu papritur një ditë tek po bisedonte me Bardhin në dhomën e vogël, ku punohej për nevojat e ekspeditës gjeologjike. Bardhi i kish thënë se gjeologët ishin ankuar, pobjeditët s'kishin gjithmonë një lartësi dhe i tregoi një koronkë. Diana e vështroi me vëmendje dhe vrau mendjen si të shmangej ai difekt. «Po sikur?» u mat t'i thoshte Bardhit. Por mendoi se po nxitohej, se këto gjëra nuk zgjidheshin aq lehtë, se duheshin menduar e stërmenduar mirë. Dhe që atë ditë iu vu punës. Hapi libra e dispensa, bisedoi me një mjeshtër të uzinës për disa çështje teknike, hartoi skica, por përsëri e brente dyshimi. Dhe ajo s'merrte guximin t'ja thosh dhe Bukrës, pa le të tjerëve. Sa herë që hynte në dhomën e vogël, ku punohej për gjeologjinë e dëgjonte goditjen e çekiçit mbi pobjeditin, i dukej sikur mendimi i saj qartësohej gjithnjë e më mirë. Por përsëri ngurronte. Këtë ngurrim, megjithëse më të zbehtë, e ndjente dhe atë çast tek rrinte e sodiste fushat e gjelbëra. Para dy ditësh ajo dhe shoqet e saj kishin parë një film dokumentar për punëtorët e një uzine në Tiranë, që kishin bërë një shpikje të rëndësishme, dhe kish diskutuar me Bukrën për të. Diana i kish thënë se shpikësit duhet të jenë njerëz të guximshëm, sepse

ja s'u doli? «Dhe pastaj?» — ja kish kthyer Bukra. «Turpërohen». «Duhet të jesh me sedër të sëmurë, në rast se mendonkështu. Po të niseshin të gjithë me këto mendime, atëhere s'duhej të prisnim asnjë shpikje e asnjë racionalizim». Diana kish heshtur. Me mend i kish dhënë të drejtë Bukrës, por... E megjithatë Bukra kish të drejtë... Ngurrimi i saj ish punë sedre.

Treni fishkëllente, linte stacionet njëri pas tjetrit, dhe asaj për një moment iu duk si e pabesueshme që këta vagona me rrota dhe lokomotiva me ulurimën e llahtarshme po e largonin me kilometra nga shokët, nga tingujt metalikë, nga «Ndërtesat» plot ajër e dritë. «Çfarë bëjnë vallë tashti?»

Diana s'ishte e qetë. Për një moment i ngjau vetja se po nisej për në provim. Diçka e brente në kraharor. Tamam si në ato çaste kur kthehej nga aksioni e shihte nënën me lule në duar që i buzëqesh-te. Kurse këtë herë s'do ta priste asnjë njeri. Këtë herë i dukej vetja si një Dianë tjetër, më e madhe, më e rritur.

Ecte përmes stacionit të mbushur plot e s'mund të shkëputej nga ajo ndjenjë e çuditshme. Njerëzit shpejtonin; boritë e taksive s'pushonin. Pranvera kish ardhur me kohë në Tiranë dhe i kish dhënë lule, gjelbërim, shkëlqim. Diana e hoqi pardësynë. Apartamentet e larta te unaza, çarçafët e bardhë nëpër ballkone, autobuset e taksitë bojëqielli e ndezën më tepër mallin e saj dhe ajo e emocionuar mbërriti te stacioni i maternitetit. Pastaj iu duk sikur rëshqiste dhe ajo bashkë me autobusin në rrugën e gjerë pranë vitrinave e reklamave. Dhe i vinte çudi që s'po takonte asnjë të njohur, që askush nuk e vështronte me kureshtje, që askush nuk e dinte nga po vinte. Autobusi u dynd me njerëz e asaj

s'po i besohej se po i afrohej atij stacioni aq të dashur. Por minutat fluturojnë. Dhe Dianës sa s'po i merrej fryma tek ngjitte shkallët për në katin e tretë. Dhe as që mund ta besonte se ishin bërë katër muaj që kur nuk i kish ngjitur ato shkallë

* * *

Atë mbrëmje shtëpia u mbush plot me njerëz. Të gjithëve u vinte çudi që Diana kish ndryshuar aq shumë. Djali i tezes, duke qeshur, i thoshte se ai me kënaqësi mund ta merrte në shoqërinë e tij. Ta kish enda ta dëgjoje Dianën tek fliste. Pa le ç'ngjyrë kish marrë.

Pastaj ërdhën vajzat e pallatit që i kish patur edhe shoqe shkollë. Të gjithëve u dukej Diana e rritur, e pjekur.

Vonë, kur mbeti me të atin e të ëmën e me motrën e vogël, iu duk sikur kish folur shumë, më shumë se sa duhej, ndaj, si fajtores tha se ishte bërë llafazane e madhe, por e kish marrë malli tepër ndaj dhe fliste aq shumë. Babai i ledhatoi flokët e i tha se ajo kish folur ashtu siç i pëlqente atij dhe se ai e ndjente veten të lumtur, kurse nëna mundahej të fshihte lotët. — Sot e kuptova se më ike përgjithmonë... — i tha ngadalë. — S'i rritim për vete, — u përgjegj babai. Nëna tundi kokën. Motra e vogël e vështronte Dianën, sikur të shihte heroinën e një përralle të bukur, të dashur, që e kish dëgjuar vite më parë.

— Natën e mirë! — i tha ajo dhe e puthi në faqe. — Të gjitha shoqet e pallatit flisnin për ty sot... Kur të mbarojmë shkollën, do të dalim që të gjitha vullnetare.

Kështu kaluan katër ditët për Dianën, si në ëndërr. Në ato katër ditë ajo kuptoi se asgjë s'mund ta shkëpuste nga uzina në kantierin e largët, se s'mund ta kuptonte jetën pa ato telashet e përditshme, pa shqetësimet e gëzimet që i jepte puna. Dhe iu shtua me tepër dëshira për ta përfunduar skicën e pajisjes. Duhet të bisedonte me Bukrën, me Janin, ndoshta dhe me Samiun. Kish mundësi që ai të qeshte kur ta dëgjonte. Por edhe sikur të qeshte, ç'do të humbte Diana? Idenë s'mund ta rrëzonte vetëm një e qeshur e Samiut. Se ajo nuk ish pa baza. Ajo ishte e realizueshme. Jo vetëm e realizueshme, por shumë e thjeshtë.

Një natë para se të nisej, i foli babait për atë çka mendonte dhe nga shprehja e fytyrës së tij kuptoi se s'kish asgjë për të qeshur, as për t'u tallur. Babai dëgjonte me interes.

— Unë pak marr vesh nga këto, por ti bise-
doje dhe me shokët. Ata do të të ndihmojnë.

Sytë e babait ishin seriozë. Ata shprehnin besim. Jo, nuk kishte asnjë shenjë ngurrimi në fytyrën e tij. Babai kish besim, le të ishte vajzë, ai kish besim. Dhe Dianës iu duk se kish rrëzuar një mur të madh që vazhdimisht i bënte hije.

Atë ditë që u kthye në kantier, ajo mezi priste sa të takohej me Bukrën. E, pasi u çmall me të, mori një fletore vizatimi që e mbante në komodinë dhe i tregoi çfarë kish skicuar.

— E po ç'pret? Pse nuk e provon? — i tha Bukra.

— Desha të bindesha plotësisht.

— Pa prova zor të bindesh, prandaj duhet të fillosh. Unë të shihja që më kishe rënë në men-

dime dhe s'po e kuptoja ç'kishe. Po kjo... thosha.

Diana qeshi; e ndjente veten të lehtësuar.

— Si thua — e pyeti përsëri, — mund të dalë?

— E pse mos të dalë?

Bukra heshti, e vështroi Dianën me kërshtëri dhe i tha:

— Do që ta paraqes unë këtë propozim?

Dhe qeshën të dyja.

* * *

Të nesërmen mbrëma u mblodhën të gjithë te salla e kinemasë. Kishte ardhur grupi artistik i teknikumit për të dhënë shfaqje. Diana kish krehur me kujdes flokët dhe kish veshur një kostum të lehtë që i rrinte pas trupit. Kur rregullohej para pasqyrës, iu duk se i kish rënë një nur i ri dhe kjo e kënaqi, e bëri tërë qejf e muhabet.

— Janë zbukuruar vajzat tona — tha ngadalë Bardhi tek i pa të afroheshin. Samiu që i kish vënë re më parë, i tha Bardhit t'i ftonte të rrinin me ta. Qëndruan mbi një çerek ore në oborrin e kinemasë duke dëgjuar Gimin që u tregonte subjektin e një drame që kish vënë në skenë teatri popullor kohët e fundit. Dikush tha se, në Durrës, shokët e Adem Rekës kishin shkruar një dramë për atë, Ademin.

Pastaj ata, ashtu grup, siç ishin, zunë vend në radhën e tretë. Diana padashur ish ulur ndërmjet Samiut e Rinës. Bukrën e kish larg, ajo seç bisedonte me Janin dhe qeshte. Diana e vështroi e ngrysur. «Ç'më le kështu?» thoshin ata sy. Por

Bukra i buzëqeshi. Samiu nxori ca shënime nga xhepi e filloi t'i lexonte. Diana mendoj se do të kalonte një mbrëmje të mërzitshme. Por kur filloi shfaqja, Samiu, që me bisht të syrit e shikonte si vinte ajo buzën në gaz, si dëgjonte e përqëndruar, apo e gëzuar, kthehej nga ajo e i thosh: «Bukur, ë?» «S'është keq?» «Sa mirë recitoi!» Vajza tundte kokën sikur të ishte dakord me të gjitha ato që thosh ai. Ndonjëherë ja plotësonte me fjalë të tjera mendimin. Dhe i vinte mirë që Samiu shfaqte interes kur ajo fliste.

Në një pjesë të shfaqjes, kur po luhej një skeç i dobët e bajat, ata nisën një bisedë tjetër. Ai dëgjonte me vëmendje. Kështu iu duk Dianës. Në një moment ai nuk ja shqiti sytë edhe pasi Diana pushoi së foluri. Vajza e ndjeu veten ligisht, por diçka sajoi e foli përsëri. Sidoqoftë, asaj iu duk se aty në karriget e kinemasë ata të dy padashur kishin rrëzuar një perde, që i pengonte ta shihnin mirë njëri-tjetrin. Dhe ashtu e entuziazmuar, siç ishte nga ky mendim, ajo vendosi t'i thoshte Samiut për pajisjen.

— Sigurisht, është vështirë ta kuptoni tashti, sidomos në shfaqje — tha ajo.

Ai buzëqeshi. Dianës i erdhi çudi që dhe sytë e tij këtë radhë shkëlqyen.

— Bisedojmë nesër për këtë — i tha ai.

Ajo e ndjeu veten të qetë e të gëzuar. Në këtë gjendje u kthye dhe në «Ndërtesa».

— Sa e bukur je bërë sot — i tha Bukra, kur ajo veshi këmishën e natës, — me këta flokë të zez.

Diana buzëqeshi dhe e përqafoi Bukrën.

— Je një ti... — i tha, — do të më bësh qejfin se më le vetëm. Sikur shumë po të shoh me Janin!...

— Ashtu? E po dëgjo: e para, unë s'di të bëj qejfe. Desha të rrija pranë Janit dhe ndejta. Sa për atë që thashë po ta përsëris: sot je e bukur.

Atë po mendonte në atë çast dhe Samiu. Atje, në gjysmerrësirën e sallës, fytyra e saj iu duk e mrekullueshme. Sytë me bisht e vetullat e ngri-tura e afronin me një artiste të një filmi që kish parë kohët e fundit. Dhe Samiu mendohej të gjen-te cila ishte ajo artiste. Në një çast, ndërsa Diana i fliste pa ja ndarë sytë, atij iu duk se i shihte për të parën herë ata sy. Deshi të përqëndrohej në shfaqje, por ata sy s'e linin të qetë, ata sy fshih-nin në shqetësim dhe herë shkëlqenin, herë errë-soheshin. Atij i pëlqente të mendonte se ja kish shkaktuar ai atë shqetësim. Po a mund t'ja shkak-tonte ai, po të donte? Ato të tjerat për të cilat i flisnin tezet, hallat, kushërirat apo shokët, sa herë shkonte në Tiranë, s'ishin të këqia. Nja dy ishin dhe me universitet, një ish arësimtare... Dhe ato s'kishin asnjë kundërshtim, veçse të donte ai. Po ato dy vajzat nga fabrika, që i hidhnin aq vësh-trime, dhe ato s'ishin keq. Atëhere, përse kjo të mos e pëlqente?

Mendimet e tij shkuan edhe më larg. Për një moment kujtoi se, po të donte ai, Diana menjë-herë do t'i shkonte në takim. Një shok i kish thënë: «Ruaju nga vajzat... Ato aty e kanë mendjen, të fejohen, të martohen... Vishen e zbukurohen që të gjuajnë... Ruaju, Sami!». Dhe përsëri ai shoku i kish thënë «Vajzat janë kapriçoze, dëgjon? Ki kujdes. Se kapriçoja e tyre të merr më qafë, është si grep...» Samiut iu kujtua qëndrimi i ftohtë, vështri-

mi krenar i mëparshëm i Dianës e mendoj se ai shoku s'kish folur keq. E kujtoi përsëri Dianën, kujtoi sytë e saj që shkëlqenin dhe errësoheshin. Kaq! S'arriti të mendonte gjë tjetër. Jani e shtyu me bërryl dhe i tregoi Nikun që, i shtrirë, lexonte një libër.

— E pres kokën — tha Samiu — në ka kuptuar dy fjalë nga ato që lexon.

— Atë mendje ka, — vazhdoi Jani. — I kam thënë unë, është anadollak.

Niku e hiqte veten se s'i bënte përshtypje asgjë nga ato që thoshin shokët e vazhdonte të lexonte.

— Më tha Bukra — tha Jani — se Lumja ka vendosur të ndahet.

— Dhe mirë ja bën — ndërhyri Hekurani. — Mor, na zinte frika dhe ne kur donim t'i flisnim Lumes, se i vrenjtej balli këtij si qielli me shi.

— Hë, çuna! E patë si rrinte, Lumja? Ish ulur pranë nesh e qeshte, s'donte t'ja dinte fare, as që e ktheu kokën të shihte nga ishte i nderuari shoku ynë.

Niku ktheu faqen e librit dhe e hoqi veten sikur të mos ishte fare në atë dhomë, por kur Jani vazhdoi të thoshte se Lumen kush s'e merte, ai përplasi librin te komodina dhe i thirri të pushonte.

— S'dua të pushoj! — iu përgjegj tjetri.

Atëhere ai u ngrit, veshi këpucët e doli jashtë.

— Se mos mbytesh në lumë — i tha Bardhi, ndonse Niku përplasi derën.

Të nesërmen kish punë vullnetare. Aq shumë punëtorë s'kish parë Diana ndonjëherë në oborrin e «Ndërtesave». Ata mbanin në dorë kazma, lopata, tezgja dhe flisnin me zë të lartë. Në një grup biseda kish marrë zjarr. Drejt e aty shkuan Bukra e Diana dhe dëgjuan Nurçen që thosh se inxhinieri e kish gabim, që ngulte këmbë ta bënin lulishten tre metra të gjërë. Ajo të bëhej e madhe. Të viheshin dhe stola. Pse, sa për stolë do ta bënim? Po nja dy djem u hodhën:

— Mos duhet të ngremë dhe një shatërvan?

— Dhe rreth e qark ta shtrojmë me çimento. Këtu e ke fjalën? — pyesnin me të tallur.

— Pse jo, dhe me çimento mund ta shtrojmë — ndërhyri një vajzë.

— Shokë, — thirri njeri nga djemtë — po statujën e Venerës ku do ta vëmë?

— Pse ju duket e tepërt? — tha Nurçja — Sikur punojmë në çaire të beut! Këtu do të kalojë jeta jonë, pranë kësaj uzine. Ndaj dhe lulishten për vete po e ngremë.

— Për vete, për vete, o Nurçe, por sa ke jorganin, aq shtriji dhe këmbët. S'është koha e zbukurimeve. Të plotësojmë një herë nevojat.

Jani nuk ish i këtij mendimi. Ai mori anën e Nurçes; ndonjë fond i veçantë s'kërkohej për lulishten: djemtë do të sillnin plisat, vajzat do të pastronin sheshin, do të punonin bashkërisht; pa dhe stolat vetë do t'i bënin. Për çimento ishte fjala? Epo pak çimento do të gjendej, se s'bëhej kiameti.

Diana e Bukra hidhnin vështrim sa andej këndeje, dëgjonin me vëmendje, por s'flisnin; e ndje-

nin se ishin me Nurçen, ndaj u buzëqeshnin mbrojtësve të tij.

— Jo, s'e ka keq Nurçja — tha edhe Lamja. — Çdo gjë duhet parë me perspektivë.

Ai seç tha dhe diçka tjetër, që i bëri të rinjtë të buzëqeshnin.

— E pse jo? — vazhdoi ai. — Dhe për fëmijët e ardhshëm duhet të mendojmë, të caktojmë dhe për ta një vend. Perspektiva.. gjithmonë perspektiva. Mirë thonë shokët, çdo gjë është në duart tona... Hajde ikim tashti, të fillojmë menjëherë.

— Vajzat të pastrojnë sheshin — urdhëroi Nurçja, — djemtë të shkojnë për plisa.

— Ja, këtu e prishe, o Nurçe! — Përse i ndan vajza e djem?

— Po thashë mos të lodhen, megjithëse...

Ai hodhi sytë nga Bukra e qeshi. Iu kujtua si e kish bërë ajo të dërsinte para disa muajve në hapjen e tarracave.

— Gabim, gabim — tha.

Vajzat muarën nga një lopatë në dorë dhe u nisën drejt lëndinës, që gjelbëronte. Pranë kishin Lamën.

«Por Samiu vallë ç'mendon?» i shkoi në mend Dianës.

Zëri i qetë i tij e bëri atë të ngadalësonte hapat. Ai i thosh Janit:

— E sheh? Të duket sikur ka fjalë pak, por të fut në të thella ky Lamja. Si tha? Ecim me perspektivë. Bukur e tha...

Papritur, Dianën e pushtoi një gëzim i paprovuar.

Hodhi vështrimin rreth e qark dhe mendoi
«Po, këta janë shokët e mi.»

Natën, kur ra të flinte, s'po e zinte gjumi.

Ajo që përfytyronte i ngjallte një ndjenjë, një
si mall të largët. Ndoshta në atë qytezë, rrëzë
kodrave, mund të ngrihej foleja e saj e përhershme.

KAPITULLI IX

Pas disa ditësh Samiu e pyeti vetë Dianën për atë idenë që i kishte lindur. Ai kish pritur që vajza të vente dhe t'i thoshte të bisedonin, ashtu siç e kishin lënë atë mbrëmje, por ajo s'po jepte asnjë shenjë. Ç'ish e vërteta, ajo s'tregohej më aq e përmbajtur me të, qeshte më çiltër, nja dy herë ishte ulur bashkë me Bukrën në tavolinën ku hante ai dhe bisedonte për gjëra të ndryshme, Megjithatë Samiut i dukej se nga fytyra e saj kish humbur ai vështrim i shqetësuar. Vetëm thëniet e shokut të tij për vajzat kapriçoze e ngrohnin, sikur i thoshin: «asaj i pëlqen shoqëria me ty, po s'do ta japë veten». Ky mendim e shtyti ta pyes-te për propozimin që kish ndër mend të bënte ajo, lidhur me koronkat. Diana po lante duart kur e pyeti ai. Ishin në pushimin e mëngjezit. Ajo ktheu kokën nga Samiu dhe ai pa si iu çel fytyra. U duk se e priste këtë çast. E lanë që të bisedonin pas punës për pajisjen. Dianën në një çast e kapri ai ngurrim që kish provuar ditë më parë, iu duk se Samiu do të tallej me të, por kjo i kaloi shpejt dhe kur mbaroi turni shkoi në zyrën e tij.

Samiu e ftoi të ulej. Ai dukej i qeshur dhe në qejf. Në përgjithësi gjithë ato ditë ashtu kishte qenë. E pyeti se çfarë kish menduar. Diana nguli vështrimin mbi letrën, që mbulonte tavolinën, ku ishin shkarravitur disa figura të çrregullta gjeometrike e nisi të fliste për pajisjen. Dukej se ai po e dëgjonte me interes. Por pa mbaruar ajo, ai ja preu fjalën dhe e pyeti se sa muaj ishin bërë që kur kishte ardhur. Pastaj tha se njeriu nuk e kupton si ikën koha.

Diana buzëqeshi.

— Dhe e mban mend si u përleshëm njëherë?
— pyeti ai.

Ajo e vështroi në heshtje.

— Ti ike me vrap...

Ajo i ngrysi vetullat dhe Samiu pa si iu errësua balli. S'dinte ç't'i thoshte që t'i sillte gëzimin e parë. Por Diana foli vetë:

— Gjëra që ngjasin — tha — por njeriu ka këtë të mirë, që i kupton shpejt gabimet. Megjithatë kur shkel mbi to, ai ndjen se diku i dhëmb. Unë atëhere s'i njihja shokët.

— Janë të mirë.

Dhe për të hapur një muhabet tjetër, Samiu i tha se edhe Niku zemrën e kish të mirë, të pastër.

— Ç'të pastër — tha ajo, — a mund të jetë e pastër kur është e mbushur me mbeturina?

Biseda kaloi në një temë tjetër, të zakonet, te burrat që e heqin veten si pronarë, te letrat e popullit drejtuar partisë.

Samiu vështroi orën.

— E sheh? Mensa po na mbyllet, dhe ne s'bëmë

asgjë. Vijnë pasdite e skicojmë diçka; një ide sikur e krijova dhe unë.

Diana s'iu përgjegj. I erdhi inat me veten. Përse kish ndenjtur e dërdëllisur një orë e ca dhe s'e kish prurë fjalën aty ku i rrihte mendimi? Ato dy ditë ajo kish jetuar me idenë e pajisjes. Tashti që kishte ardhur rasti, s'kish arritur të bënte asgjë. Diana u ngrit me një brengë nga karriga. Pastaj u kujtua se pasdite kishte provat e korit. Dhe e lanë të takoheshin përsëri të nesërmen. Në mensë gjetën vetëm makarona.

— Vetë e keni fajin — u tha kamarieri. — Kisha një rosto sot...

Ndërsa ktheheshin te «Ndërtesat», takuan Janin dhe e bënë së bashku rrugën. Samiu buzëqeshi në një mënyrë të çuditshme. Kur u nda Diana prej tyre, Jani i kërkoi atij një cigare dhe pasi e ndezi i tha se Diana nuk ishte nga ato vajza që mund të kujtonte ai.

Samiu vuri buzën në gaz.

—Të gjitha vajzat njëlloj janë — tha. — Pastaj ti ku e di se si kujtoj unë.

— E po unë po ta përsëris dhe një herë: s'është nga ato vajza, dëgjove?

— Pse e ndan nga të tjerat? Si gjithë vajzat të thashë, me zemër, me ndjenja.

Jani e vështroi me inat.

Rrugën e bënë në heshtje. Nuk qëndruan as përpara reklamave të filmit, siç bënin sa herë, as u kthyen të shihnin volibollistët. Hynë në dhomë të vrejtur. Bardhi që në vështrimin e parë i kuptoi se ishin ngrënë.

S'u foli fare por u ngrit e hapi radion. Dhoma u mbush me zërin e Vaçe Zelës.

Pastaj Bardhi, sikur të ish kutjuar për diçka, e pyeti Samiun përse kish mbetur vetëm në mensë.

Ky i foli për paisjen që kish menduar Diana, ja tha këtë në një mënyrë, që e detyroi Bardhin të thoshte:

— Bravo, bravo, qenka me pretendime!

Jani, sikur të ish pregatitur më parë për këtë sulm, nuk e la të vazhdonte.

— E pse të mos jetë? — tha. — Punon më mirë se ti? Punon. Të kujtohet si qeshe para disa muajve? Pse s'qesh edhe tashti? Prandaj s'ka pse të mos jetë me pretendime.

Samiu vuri buzën në gaz e me përtim tha. se njerëzit në përgjithësi maten të hedhin një hap më shumë se të tjerët. Por sa ja dalin! E sidomos vajzat që sa kanë hedhur hapat e para e u duhen vite të tëra që të barazohen me djemtë në këtë fushë.

— Po fakteve u beson? — pyeti Jani, pa e shikuar fare.

— Sigurisht, ka edhe përjashtime. Eshtë edhe Diana një përjashtim? Ndoshta! Veçse nuk e kemi dalluar. Që punon, punon, që ka vullnet, ka, që e njeh punën e saj, e njeh. Por kjo s'do të thotë të jesh përjashtim.

Jani s'ja zgjati më këtë bisedë.

— Më mirë mbylle atë radion, o Bardhi — tha.

Samiu mori një libër mbi komodinë. Në dhomë sikur hyri spikeri i radoi-Tiranës dhe lajmëroi se mbaronte koncerti me muzikë të zgjedhur.

— Mbylle! — thirri prapë Jani. — Hap dhe ti librin. Të premtën kemi formën, mos e lërë për ditën e fundit.

Samiu u nis për në zyrë në orën e caktuar, i bindur se Diana për diçka do të kish menduar. Por kjo s'përjashtonte mendimin se kërkesa e saj për ndihmë mund të ishte një shkak për t'u afruar. Dhe Diana, si çdo vajzë, kish zemër, kish ndjenja. Pale se ç'thoshte Jani! Përse idenë e saj ja kish thënë vetëm atij. Samiu solli ndër mend ditët, orët, minutat që kish kaluar apo që kish qëndruar në shoqërinë e saj. Ndodh shpeshherë me njerëzit të mundohen të grumbullojnë fakte në favor të vetes, ndaj edhe ai kujtoi si i kish buzëqeshur ajo njëherë, si e kish ftuar bashkë me Janin në tavolinë, kur hante bukë. Pastaj kujtoi mbrëmjen para dy muajve dhe iu duk se s'duhej të dyshonte aspak në simpatinë e saj. Asaj i pëlqente shoqëria e tij.

Kur arriti në zyrën e byrosë teknike, ku e kishin lënë për t'u takuar, Samiu pa orën dhe nuk i erdhi mirë që ajo s'kish ardhur. Hodhi vështrimin përtej dritares, në rrugën, që, si kordele gri, zgjatej deri te «Ndërtesat», por Diana s'po dukej. Kaluan dhjetë minuta. Hapat e saj akoma s'po dëgjoheshin. Filloi të mërzitej. Por edhe vonesën e saj deshi ta kuptonte ashtu siç i pëlqente, ndaj mendoj: «Vajzat kështu e kanë, aq më tepër që ajo është ca kapriçioze.»

Kur u hap dera, ai vuri buzën në gaz. Kish menduar se Diana do të vishte një nga ato fustanet që i rrinin aq bukur, kurse ajo nuk i kish hequr kominoshet. Hyri e qeshur; në dorë mbante disa skica.

— Ulu, — i tha Samiu dhe po habitej me vete se si nuk e kish vënë re më parë se sa e

mirë ishte. Edhe me kominoshe dukej tërheqëse. Faqet i ishin skuqur.

— Ishim në fushë, po luanim voliboll, — foli ajo.

— Di të luash mirë?

— Kam qenë në skuadrën e shkollës, s'jam keq.

— Ai u bë gati ta pyeste përsëri, por vajza mori lapsin në dorë e, me një ton sikur të qërtonte dhe veten dhe Samiun, tha:

— Tashti të fillojmë se do ta bëjmë si dje.

Ai s'foli. Tërhoqi një skicë. Por përsëri pyeti për diçka tjetër. Ajo iu përgjegj shkurt. Ai vështroi skicën. — Po këto shenja ç'janë? — tha.

Diana e shikoi si e hutuar. Pikërisht për ato shenja i kish folur pak më parë. Megjithatë ja shpjegoi përsëri. Samiu e kuptoi se s'po përqëndrohej dot. Kur heshti Diana, u zgjat për të marrë skicën tjetër. Padashur dora takoi atë të sajën. Vajzës as që i bëri përshtypje; tha se e shqetësonte çështja se si do të dilnin ashklat. Vrimat s'duhej të ishin më të mëdha, mbasi puntua mund të thyhej.

— Ta mendojmë — tha ai.

Po në të vërtetë nuk po mendonte për puntot, as për koronkat. Shtriu krahun dhe ja mbuloi dorën me dorën e tij. As vetë nuk e kuptoi se si e bëri, por ja që e bëri dhe ai nuk kish si të vinte përsëri gjithshka në vend. Diana e hoqi me rrëmbim dorën nga e tija dhe u ngrit nga vendi. Samiu u zverdh, tha se do të rrëzohej. Jo! Ajo nuk e shtyu, as nuk e pështyu, nuk i tha asnjë fjalë. Veç ata sy! Duhej t'i shihje ata sy, atë vështrim për ta dalluar tronditjen e saj. Ai s'dinte ç'të thosh. Ajo rrëmbeu skicat dhe iku, në fillim me rrëmbim, pastaj hapi i saj u ngadalësua deri sa u ndal. Samiu

akoma s'po e mblidhte veten. Po kur hapat s'po dëgjoheshin më, atëhere u zbeh edhe më tepër. Mendoj se Diana do të kish hyrë në zyrën e sekretarit të partisë. Doli te dera dhe i erdhi inat me veten, kur e pa atë para stendës së madhe, thujse lexonte me interes fletërrufenë që ishte shkruar. Në të vërtetë ajo e kish shumë vështirë të mblidhte veten. Po mos të kish qenë aty në korridorin e uzinës, do të kishte qarë ose do të kish bërtitur. as vetë nuk dinte ç'do të kishte bërë, por diçka patjetër do të kish bërë. Kur ndjeu se i kaloi ai të kuq që i përcëlloi faqet, u nis për në «Ndërtesa». Gishtërinjtë shtrëngonin me forcë skicat. Për një çast desh i grisi, po iu duk se do të vepronte tamam si atë ditë, kur ishte larguar me vrap nga salla. Ky kujtim e bëri të përmbliidhte veten.

Në anën tjetër të rrugës vuri re një grup djemsh, në mes të të cilëve dhe Janin. Ata e përshëndetën. U mundua t'u buzëqeshte, po iu duk sikur e kuptuan që u shtir; nxittoi hapat, thujse vrapoi. Nuk donte të takonte asnjë njeri. Kur hapi derën e dhomës, e ndjeu veten të çliruar.

«Përse të ndodhë kështu? Mos vallë vajzat janë vetëm që të dashurojnë, të martohen e të lindin fëmijë? Pse, kjo është e gjitha?»

Në derë dikush trokiti. Ajo u ngrit, u mundua të përmbliidhte veten dhe u drejtua për në korridor. Sikur ta kish parandjerë që ishte Jani!

Vështrimi i këtij ishte i shqetësuar. Ai ngutej të pyeste për diçka.

— Hajde brenda — tha ajo me zë të ulët.

Ai shkoi pas saj pa folur, si i trembur.

— Nuk është Bukra? — pyeti po me atë shqetësimin e parë.

Ajo e kuptoi se ai kot pyeti për Bukrën. Uli kokën, ndjeu se u skuq.

— Se ku shkoi me Rinën. Kishe punë? — i tha.

Ai, sikur të ishte fjala për diçka tjetër, i tha me padurim:

— Ç'thotë ajo pajisja jote? E pa Samiu?

Dhe nuk ja shqiti sytë. Ai vështrim e tronditi më tepër Dianën. E ndjeu veten të këputur, por nuk deshë të tregojë. Mblodhi gjithë fuqitë për t'u treguar e qetë.

— Isha në voliboll dhe u vonova. Samiu nuk më kish pritur.

Buzëqeshi si fajtoreshë dhe u pendua që e gënjeu në këtë mënyrë. Më mirë të ish përgjegjur as ashtu, as kështu. Jani mund ta pyeste Samiun. E shikoi përsëri sikur t'i kërkonte falje. Jani hoqi shpejt vështrimin nga ajo, mori një revistë, që ish në tavolinë, dhe me zë të qetë, fare të qetë, tha:

— E di, Dianë? A nuk e shohim nesër bashkë e i themi dhe Esatit, e po deshe dhe Hekuranit?... Të na ndihmojë dhe inxhinieri.

Diana uli sytë. Jani diçka kish pikasur. Dhe asaj nuk i erdhi mirë. Por i pëlqeu që ai i jepte dorën, që ishte një shok i mirë.

Nuk arriti t'i përgjigjej. Jani u drejtua për te dera:

— Natën e mirë, Diana!

Ajo vetëm belbëzoi. Qëndroi ashtu e mbështetur te tavolina dhe dëgjonte hapat e rënda të Janit në korridor. Ato hapa sikur shkelnin mbi një brengë... Por ja, u zhdukën. Çliroi grushtet që kishin shtrenguar fort tavolinën dhe hapi dritaren për të sjellë në dhomë zërat e mbrëmjes së qytetit, që tanimë

ish bërë edhe i saj. Dikush qeshte fare pranë dritares. Pastaj zhurmat u shtuan, sikur përreth asaj dritareje gumëzhinte vetë jeta. « E pse fyhesh ti? — sikur i thosh një zë i brendshëm. — Ti e tregove veten, kurse ai...». Por një zë tjetër përgjigjej me rrëmbim: «Pse të shohë tek unë femrën, vetëm femrën?!.. Përse?!..»

Kur hyri Bukra, iu duk sikur dhoma u freskua. Gëzimi i saj sikur u derdh nëpër dhomë. Bukra ishte bërë tepër simpatike me një triko blu saks që kish veshur e që i shkonte me sytë e kaltërt. Ajo fliste me duar e me këmbë e tregonte se kish-te parë Nikun me Lumen. Ishin ulur te shkallët e klubit e ai seç i fliste duke qeshur. Lumja e dëgjonte duke vënë buzën në gaz. Dhe Bukrës i pëlqeu si dëgjonte Lumja. Kish një shprehje të vendosur në gjithë qëndrimin e saj.

— Veç ta shikoje, moj Diana! Po si thua, të jetë lëkundur dhe Niku, apo tregohet ashtu? Mëgjithatë, e shikon ç'do të thotë të mbash qëndrim? Se edhe tjetri të çmon nga qëndrimi që mban.

Dianës iu duk sikur i tha për të ato fjalë. Ajo kish vendosur të mos tregonte se çfarë i ndodhi, ndaj shtirej e qetë, por këto fjalët e fundit i rënduan. «Mos ajo vetë kish dhënë shkas të mendonte Samiu keq për të? Ç'kish bërë ajo? Mos e kish tepëruar me fjalë atë mbrëmje kur dha shfaqje estrada?»

Sytë iu ngrysën. Vështrimi i mbeti te cepi i tavolinës. Bukrës iu duk si një fëmijë i gjetur në faj. Mendoi çfarë mund ta shqetësonte atë aq tepër, sikur t'i kishin lënduar një plagë. Iu kujtua se ajo duhej të bisedonte me Samiun për paisjen.

—E, ç'tha ai? —pyeti.—E patë paisjen?

— Nuk e pamë — u përgjegj ajo me një frymë.
— U vonova. — Ndjeu se po skuqej. — Dhe më vjen inat që ai kish ikur. Ti, Bukra, ke zakon që ja thua tjetrit, por atij mos i thuaj gjë. Do ta shoh me Janin e me të tjerë nesër. Veç dëgjon? Me Samiun s'duhet të bisedosh.

— E pse, të bisedoj? Për t'i rritur mendjen? Nuk erdhi, s'do t'i lutemi. Shumë mirë ke merduar. Bisedoje me çunat nesër.

— Dhe me ty, Bukra, — tha Diana duke vënë buzën në gaz.

E ndjente veten disi të lehtësuar kur mendonte vendimin që kish marrë. Do t'i tregonte Samiut se aq i bënte për mendimet që ai kish në kokë dhe se këto mendime nuk mund ta zmbropsnin nga rruga e nisur.

* * *

— Shkojmë t'jua shpiegoj konkretisht — u tha Diana shokëve me një farë sigurie.

Pajisja që propozonte ajo do të përmirësonte cilësinë e do të shpejtonte punën në dy procese. Vari skicat në mure e me një shufër hekuri nisi të tregonte. Pastaj priti se ç'do të thoshin ata. Në fillim i hodhi sytë me ndrojtje sa nga Lamja te xha Ristua, nga xha Ristua te Gimi, pastaj mori kurajo. Vështrimet e shokëve ishin të përqëndruar në ato skica të zbeta, që akoma s'kishin marrë formë. Një shkëndijë gëzimi shkrepiti në sytë e saj. Ktheu kokën nga Esati dhe i erdhi mirë që edhe ai shqetësohej për të njëjtën gjë që shqetësohej dhe ajo.

— Ashklat si do të dalin? — tha Esati. — S'ka frymëmarrje.

— Pse? Edhe mund të dalin — tha Gini. Puntua nuk është e lëmuar, por e filetuar.

— Sikur të bëhen vrimat më të mëdha? — tha dikush.

— Oh, jo! — u përgjegjën disa njëherësh. — Do të thyhet puntua.

Për çudinë e të gjithëve u dëgjua zëri i Hekuranit. Diana për një çast u drodh, por u qetësua shpejt. Ai tha se ashklat mund të dilnin.

— Thirreni edhe Samiun — tha Esati.

— Nuk është — u përgjegj dikush. — Ka shkuar në byronë teknike.

— Njëlloj si Samiu, si ne — tha Lamja.

— Kam një mendim — vazhdoi ai. — Sikur të merret Jani me këtë punë. Ta shikojë bashkë me Dianën.

Kur u shpërndanë të gjithë, xha Ristua e kapi nga krahët Dianën.

— Të lumtë vajzë! — i tha. — Kjo kohë që erdhi ju bëri njësoj si djemtë.

Ajo buzëqeshi. I erdhi mirë që shokët e dëgjuan me vëmendje, që shfaqën interes. Të ishte ndryshe, s'do ta pyesnin e s'do të shqetësoheshin për ashklat. E ç'rëndësi kish vetëm një Sami kur të gjithë sëbashku shprehën besim? E ç'rëndësi kishte ç'mendonte ai? Këta njerëz që po shpërndaheshin e që bisedonin akoma për pajisjen, nuk shihnin tek ajo vetëm «femrën».

Jani buzëqeshi e i tha:

— Çdo gjë në rregull, Dianë. Sikur e shoh me sy puntun që rrotullohet brenda në pajisje.

«Ti je i mrekullueshëm,» deshi t'i thoshte

ajo, por vetëm vuri buzën në gaz. I pëlqeu që ishte aty, që pranë «Ndërtesave» ishte një lumë dhe që frynte erë, aq shumë erë në atë vend. Po Samiu? Le të mendonte ç'të donte ai. Megjithatë asaj i erdhi inat me veten që ishte gati ta falte.

E pa Samiun kur hyri të zverdhur e pak si të hutuar. «Ndoshta e humbi për një moment? Këtë tregon edhe shprehja e tij» mendoi. Por një zë tjetër, dhe ky zë ishte i fortë, i thosh:

«Lëri sentimentalizmat. Njeriu duhet të jetë i fortë, i arësyeshem. Dhe arësyeja s'duhet të mbytet nga asnjë ndjenjë.» Nëna i kish thënë njëherë se kish kaluar pyllin me një shok partizan.

Dhe ajo i mbyti gjithë zërat, që nisinin e ligjëronin kur shihte lëvizjet e ngathëta të Samiut, përgjegjet që u jepte shokëve, gjithë qëndrimin e tij.

Kur shkuan të hanin në mensë, ata u ndodhën përballë njëri tjetrit. Ai deshi ta largonte vështrimin, po ajo s'e bëri veten, e përshëndeti sikur të mos kish ndodhur gjë. Ai shtangu në vend. Vetëm për një moment iu çel fytyra dhe i buzëqeshi Janit.

— Të isha unë, as që t'i kisha hedhur sytë — i tha Jani, — U mendua ca e përsëri vazhdoi: — Mirë bën, mirë bën. Ajo përshëndetje ishte tamam sikur të të thosh: «As që të vë në hesap ty».

— Përditë një avazi do t'i biesh! — u inatos Samiu.

— Ke nevojë ta dëgjosh.

Atë mbrëmje, si u largua me hap të rëndë nga Diana, Jani u sorollat pothuaj një orë të tërë sa e gjeti Samiun.

— Ti je hajvan! — i shfryu sa e pa.

Samiu u skuq:

- Ç'ke?
- Por besoj se s'të doli gjë.
- Nuk të kuptoj.
- E marr me mend...

Jani heshti dhe Samiut i erdhi mirë. Ndjente një zbrazësirë në vetëvete që s' kish provuar asnjëherë. Mendohej ta bindte veten se, fundja, s'kish bërë asgjë për t'u futur në mendime kaq të thella, por ai vështrimi i rreptë i Dianës, ata sy, po i krijonin një ndjenjë boshllëku e mosbesimi në vete. Jani, pa u thelluar shumë, qëllonte pa mëshirë, duke ja shtuar akoma më shumë zbrazësirën. Dhe kish dy ditë të tëra që s'pushonte. Ja edhe tani vështroi Samiun e qeshi:

— Si the? «Moment që s'mund të kalojë». Ha-ha-ha! S'mund të kalojë? Lëri këto dokrra e vëri gishtin kokës. Sidoqoftë — tha me ton serioz, — ti s'duhet të rrish mënjanë. Do të të keqkuptojnë. Gjithë shokët e përkrahën propozimin e saj.

Samiu nuk foli. Por pas dy ditëve, kur do të provonin pajisjen që Diana e Jani kishin bërë gati, ai hyri në dhomën e koronkave. Qëndroi në një vend nga nuk mund ta dallonte ajo. Megjithëse vështronte vetëm profilin e saj, Samiut iu duk tepër e emocionuar. Mënyra si e hidhte vështrimin sa nga njëri te tjetri e theksonte më tepër emocionin e saj.

— Të thashë një herë — tha Diana. — S'dihet...

Zëri i doli si i huaj. U ul në fronin e lartë, hodhi edhe një herë vështrimin nga shokët që prisnin, ndezi motorin dhe afroi pajisjen pranë puntos. Filloi ai rrotullim që të merrte sytë. Dhe ndodhi ajo së cilës i trembeshin të gjithë: puntua u këput. Diana u zverdh në fytyrë.

— Një punto tjetër! — thiri Jani. — Ishte e vjetër kjo.

Dhe përsëri ai rrotullim. Diana u mbyt nga djersët. Kur po mendonte me një farë shprese se s'kish ndonjë sforcim, puntua u këput përsëri.

— E ka fajin kjo — tha Jani dhe e mori pajisjen, — nuk e kemi bërë si duhet.

Diana s'foli. As Lamja. As Esati. As Hekurani. Të gjithë heshtën e filluan të shpërndahen. Asaj i erdhi keq që ata u shpërndanë pa thënë asnjë fjalë. Vetëm Lamja u afrua e u tha Dianës e Janit, që rrinin pa folur se kështu e kishin provat, s'mund të dilnin menjëherë dhe u tregoi se edhe me tranxhën kështu e kishin pësuar. Pas një jave prova u kish dalë me sukses.

— Të kujtohet? tha Lamja duke u kthyer nga Samiu, i cili dukej tepër i zbehtë.

Vetëm atë kohë Diana e vuri re Samiun. Dhe nuk i erdhi mirë. Dhe Samiu sesi e ndjeu veten, sikur ta kishin mbërthyer nga gryka.

— Ashtu është — tha me gjysmë zëri dhe iku.

Më vonë i tha se asgjë në këtë botë nuk është bërë menjëherë. Teksa kish parë puntun që rrotullohej e gërryente metalin brenda në pajisje, ai po bindej se mendimi i Dianës nuk ishte i keq. Bile ishte mendim interesant. U thye puntua? Kjo s'donte të thoshte gjë. Pajisja ta mbushte mendjen. Veçse duhej gjetur diçka që puntua të mos thyhej.

— Mos janë shumë më të gjëra vrimat e pajisjes nga puntua?

— Jo, këtë e kisha parasysh — i tha Jani, — dhe ndoshta nga kjo mos i kam bërë tepër të ngushta.

Provuan punton, por ajo hynte lirisht në vrimat. Megjithatë, Samiu i tha t'i zgjeronte farepak, sa të mos dëmtonin punën. Dhe iku disi i lehtësuar. Diana, që mundohej të mos jepte veten, shkoi pranë Janit dhe priti që ai të thosh diçka. Por Jani s'foli. Ai e çmontoi pajisjen e po kërkonte limën.

— Siç duket, s'është gjë — tha Diana.

Ai e vështroi me qortim:

— Prit. E dashke menjëherë!

Diana nuk e kundërshtoi.

— Po ai ç'tha? pyeti ajo me sy të ulët dhe tregoi me kokë nga Samiu.

— Tha se do të dalë mirë.

E vështroi Dianën e buzëqeshi:

— Edhe unë të them se do të dalë. Ti ç'do?

— Edhe mua ashtu më duket, por... përsëri....

— Për këtë ekziston edhe dyshimi, për t'i futur njerëzit në siklet — tha Jani. — Por kjo do të dalë.

Diana buzëqeshi.

— Kur të mos ketë njeri, atëhere ta provojmë — i tha ajo Janit. — Aq më mirë që aty punojnë me një turn.

Ai tundi kokën.

Në orën dy e gjysmë, kur shokët e tyre u larguan, ata u sorollatën nëpër repart. Bisedonin me punëtorët e turnit tjetër. Kur panë se në oborr s'kish më lëvizje, shkuan në dhomën e koronkave. Diana vuri pajisjen pranë trapanit e do të ulej, kur u hap dera dhe hyri Samiu. Ajo as që ja hodhi sytë.

— Ne s'do të japim shfaqje estrade, Jani, apo jo? — tha me inat.

Samiu u prek, por nuk e bëri veten. Qëndroi,

vështroi nga Jani dhe iu afrua trapanos, ndoqi rrotullimin e puntos dhe, kur ajo u këput, u bë gati të thoshte diçka. Por Diana u tregua më e shpejtë. Ajo, sikur t'ja kishte vjedhur mendimin, tha:

— Mos duhet puntua më e shkurtër? Fare e shkurtër?

— Tamam! — u hodh Samiu i entuziazmuar. — Më e shkurtër, Jani.

Ajo ngriti sytë. Dëgjoi zërin e tij, por s'po e besonte.

— Hë, Jani. — tha ai.

Diana po habitej që edhe Samiu ish po aq i interesuar sa edhe ajo.

Jani e shkurtoi puntën. Dhe përsëri ajo filloi të rrotullohej.

— Më ngadalë, — dëgjoi Diana përsëri Samiun. Ai shihte si rridhnin djersët nga balli i saj.

— Largoju ti! Ma lërë mua! — tha përsëri ai. Por Diana nuk lëvizi. Puntua po gërryente me durim e po zvogëlohej në sytë e saj.

— Mjaft! — thirri Jani.

Dhe ajo buzëqeshi. Ngriti sytë e dalloi te Samiu po atë gëzim që pa te Jani.

— Pritni! — tha Samiu. — Duhet provuar akoma. Një vrimë u hap. Puntua mund të thyhet në tjetrën ose në të tretën. Janë 16 vrima për t'u hapur.

Dhe ata iu vunë provës përsëri.

Kur hynë në mensë, u shkëlqente fytyra. Paks punëtorë gjetën në sallë. U ulën në një tavolinë.

— Duhet të hamë nga tre racione sot, Diana, — i tha Jani.

Ajo e vështroi plot mirënjohje. E kuptoi se edhe

Jani i kish provuar gjithë ato çaste të vështira që kish kaluar ajo gjatë atyre katër orëve...

— Na lodhi — tha ajo. — Duhet të pimë dhe birrë sot, Jani.

— Veç thirre ti kamarierin. Kushedi, të ecën... Pasi sa herë i kam thënë: «Kamarier, na sill edhe birrë», më ngre supet dhe me fytyrë të mërzhitur më thotë: «Më vjen keq, por mbaroi».

Ata qeshën të tre, por birrën e pinë...

Jani, s'pushonte së foluri. Diana dëgjonte e qeshur e tundte kokën, sikur të ishte dakord me gjithshka thosh ai...

KAPITULLI X

Diana ish tërë hund' e buzë. U ul mbi tubat e çelikut, por s'kish dëshirë të hante. Sytë ja kish qepur Ademit, që pa të keq zgërdhihej me Dhorin.

Pak minuta para pushimit, ajo ish afruar pranë maqinerisë së tij, kish marrë një bulonë dhe e kish shikuar me vëmendje. Ai kish vënë buzën në gaz dhe i kish thënë se, me sa dukej, shoqja teknike i kish vënë shënjestrën. Por Dianës nuk i bëri fare përshtypje toni i tij ironik. I tha se bulonat i kish prerë më të mëdha se sa duhej. Ai nuk e pranoi vërejtjen e saj e, për ta bindur se gabohej, mori kalibrin.

— E punë e madhe për një centimetër, -- tha pastaj si pa të keq. — U bë kiameti që bulona është bërë një centimetër më e gjatë?

Diana e vështroi me kërshtëri e s'mund ta kup-tonte si mund të fliste Ademi në atë mënyrë.

— Tallesh, apo e ke me gjithë mend? — pyeti.

— E pse të tallem?

Atëherë ajo iu kthye:

— Ta zëmë se e bëre parvazin e derës së shtëpisë tënde pak më të vogël se dera, ashtu do ta lesh?

Dhe do të jesh i kënaqur? Nuk besoj, mbasi nuk do të mbyllet dera. Do ta prishësh fët e fët e s'do të thuash «punë e madhe». — Ademi sec murmuriste, kurse Diana numëroi bulonat.

— Dhe janë 80 copë. Duhet prerë nga 1 cm. Bëj llogari sa material të shkon dëm.

Ajo u largua. Ademi i tha ndihmësit të tij se, po të ishte ndonjë tjetër, ajo s'do t'ja kish vënë re, kurse atij dhe majën e gjilpërës ja vinte në dukje. E pasi tha këto fjalë, përplasi bulonën përtoqë e shkoi te Samiu. Por dhe ky i tha se teknika e dinte më mirë punën e saj. Ademi, që nuk priste një përgjegje të tillë, u largua i pakënaqur. Dhe kur shihte Dianën pranë, i përplaste tërë inat bulonat në grumbullin e madh. Ajo nuk po e kuptonte përse i mbante mëri. «Duhet të bëhesh e keqe me punën, që të bëhesh e mirë me tërë mend.»

Ademi vazhdonte të përplaste metalin.

* * *

Ishin ditët e fundit të prillit, ditë plot diell. Ngado që hidhje vështrimin, shihje si pranvera kishte shpërthyer me gjithë bukurinë e saj dhe të ndizej një dëshirë të këpusje bisqet në pemët plot gjelbërim, të shkelje mëngjezeve në barin tërë vesë e në pushimin gjysmorësh të uleshe mbi tubat para repartit, nën rrezet e ngrohta të diellit që shkëlqente. Mblidheshin pothuaj të gjithë aty e fillonin diskutonin për të rehat e ditës, pa qeshnin, e ndonjëherë, ja merrnin edhe këngës. Vetëm Samiu dukej më të rrallë. Dhe, kur vinte,

thithte dy-tri herë cigaren, hidhte një vështrim të shpejtë nga ana ku rrinin vajzat e, pastaj largohet me hap të shpejtë. As vetë nuk e kuptonte ç'po ndodhte me të. Ish bërë pak nervoz dhe në çdo hap që hidhte i dukej sikur e ndiqte një hije shqetësimi. Atë ditë, pas mbarimit të provës, tek u ul me Janin e Dianën në tavolinë e dëgjonte bisedën e tyre të çiltër, të përzemërt, iu duk se i therr dikë brenda në kraharor. Pastaj nuk po e ndjente më atë thikë, por një boshllëk të madh në vetëvete, që sa vinte e thellohej. Tamam sikur t'i kishin shqitur diçka nga vetja. Dhe ç'ishte më e çuditshme, kjo gjendje s'po i kalonte. Le t'i thosh Jani se Diana kish pyetur se ç'mendim kish Samiu për paisjen, se asaj duhej t'i kish bërë përshtypje interesimi i tij, se askujt nuk i kishte rënë në sy qëndrimi që ai kish mbajtur ndaj propozimit të saj. Të gjitha këto Samiut i dukeshin si fllucka sapuni. Diçka ish thyer. Dhe ai nuk ishte i qetë. Sa herë ndeshte vështrimin krenar të Dianës, apo dëgjonte përgjegjet e saj të prera, i dukej se boshllëku ishte i madh; këtë gjendje të dëshpëruar ja shtonte edhe inxhinier Petrua që duke vënë buzën në gaz si me tallje, i thoshte: — Nga java mendojmë ta shikojmë edhe atë propozimin tënd. — Atëhere ai shante edhe inxhinier Petron, dhe propozimin e tij, shante dhe Janin po ta kish pranë e i thosh se ai e kish fajin që nuk e kish lënë të shkonte te drejtori.

Po inxhinieri e mbajti fjalën. Të enjten në orën dymbëdhjetë e thirri Samiun e duke vënë buzën në gaz ja hodhi poshtë projektin e paraqitur. Pothuajse pjesa më e madhe e byrosë ishte me inxhinier Petron. Vetëm përgjegjësi i repartit të montimit dhe një punëtor tjetër ngulnin këmbë se,

me disa ndryshime, ajo që propozonte Samiu ishte e realizueshme.

Samiu mezi e përmbajti veten, por nuk ndënji pa thënë se s'kish ç'bënte kur ish i detyruar të binte në duart e disa njerëzve që e shikonin shtrëmbër. Inxhinieri, megjithëse në pamje të jepte përshtypjen e një njeriu nursëz, iu përgjigj fare qetë se ky ishte mendimi i tij. I tha këto fjalë sikur të vinte një pikë të madhe e të mbyllte çdo diskutim. Samiu ja ktheu se as që pyeste për mendimet e tij.

— E kam më se të kuartë... Për këtë ka dhe pëshpëritje... Të ka hyrë në qejf vetja, Sami... Sidoqoftë... — vazhdoi inxhinieri, por Samiu nuk e la të mbaronte.

— S'kam nevojë të dëgjoj më. Më jepni projektin.

Me hap të rëndë u drejtua nga dera. Çështja vajti deri në byronë e partisë të uzinës. Të nesërmen, në stendën e madhe te hyrja e uzinës varën një lajmërim, ku me shkronja të mëdha ish shënuar se atë pasdite në orën 4.30 do të diskutohej propozimi i Sami Belulit. Në lajmërim kaq ish shkruar. Por në fakt të gjithë e dinin si qëndronte puna. Dhe kudo s'bisedohej gjë tjetër, veç për Samiun, inxhinier Petron dhe për mbledhjen që do të bëhej. Vetëm Samiu heshte. Në ato çastë ai mendonte se pa të drejtë i kishin ngrënë hakën, se po mos të zgjidhej si duhej çështja e tij, ai do të kërkonte të largohej. Plot kantiere të tjera kish anembanë Shqipërisë! Fundja ai s'kërkonte të mbronte një çështje thjesht personale, por të lidhur me punën. Ai s'mund ta kuptonte jetën e tij pa ato skica e projekte, pa e vrarë mendjen për të gjetur diçka të re... pa djersë. Kish dërsitur për atë

projekt, kurse inxhinieri me indiferentizëm i thoshte se ishte pa vlerë. Si mund të ishte pa vlerë?

Samiu u nis me Janin për në klub.

Disa metra para tyre ishin ata të repartit: Gimi Diana, Bukra, Esati e të tjerë. Patjetër dhe ata flisnin për atë, për projektin. Por ç'thoshin? Do të ishte shumë mirë sikur ta dinte ç'thoshin ata. Mendimi i tyre do të thosh diçka. Jo vetëm i tyre... Pasdite do të bëhej mbledhje. Samiu në ato minuta e kuptoi se e kish pushtuar një emocion i ri. Ç'do të thoshin vallë shokët? Dhe ai e vështroi Janin pak si i trembur, sikur të kërkonte një këshillë.

* * *

Ai që kryesonte mbledhjen lajmëroi se do të bëheshin njëzet minuta pushim. Menjëherë lëvizën karrigat, u hapën dritaret, tymosën cigaret dhe një zhurmë e madhe pushtoi sallën. Samiu nuk lëvizi nga vendi. Shfletonte fletët e një bloku të vogël dhe seç shkruante në një letër të bardhë. Ndjente një turbullirë në kokë. Mendimet i ishin ngatërruar. Gishtërinjtë i lëviznin me ngathtësi e atij i vinte inat që herë — herë edhe i dridheshin. E futi stilolapsin në xhep e dëgjoi ç'i thosh Esati. Vetëm dëgjoi. S'dinte ç't'i thoshte. Në përgjithësi i dukej sikur i kish humbur fjalët. Pastaj vështrimi padashur iu ndal në profilin e bukur të Dianës. Ajo ish ulur dy rreshta përpara, fare pranë inxhinier Petros e seç i skiconte në një fije letër. Për një moment ajo ja nguli sytë inxhinier Petros, pastaj vrenjti ve-

tullat e filloi t'i fliste. Dukej që inxhinier Petrua s'ishte dakord sepse bëri një gjest sikur t'i thosh Dianës «jo, jo».

Tashti Samiu i jepte të drejtë Janit. Kish bërë gabim të madh që nuk e kish diskutuar me shokët projektin. Po ta kish varur në sallën e repartit e ta kish biseduar me shokët, s'do të ishte zhvilluar kjo mbledhje e ai s'do të kish dëgjuar gjithë ato fjalë që u thanë.

Kur e mori fjalën diskutanti i parë, Samiu filloi të ngrohej. Ai po e mbronte projektin e tij, u ndal në përfitimin që do t'i sillte uzinës ndërtimi i një maqine si kjo që propozohej dhe tha se shumë pak gjëra mund të ndryshoheshin në atë projekt. Duke dëgjuar atë, Samiu e quajti një fat të madh që inxhinieri s'e kish marrë fjalën i pari. Dhe i erdhi çudi që ai s'u ngrit as i dyti. Por i treti që ngriti dorën të fliste që inxhinieri. Samiu lëvizi nga vendi tek dëgjoi:

— Si duket Samiu u deh nga suksesi i konkur-sit e mendon se çdo shkarravinë e tij mund të qu-het shpikje.

Salla gumëzhiti. Samiun e njihnin dhe e çmo-nin të gjithë. Nuk mund të flitej kështu për të. Foli edhe Bukra dhe foli mirë... Theksoi nevojën e diskutimit të projektit me shokët, me kolektivin, gjë që Samiu e nënvleftësonte.

Lëvizën përsëri karrigat, u mbyll dera, presi-diumi zuri vend. Samiu nuk e kish menduar se do të emocionohet aq shumë. Dy orë më parë, kur i thanë të ngrihej e t'u spjegonte të pranishmëve projektin e paraqitur, ai e kish mbajtur veten mirë, kish marrë shufrën e hekurt, e kish lëvizur atë sa nga një anë në tjetrën mbi projektin, kish shë-

nuar diçka me shkumës në një dërrasë të zezë, ish ndalur më tepër në shpjegim aty ku i dukej e arësyeshme, thujse po kryente gjënë më të thjeshtë. Por sa herë që nga presidiumi pyesnin «kush e do fjalën?» atij i dukej se i merrej fryma. Dhe pas çdo diskutimi hidhte vështrimet sa nga sekretari i partisë te drejtori, e pastaj tek inxhinier Petrua.

Kur s'e priste, u ngrit Diana. Dhe ai e vështroi i trembur tamam, siç kish parë Janin dy orë para mbledhjes. Iu duk se i gjëmonin veshët.

Diana ishte dakord me përgjegjësin e repartit të montimit, projekti ishte i vlefshëm pas disa ndryshimeve që mund t'i bëheshin.

Ajo fliste, ndërsa Samiut iu kujtua ajo ditë, kur Diana kish thënë për të: «Ka pse të mbahet më të madh, e mbajnë në pëllëmbë të dorës». Këtë po thoshin pothuajse edhe të gjithë diskutantët. Kur e mori fjalën edhe drejtori, Samiu e kuptoi se s'kishte përse ta gënjënte më veten. Shokët kishin të drejtë. Nuk shfaqti asnjë nervozizëm kur iu përgjegj kryetarit të mbledhjes e tha se ishte dakord që projekti të përpunohej nga një grup shokësh.

* * *

Ishin ulur në verandë të klubit dhe soditnin përdimin.

Diana bisedonte me përgjegjësin e montimit. Bukra kishte marrë inat me Janin e rrinte e zemëruar. Kur ky filloi të bëjë shaka me të, ajo e ndërpreu:

— Përse e ule kokën die në mbledhje kur u ngrita të diskutoja? Se mos do të bëja ndonjë turp?

Jani u shquq dhe u turbullua, por i tregoi të drejtën:

— Sesi më erdhi... Nuk e mendoja se do të ngriheshe, kurse ti papritur e pakujtuar... — ç'do të thotë kjo thashë por ty më të lumtë!

Ajo i ngrysi më tepër vetullat e dendura. Jani e kuptoi se e kish prekur shumë.

— Unë kisha frikë për ty, prandaj... u shfajësua ai. — Ashtu si kam frikë dhe për vete para se të diskutoj.

Ajo e vështroi me dyshim; Jani belbëzoi:

— Më beso, Bukra! — Ajo heshtte; vështronte lumin.

Jani deshi ta thyente atë heshtje të papëlqyer dhe i tha se i vinte keq për Samiun.

Ajo e vështroi sikur të mos kish Janin përpara.

— Kështu nuk tregohesh shok i mirë — i tha. — Kjo mbledhje duhet të jetë një mësim i mirë për të.

— Ashtu është, por.. E vure re si u bë kur foli sekretari i partisë?

Bukra i tha se sekretari i partisë kish folur ashtu siç duhet. Kur fliste ai sikur i thosh edhe asaj: «Folë, Bukra! Teknika nuk është monopol i disave».

— Prandaj i zura me gojë edhe librat që shfletoj — tha ajo — që të mos habiten njerëzit kur na shohin midis tyre duke punuar, duke diskutuar. Njeriu s'lind i ditur.

— Dhe dëgjo Dianën — vazhdoi Bukra — ç'i thotë Vasos. Ka të drejtë. Ne shokët kemi shumë faj. Dhe ti, Jani, në radhë të parë je më tepër fajtor. Kur është fjala për të tjerët, s'përton, u bije kokës, kurse Samiun një herë s'je ngritur ta kritikosh.

Jani nuk iu përgjegj. Vështronte herë Vason e herë Dianën. Mendonte se Bukra kish të drejtë, por fare pak. Sa herë ai veças i kish folur Samiut! Por a ishte e mjaftueshme kjo?

* * *

Një ditë, ndërsa kish zhytur duart në vajin e maqinës, ku punonte Meti, Dianën e thirrën në drejtori. Ajo s'mund ta merrte me mend përse e kërkonin atë me ngut. Po kur te dera e drejtorit pa Lamën, Vason dhe një inxhinier, mendoj se duhej të ishte ndonjë mbledhje për planin. Pas saj erdhën dhe Samiu dhe një punëtor i turnit tjetër, të cilin Dianës ja kishin lavdëruar së tepërmi. Ata hynë me zhurmë në drejtori dhe aty mësuan se ishin caktuar të punonin mbi projektin e Samiut.

Diana në fillim u hutua, pastaj kuptoi se fjalët e drejtorit e kishin gëzuar së tepërmi dhe se ky gëzim e pengonte të përgjigjej. Kur e pyetën: «Ti, Diana, si thua?» iu duk se zëri do t'i shprehte gjithë emocionin që ndjente. Atë e kishin çmuar së bashku me shokët e tjerë, po i besonin edhe asaj.

Sytë i vajtën te Samiu. Po ai vallë të kish qenë dakord me të? Dhe ndjeu se e brente kureshtja për ta mësuar këtë gjë.

Edhe kur i zhyti përsëri duart në lubrifikant, edhe kur përtypte bukën, edhe kur u shtri për të pushuar, ky mendim e ngacmonte. Po të kishte qenë kundër Samiu, do të kish ngulur këmbë dhe Dianën s'do ta kishin caktuar. Projekti donte punë. Nuk ishin caktuar kot aty ata më të mirët, ata që i njihje gjithë uzina. Po përse ja kishin bërë edhe asaj.

këtë nder? Iu kujtua pajisja e saj, iu kujtuan vështrimet e qeshura që i hidhnin ato ditë punëtorët e turneve të tjerë dhe iu duk se më të lumtur nga ajo nuk kish.

Pas dy javësh projekti ishte gati. Dianës i dukej vetja sikur kish dhënë një provim të rëndë. Kish kaluar nëpër duar sa e sa libra dhe aty midis shokësh e kish ndjerë veten mirë. Kish raste që ajo ngulte këmbë në atë që thosh dhe këtë nuk e bënte për kokëfortësi. Hynte lirisht në diskutime dhe nganjëherë jepte mendime të vlefshme. Samiu kthehej nga ajo dhe dëgjonte. Gjithë ato ditë që kishin punuar bashkë, nuk kishin këmbyer asnjë fjalë. Diana, kur ndjente se ai ja kish ngulur sytë, largohej. Ndonjë vërejtje apo mendimi të tij i përgjigjej duke vështruar nga shokët e tjerë. Gardhi që i kish ndarë këtë radhë ishte mpleksur e ngatërruar e dukej se ashtu do të mbetej përherë. Mbaroi projekti, dhe ky gardh nuk u çmpleks qoftë edhe pak.

Atë ditë që mbaroi projekti, para se të vinte drejtori e sekretari i partisë, Lamja thirri inxhinier Petron, për të parë ç'mendim kish ai pas punës së përbashkët, që kishin bërë. Samiu i qëndroi rëndë inxhinierit, nuk buzëqeshi si të tjerët kur ai tha: «Më duket se mori formë. Po, po, sikur ka marrë tamam formë». Inxhinieri qëndroi disa minuta para skicave e pastaj, iku, sikur të rrëshqiste diku papritur. Dikush ja dha gazit e buzëqeshi.

— U lëkund dhe inxhinieri — tha Diana dhe Esati në një kohë.

— Nursëzi — shqiptoi Samiu. — Nuk i qesh buza kurrë.— Dhe i erdhi inat që atë ditën e mbledhjes së madh ai rrinte pranë Dianës e vetëm asaj

i buzëqeshte herë pas here. Hodhi sytë nga ajo dhe ndjeu se inati iu shtua. Ajo dukej tepër e gëzuar, tepër e çiltër, bisedonte me Esatin dhe as që i hidhte sytë fare nga Samiu. Vendosi dhe ai të mos vështronte fare nga ana e saj, por për drejt sytë venin e mbërtheheshin te flokët e saj të gjatë, që i kish lidhur pas me një kordele ngjyrë qielli, te duart e saj, që me shkathtësi kapnin treguesin prej druri dhe e kalonin mbi projekt.

Fitorja ishte arritur. Kjo dukej nga shprehja, nga fjalët e drejtorit, të sekretarit, të të gjithëve, por entuziazmi i atyre të gjashtëve ra. Gjatë dy javëve që kishin punuar mbi projekt, ata i kish brejtur dëshira për të filluar sa më parë nga puna. Ndërsa drejtori u tha se deri në fund të muajit nuk do të merreshin me projektin sepse gjithë forcat duheshin vënë për realizmin e planit gjashtëmuor.

Por ata e gjetën rrugëdaljen.

KAPITULLI XII

Lajmi se në repartin mekanik u krijua brigada e të rinjve, që punonte për të marrë titullin «Brigadë e punës socialiste» u përhap në të gjithë uzinën. Në çdo dhomë të «Ndërtesave» flisnin për këtë ngjarje. Ishin pesëmbëdhjetë të rinj. Brigadierja ishte vajzë. Po njerëzit s'po i çudiste ky fakt: që brigadierja ishte vajzë. Ata i shqetësonte zotimi i tyre që edhe planin si gjashtëmuor ta plotësonin tri ditë para afatit, edhe maqinën ta përfundonin.

Të nesërmen radjua foli për këtë inisiativë. Kur e pyeti korespondenti i radios Dianën se ç'mendonte, ajo iu përgjegj se shokët s'do të kursenin asgjë dhe zotimin do ta vinin në jetë. Nuk i tregoi sa e gëzuar ishte, kujtoi se do të qe më mirë ta fshihte atë gëzim, po ai ishte tepër i madh dhe korespondenti i tha:

— Për ju kjo është një fitore, apo jo?

— Çfarë? — pyeti ajo. Sytë i qeshnin.

— Po... Një vajzë... Unë isha këtu kur shokët të propozuan. Të pashë si u hutove kur ata njëri pas tjetrit përsëritnin: «Dianën ta vëmë brigadiere.»

Diana dëgjonte korespondentin. Vërtet gjith-

shka ashtu kishte ndodhur. Por ajo donte t'i thoshte se fitorja kish filluar më parë, dy javë më parë, që kurse e kishin thirrur dhe i kishin thënë «dhe ti do të punosh për projektin» Fitorja ishte e lidhur dhe me mospërfilljen e Samiut. Kjo fitore i thoshte asaj se ajo dhe shoqet e saj mund të jepnin njëloj si djemtë.

Megjithëse nuk flisnin e ndruheshin se mos padashur mbeteshin vetëm, Diana e kish kuptuar se ai përpiqej të rrinte sa më tepër me të, gjithmonë i shoqëruar nga Jani e të tjerë. Diana s'dinte si ta spjegonte këtë sjellje të tij. Ç'është e vërteta, i pëlqente që po ndodhte kështu e i vinte mirë, njëkohësisht, që dinte ta mbante veten përpara tij dhe herë-herë e nevrrikoste me mospërfilljen e saj. Atë ditë që bëhej mbledhja, ajo me intuitën e saj e kuptoi se Samiu i hidhte vështrime të njëpasnjëshme e se po bëhej nervoz. Ndaj s'ja ndërpreu dërdëllitjen e inxhinierit. Por s'donte të pyeste veten përse i vinte mirë e kënaqej, kur Samiu, si i zënë në befasi, ulte qerpikët.

Dhe atë çast kur u ngritën shokët dhe thanë: «Samiu ka përgjegjësi për gjithë repartin, brigadiere të bëhet Diana», ai, sa ndeshi vështrimin e saj, i uli qerpikët, por fytyra i qeshi. Shokët thoshin «Dianën, Dianën». Asaj iu skuqën faqet. E kapi një emocion i fortë. E si mund t'ja thoshte të gjitha këto ajo korrespondentit të radio Tiranës? Megjithatë dikush kish hyrë në mendimet e saj, ndofta ai Jani, që për një orë të tërë se ç'i thosh korrespondentit. Ky në reportazhin që i dha radio-Tiranës shkroi edhe fitoren e Dianës.

Kishin mbetur vetëm dyzet e pesë ditë. Ky numër u shënuar ditën e parë në një tabelë të madhe dhe u vu ne hyrje të repartit. Dhe, ndërsa grafikët shkonin në ngjijtje, ky numër zbriste e ndonjëherë i bënte ata të brigadës të rrënqetheshin. Por përsëri e mblidhnin veten e mundoheshin të zhduknin edhe gjurmën më të vogël të dyshimit.

E kishin biseduar gjerë e gjatë çështjen, dhe kishin vendosur që njëzet e pesë ditë të gjithë do të punonin për realizimin e planit të prodhimit kurse njëzet ditët e tjera Samiu, Jani, Diana, Hekurani dhe Esati do të merreshin me maqinerinë. Pasi mbaronin punën hyrin ashtu të gjithë, siç ishin të lodhur po tërë humor në sallën e mensës. Kur kamerieri u vinte përpara gjellën e, ngrohtë dhe të shijshme dhe çdo ditë i pyeste në donin birra, Jani qeshte.

— Më fal, vëlla, më parë të kam sharë...

Kamerierit i bëhej qejfi, ndaj zinte e fliste me zë të ulët.

— E di që lodheni, prandaj jua ruaj. Ja kam mbushur mendjen dhe kuzhinierit. Tashti ai, pa e kujtuar unë, e heq mënjanë tavën më të mirë. — Dhe jo sikur ecte, por sikur fluturonte, kthehej në cast me duart plot.

— Po maqina si duket? — pyeste.

— E ke parë atë shifrën e madhe para repartit?

— përgjigjej Bardhi. — Patjetër e ke parë. Kur aty të shënohet numri njëzet, dije, vëlla, ky shoku, ky këtu, ai aty, kjo dhe ky bullafiqi, — ai tregonte me dorë Samiun, Hekuranin, Janin, Dianën e Esatin — ja këta do të punojnë për maqinerinë. I mbajtin mend? Ajkën jepun atyre, kanë nevojë për kalori.

Shokët qeshnin, qeshte dhe kamerieri me ta.

Dhe aty, duke ngrënë bukë e duke bërë shaka, vendosnin kush do të punonte pasdite. Por, po t'i vije re me kujdes, do të shihje se pothuaj që të gjithë kalonin disa orë pasdite në repart. S'kishin kërkuar kot të caktoheshin në një front pune të vështirë po, ku të punohej vetëm me një turn.

Çdo gjë po shkonte mbarë, me hap të shpejtë dhe këtë ecje nuk e pengonte dot as ndonjë sorollatje e Metit apo kokëfortësi e Demit. Ndaj dhe kur dikush i drejtohej Metit dhe i thoshte të linte fjalët e të shikonte punën, të tjerët nuk e zgjatnin këtë bisedë, por me gjysmë zë thoshin:

— Lëre dhe ti, Metin! Pse, me të do merremi tashti? E ku dëgjon ai. Të tijën që të tijën.

Hekurani shfrynte, thosh se ashtu si e kish nisur Meti ish rrezik ta përjashtonin nga brigada.

Po Esati fare ngadalë i thoshte Hekuranit.

— Unë edhe ti, kohën përpara e kemi! Këto ditë duhet t'i kemi nervat të qeta. Pa do t'i vijë radha dhe Metit.

Ashtu kaluan disa ditë.

* * *

Një pasdite Diana gjeti një zarf mbi komodinë. E hapi me rrëmbim, ashtu siç bënte sa herë merrte letër nga prindët.

«Punë të mbarë, bijë! Dëgjuam në radio për ty dhe zemra na u bë mal». Babai kishte shkruar një letër plot dhëmbshuri. Diana lexonte ato rreshta të ngjitura njëri pas tjetrit, hidhte sytë nga fotografia

e prindërve e i dukej se babai i përshpëriste: «Punë të mbarë, bijë» Ajo s'i hiqte sytë nga ajo fotografi: «Sa frikë kam! A do t'ja arrijmë?» Babai e shihte i qeshur, optimist. Sytë e tij përsëri thoshin: «Janë edhe 25 ditë, Dianë, e si s'do t'ja arrini?»

Diana hodhi vështrimin në krevatin pranë. Bukra kish hapur sytë e vështronte tavanin. Dukej e lodhur, pa gjallëri.

— Kam dëgjuar për një brigadë socialiste — tha Bukra kur e pa se mbaroi së lexuari — po ajo nuk vështronte vetëm punën... Ne i harruam të gjitha. Po lulishten, që e kishim nisur me aq qejf?

Diana ndjeu një turbullim. U ngrit menjëherë në këmbë, pastaj, sikur të kish gjetur një armë mbrojtëse, tha:

— Fundja ne s'kemi ndejtur kot... Kemi punuar...

— Dhe kjo do të thotë të heqim dorë nga çdo gjë?

Kur iu afrua grumbullit të vullnetarëve, Diana ndeshi vështrimin qortues të Lames:

— Mirë që erdhët ju të dyja — i tha ai. — Është e treta herë që reparti juaj mungon.

Diana u mundua të shfajësonte shokët, t'i thoshte se ata çdo ditë kishin punuar se kishin marë një angazhim dhe... Por Lamja ja la fjalën pa mbaruar.

— Mojtë vajzë! Po për veten tuaj, për njerëzit keni menduar? Ç'kuptim ka të punoni gati dy muaj ditë e natë e pastaj të sëmureni? Ju nuk e ndjeni që lodheni?

Diana mbushte lopatën dhe i dukej sikur lodhja me të vërtetë po e mundëte. Lodhja apo mendimet? Dyshoi se mos ajo ish fajtorë për të gjitha. Mos vallë s'dinte të organizonte? Iu kujtua se gjatë njëzet ditëve një herë kishin shkuar në kinema. Dhori nuk

kishte pranuar të shkonte në skuadrën e futbollit, Jani s'kish bashkëpunuar me redaksinë e fletërrufëve, Bukra nuk kishte shkuar në mbledhjen e komisionit të garave, ajo kish lënë volibollin.

Që atë mbrëmje, kur dielli perëndoi, Diana lajmëroi të mbledhej gjithë brigada përpara klubit.

Ajo foli e tha se brigada po rendte, po sikur po rendte symbyllurazi e nuk shihte asgjë rreth e rrotull. Në të vërtetë duhej të rendte gjithë jeta e tyre që dhe grafikët të ngriheshin dhe ata të përparonin.

Samiu u ngrit menjëherë pas Dianës. Ai nuk ishte krejt në një mendje me ato që thoshte Diana. Që i kishin lënë shumë gjëra pas dore, për këtë nuk kishin asnjë kundërshtim. Dhe ata duhej të bënin një hap prapa për të përmirësuar këtë gabim, por... Samiu s'pranonte që njerëzit të mos punonin pasdite apo në mbrëmje. Diskutuan gjatë rreth këtij problemi. Shumica mbronte Samiun e thoshte: — Deri sa kemi dëshirë, do të punojmë. Ne kemi punuar edhe herë tjetër, por sigurisht — thoshin ata, — kjo s'duhet të ndodhë çdo ditë. Këtu e kemi tepëruar. Kur është e nevojshme, kur s'mund të shkëputemi dot prej punës që kemi filluar, ne s'kemi për të parë orën.

KAPITULLI XIII

Lamja dhe xha Ristua hynë në kthinën që ishte caktuar për maqinën dhe panë Dianën të përkulur mbi disa hekurishte.

— Domethënë po filloni? — tha xha Ristua buzëzagaz. Dhe si i hodhi një vështrim asaj kthine, që kish vetëm një torno të vogël e ca hekurishte, tha se vend kish boll dhe dritë kish tepër. Pyeti se nga ishin zhdukur djemtë, por nuk arriti të dëgjonte përgjigjen e Dianës. Dera prej kompensate u përplas lehtë dhe u duk shpina e Janit. Ai së bashku me Esatin po tërhiqte një trup të vogël maqine.

— Domethënë do të filloni? — përsëriti xha Ristua.

Djemtë tundën kokën e buzëqeshën.

— E po punë e mbarë, djema, dhe na nxjerrshit faqebardhë.

Lamja e pyeti Dianën se si ishin me realizimin e planit. Dhe ajo nisi t'i tregonte shifrat e fundit. I tregoi vetëm shifrat sepse të tjerat Lamja i dinte, ai e dinte që po bëhej punë e mirë. Skarcitetet ishin më të rralla, punëtorët i rrinin mbi kokë njëri-tjetrit. Dhe Dhori s'thosh më «e po njerëz jemi, do bëjmë dy fjalë». Disa herë me radhë Lamja vetë kish qën-

druar me orë të tëra pranë maqinerive, ku punonin ata të brigadës, i ishte përveshur bashkë me ta punës. Një ditë, ishte aty pranë, kur Dhori, i inatosur, kishte lajmëruar Gimin, zëvendësbrigadierin, se nuk mund të punonte në atë proces, sepse i dilnin keq prerjet. Gimi e kishte vështruar rreptë e me inat, dhe e kish caktuar diku tjetër. Në vendin e tij kishte thirrur Nikun.

Por Niku nuk deshi të ndërronte punën.

— Pse? S'do të largohesh nga Lumja?

Niku ja ktheu se ai nuk vepronte mirë që ja bënte qejfin Dhorit, se në mbledhje kishin thënë jo të rendnin, por të ecnin të gjithë bashkë.

— Kurse ti po rend — ja kish prerë — Mësoje Dhorin që mos t'i dalin keq dhe mos zgjidh rrugën më të shkurtër.

Lamja pa rënë në sy të tyre, i kish dëgjuar të gjitha këto, e i kish thënë Dianës se i pëlqente që ata korrigjonin njëri-tjetrin.

— Veç Nikun s'po e korrigjojmë si duhet — u përgjegj ajo. — Për disa kohë thamë se bëri kthesë, por s'ka hequr dorë nga e tija. Është fanatik. Sikur rron me një frikë se Lumja kushedi ç'do të bëjë. Dhe ajo s'është shumë e vendosur. Mbjalti ca kohë qëndrimin e duhur po pastaj përsëri të parën, veç mos ti prishet qejfi atij. Punë e ngatërruar kjo, — tha Diana. — Dhe nevrikoset kur ne përzihemi në këtë çështje. Një ditë bëri fjalë me Bukrën. I tha se nuk i pëlqente që ajo kërkonte t'i jepte mendtë e saj Lumes. Le t'i mbante për vete. Bukra as që u bë merak për fjalët e Nikut dhe i tha se askush nuk mund ta ndalonte të shfaqte mendimet e saj

hapur, aq më pak fanatikët. Kjo ishte një e drejtë e saj. Kush të donte le të dëgjonte, kush nuk donte le të mbyllte veshët. Kur erdhi Bukra në dhomë, na e tregoi këtë bisedë «të përzemërt», siç tha ajo, e pastaj iu drejtua Lumes «Shiko, — i tha. — Mua s'më intereson se ç'thotë ai. Po ti duhet të na dëgjosh ne. E kupton? Se je një ti, menjëherë infektoshesh. Ai me atë kokë që ka, kërkon të të bëjë shqerrë. Po a mund të ketë vajza shqerra sot? E mban mend si folën atë ditë në radio luftëtarët e së resë?»
! fola edhe unë Lumes, por ajo mblidhte supet.

Niku, që nga vendi ku punonte, e shihte Lumen që bisedonte me Dianën por as që i shkonte mendja se flisnin për të. Fjalët që i tha Gimi i rëndonin akoma. I vinte inat që shokët një e dy dhe ja përmendnin Lumen. «Kushedi se çfarë po bëj» mendonte.

Kur ra çanga, që lajmëronte pushimin e mën-gjezit, ai s'po shkëputej nga tornua. Priste të dilte Gimi i pari. S'i pëlqente ta kishte pas e të vinte buzën në gaz kur të shihte Lumen që e priste te dera e repartit. Por Gimi s'po lëvizte. Ishte tepër i përqëndruar në detalin që pregatiste. Niku hodhi dhe një vështrim nga ana e tij dhe iku me hap të shpejtë.

— E ç'më pret? — i shfryu Lumes. — Pse s'shkon me të tjerët — Lumja e vështroi e hutuar.

— Po ti vetë më ke thënë të të pres.

Ai e shikoi me inat.

— Ç'bërtet? Të të dëgjojnë njerëzit? Sikur s'di të flasësh ngadalë.

Ajo s'po e kuptonte përse ishte nevrikosur Niku.

— As unë nuk e di se ç'do ti, Niku, — i tha e mërzitur.

Ai s'foli. Ktheu kokën nga pas dhe i erdhi mirë që Gimi s'kish dalë nga reparti.

— Shko, shko me shokët — i tha. — Se më vër-sulen mua njerëzit pastaj. Ti kështu e ti ashtu.

— Po dhe mua më pëlqen të hamë bashkë. E ti mos u bëj merak se ç'thonë njerëzit kur nuk ke faj — tha ajo me një farë gëzimi.

Nikut i pëlqeu përgjegjja e Lumes, por nuk e shprehu këtë. Shkoi pranë Bukrës e Janit, që qeshnin me zë të lartë.

* * *

Kështu rridhnin ditët. Megjithëse Diana kish bërë autokritikë, përsëri e shihte se pak kohë i mbetej për t'u kujdesuar për veten. Vërtet në volej-boll e aktivitete të tjera vazhdonte të shkonte, por çdo mëngjez, tek vishte bluzën prej doku, qortonte veten që gjithmonë harronte të nxirrte e të rregullonte rrobat e verës. Dhe letra e prindërve kish mbetur pa përgjegje. Ç'ishte më e çuditshmja, ajo, sa shtrihej në krevatë ndjehej e këputur e s'kup-tonte se si brenda pak minutave gjumi ja mbër-thente sytë. Kjo nuk i kish ndodhur asnjëherë. Më parë gjumi mezi e zinte kurse tashti. . . «Ka të drejtë Lamja kur na qorton» mendoi. Por nuk e linte merakun, i dukej se kishte një barrë të rëndë mbi shpinë, e du-heshin bërë përpjekje të mëdha për ta çuar deri në vend. Çdo mëngjez sa shihte maqinën, seç ndje-nte në kraharor. Esati buzëqeshte e i thoshte:

— Janë dhe kaq ditë akoma, shoqja brigadiere, është shpejt për t'u emocionuar.

Ajo ndjente një drithërimë që ja përshkonte trupin e nuk e kuptonte përse ditët ecnin aq shpejt, ndaj dhe i lëvizte duart me shkathtësi pranë maqinorisë. Ajo, Samiu dhe Jani merreshin me montimin e saj, kurse Esati dhe Hekurani me përgatitjen e detaleve. Punonin e më të rrallë flisnin. Më tepër fliste Jani, ata të dy dëgjonin. Dhe kur thoshin ndonjë fjalë, përherë do t'i drejtoheshin Janit. Edhe kur Diana s'e kishte të kuartë atë që shpjegonte Samiu, prapë i drejtohej Janit.

— E pse jo kështu? — pyeste sikur përgjigjen e priste nga Jani.

Por Jani ishte mësuar me këto skena, ndaj e shtynte Samiun për bërryli.

Dhe vinin buzën në gaz të tre.

— E di çfarë? — i tha një ditë Jani Samiut. — Ju bëni si dy fëmijë të zemëruar, që duan të flasin, por tregohen kapriçiozë. Luajnë bashkë por emrin s'ja thonë njëri-tjetrit.

Samiu vuri buzën në gaz. Kish vënë re se sa herë thoshte ai diçka për të qeshur, gajaste dhe Diana bashkë me të tjerët, sa herë që ai shfaqte ndonjë mendim, ajo, duke iu drejtuar Janit, e kundërshtonte ose e aprovonte. Veçse kur ndeshte në vështrimin e tij, nuk e bënte fare veten.

Samiu i kujtohej shpesh ajo ditë e largët kur ajo sa po kishte parë Samiun, fare pa druajtje kish thënë: «Ne s'do të japim shfaqje estrade!» Atë çast mezi e kishte mbajtur veten dhe kishte menduar keq për Dianën. Por djersët që i rridhnin, qëndrimi plot emocion, dyshimi, frika, shpresat, që shfaqeshin e zhdukeshin në fytyrën e Dianës ja hoqën mendimin e keq. Përpara kish një vajze të mrekullueshme, që kishte dërsitur tamam si ai, kur kish bërë

racionalizimin e parë. Dhe... ai s'donte ta besonte, por i ishte dukur tamam sikur ajo i kish vjedhur mendimin. A vidhet mendimi? Sa ishte bërë ai gati të hapte gojën, ajo para tij e kish gjetur difektin e pajisjes. Dhe në atë çast Samiu i haroi fare fjalët e ashpra që kish thënë ajo para se të fillonte prova. Përpara syve kishte një Dianë tjetër. Në të vërtetë, i pëlqente që ajo ishte kështu. I pëlqenin vështrimet e saj herë të akullta herë femënorë, pyetjet që i drejtonte Janit me naivitet. Të gjitha këto i jepnin më tepër shije gjithshkaje edhe punës, dhe Dianës, dhe mendimeve të tij.

Po Diana, megjithëse e kuptonte që sjellja e tyre ishte pak qesharake, përsëri vazhdonte të sillej ashtu. I dukej se në këtë mënyrë i tregonte Samiut se kush ishte ajo dhe i ngacmonte nervat që dikur i ishin dukur aq të qeta. Ndjente kënaqësi tek e shihte atë të vrehet nga qëndrimi i saj mospërfillës.

Një ditë, kur kishin mbetur vetëm në repart, ata s'lëvizën nga vendi ku punonin, s'këmbyen asnjë fjalë, rrinin si dy të zemëruar, që s'donin të dinin për njëri-tjetrin, por zemra u rrihte fort. Dhe t'i shihje si u ndryshuan fytyrat kur erdhi Esati e u tha se dy shokëve nga brigada u kish ardhur fletë-thirrja për në zbor.

S'dinin ç'të thoshin.

Kishin mbetur vetëm tetë ditë. Ajo i nguli sytë Samiut, sikur të kërkonte prej tij një mendim, por kur Esati tha: — Duhet bërë diçka që ata të mos shkojnë, — ajo u përgjegj prerë:

— Ata do të shkojnë.

Ju duk se dhe Samiu këtë mendim kishte.

— Por ka rrezik — tha Esati.

Ne mbetemi trembëdhjetë — tha Diana. — Do t'ja dalim.

I erdhi keq veç kur mori vesh se një nga ata të dy ishte Hekurani. Gjatë atyre ditëve ajo kishte parë me ç'mprehtësi i kapte ai mendimet e Samiut dhe s'donte të kujtonte se ca kohë më parë e kish përbuzur atë njeri. Hekurani ato ditë punonte për ngritjen e elektromotorit, të cilin e kish marrë nga një maqinë e prishur dhe do ta adaptonin për maqinën e tyre. Duhej punuar aksi; duheshin gjetur e duheshin vënë kushinetat. Po ja Hekurani do të largohej, dikush tjetër do të merrej me këtë punë.

Do të largohej edhe Niku.

Hekurani tha se do të punonte tërë natën, do të mundohej të përfundonte aksin e elektromotorit, ndërsa kushinetat t'i siguronin shokët e t'i montonin.

Diana nuk e kundërshtoi.

— Sigurisht, jo gjithë natën — i tha. — Do të punojmë edhe ne disa orë dhe ti të bësh sa të bësh. — Ajo vuri re se edhe Samiu ishte i shqetësuar.

— Ku është Jani? — thërriti ai i nevrikosur — Iku dhe u zhduk.

— Uh, veç mos bërtitni, sikur na u lidhën fare duart kështu — tha Diana e vazhdoi të punonte duke u munduar të fshihte emocionin që e kish pushuar.

* * *

Atë pasdite, që Hekurani dhe Niku u kthyen nga zbori, në tabelë ishte shënuar shifra 4. Ata hynë me një frymë në repart. Në oborrin e «Ndërtesave»

kishin dëgjuar një thashetheme, që i kishte tron-
ditur, gjoja sikur maqina nuk punonte. «Ju vajti
mundimi kot» u kishin thënë. Dhe ata të dy me një
frymë mbërritën në repart.

Te dera takuan Janin që pinte një cigare.

Ai u tha se nuk punonte elektromotori.

Hekurani u zverdh. Hyri si rrufe në kthinën, ku
punonin shokët e plot dyshim pyeti se çfarë kishte
ndodhur.

Shokët e përsëritën dhe një herë lajmin që u
kishte dhënë Jani.

— Mos e ka fajin aksi? — pyeti ai me zë të
dredhur.

— Jo — tha Samiu. — Asnjë nga ne s'ka faj.
Mbështjellimi s'ka qenë i mirë. Duhet bërë mbësh-
tjellimi i ri. Po ku? Në Tiranë apo në Durrës.

— E kini fajin vetë, foli Esati.

— T'i kishim vënë një motor të ri.

— E kush nuk e dinte këtë, mor Esat? Por ne
kishim vendosur që maqinën ta ngrinim me forcat
tona. Dhe elektromotorin do ta merrnim nga ata jashtë
përdorimit e do ta sillnim në vete. Po ja që mbësh-
tjellimi s'është në rregull. Duhet ta kishim men-
duar edhe këtë — tha Samiu.

— E si ta kishim menduar? — i tha Diana Janit.

— Ta parashikonim; mund të na ndodhte një
gjë e tillë — vazhdoi Samiu.

— Dhe pastaj? — pyeti përsëri ajo po me atë
nervozizëm.

— Të mos alarmoheshim si tashti.

— Dhe kot alarmoheni — tha Lamja, që nuk
kish shkuar fare në shtëpi. — Po zien tërë «Ndër-

tesa»; «Maqina nuk punon» E kush tha se s'do të punojë.

Jani tha se inxhinieri ishte i mendimit t'i vinit elektromotor të ri. Të shfrytëzohej një nga ata që ishin për maqineritë e reparatit që po ngrihej.

— Unë s'jam dakord me të — tha Lamja. — Maqinën po e ngrini me forcat tuaja; apo jo?

— Ashtu i thashë dhe unë — ja ndërpreu fjalën Jani.

— Prandaj duhen menduar mundësitë, të gjitha mundësitë. Ju bëni një provë, pastaj ata të Durrësit do të na kuptojnë patjetër e brenda një dite do të na mbarojnë punë.

Pas kësaj u duk sikur të gjithë i mbaruan fjalët. Samiu për orë të tëra nuk e hapi gojën. Hekurani i kish vretur vetullat, sikur gjithë fatkeqësia të kishte rënë mbi të. Vetëm Esati sa s'pëlçiste nga kjo heshtje e rëndë.

— Kur s'i thamë dhe Bardhit të vinte — foli ai. — S'do të shihja vetëm mumje këtu. Ç'keni, more? Na e ngritë gjakun fare. Ja, të shihni, çdo gjë do të rregullohet.

Askush s'iu përgjegj. Diana shkante sa andej këndeje, thujse e kish humbur fare. Pastaj qëndroi pranë Janit. Samiut i erdhi keq tek e pa aq të hutuar. Aty nga ora dymbëdhjetë e natës ajo iu duk tepër e lodhur. Sytë thujse me zor i mbante hapur. Dhe ai për herë të parë, gjatë gjithë kohës që kish qëndruar bashkë, iu drejtua asaj me zemër të hapur e i tha ta përcillte për në «Ndërtesa». Ata do të rrinin edhe ndonjë orë të punonin.

— Jo, Sami, — kundërshtoi ajo. — Do të ikim bashkë të gjithë.

Dhe sa herë ndjente se i vinte gjumi, ngrinte sytë, e frikësuar se mos e kishin pikasur.

Nga ora një e lanë punën. Doli e kjarhtë se dikush duhej të nisej për Durrës. Dhe askush s'foli për lodhjen, po mundoheshin të bindnin njëri-tjetrin se dhe katër orë gjumë ishin të mjaftueshme për njeriun. Jani tha se këtë e vërtetonte dhe mjekësia.

E përcollën Dianën deri te dera e dhomës. Pritën sa të hapej dera. Bukra që nga brenda shfrynte tërë inat:

— Ti je e çmendur — i tha Dianës, që rrëmbeu gotën me kompostë dhe e ktheu njëherësh. — Të gjithë jeni të çmendur! Të shihni po s'ju vura një fletë-rrufe të madhe. Nuk e kuptoj, mos jeni në gara çiklizmi? S'mund t'ju mjaftojnë katër ditë?

Diana ishte aq e hutuar sa që s'mund t'i përgjigjej në do t'u mjaftonin ose jo.

— Ti e more vesh, apo jo, që nuk punon elektromotori? — i tha. — Në vënd që të vije e të rrijë me ne!.. Dhe Janitë i mbeti goja: «Po kjo Bukra s'u duk fare».

Bukra nuk ja zgjati. U kthye nga muri e mbylli sytë.

* * *

Pranë maqinës që po ngrihej ishin mbledhur ata të brigadës. Aty ishte edhe xha Ristua. Ai thithte cigaren dhe seç i thoshte Samiut. Ky heshtëte.

— Po ti mos u bëj merak, — i tha më së fundi xha Ristua pak i prekur. — Jam marrë me këto punë, edhe pompën e vajit të sistemit hidraulik e kam kaluar nëpër duar. Prandaj, shko, i qetë. Punoj unë me Janin.

— Falemnderit, xha Risto. — tha Samiu disi i lehtësuar e doli nga hyrja e ngushtë, ku një e dy e përplasej dera prej kompesate. Pas tij doli edhe Hekurani me Esatin, që binin elektromotorin. E vendosën atë në automjetin që priste në oborr.

Kur automjeti humbi në anën tjetër të kodrës, Diana u kthye në repart. I dukej sikur kishte përcjellë një të sëmurë për në spital.

Mezi prisnin të vinte e nesërmja. Ishte në të ngrysur kur u dëgjua boria e automjetit, që silte elektromotorin, ora kishte kaluar nga shtata. Samiu u tregoi se si shokët e Durrësit e kishin ndihmuar menjëherë. «Por çfarë t'i bësh rrugës — tha ai — tërë kjo rrugë. Ajo dhe na vonoi».

Ai donte të fillonte menjëherë nga montimi i elektromotorit, por shokët i thanë se e kishin tepëruar fare kohët e fundit. Kur të vinte mëngjezi, do ta montonin. Ata u larguan si pa dëshirë nga oborri i madh, nga zhurmat metalike që shpërndanin dritaret e hapura.

Në «Ndërtesa» nuk dëshironin të ktheheshin, sepse u dukej se ajo do të ishte nata më e gjatë e jetës së tyre. Esatit i shkrepëi të zbritnin poshtë bregut të lumit. Bukra tha se Esati kish idera të mreku llueshme, kurse Samiu, duke psherëtitur, u tregoi shokëve se kish më se tri javë që nuk kishte shkuar në kinema. Diana preku rrjetën e volejbolit, pranë të cilës po ecnin e u propozoi të luanin, por Bukra kishte marrë tatëpjetën përmes kaçubave që gjelbëronin. Aty, në një vend pak të ngritur, ku dukej dhe rrëkeja që zbriste me bujë nga kodra, u ulën të gjithë e filluan të këndonin e të tregonin historira.

Të nesërmen kur shkuan në repart, e ndjenin veten më të çlodhur. Samiu i buzëqeshi Dianës. Asaj i shkëlqenin sytë. Natën e kaluar disa herë me radhë atyre u ishin takuar vështrimet. Diana kishte vënë në buzën në gaz. Kishte buzëqeshur dhe Samiu. Në ato çaste Diana kishte menduar se askush tjetër më shumë se ajo nuk e kishte pritur aq me padurim borinë e maqinës që pruri Samiu dhe elektromotorin. Kishte vështruar përsëri nga ai dhe i ishte dukur tepër i dashur tek rrinte ashtu shtrirë në bar e diç i tregon-te Janit tërë gaz. Pastaj ishin ngritur. Samiu kishte qëndruar pranë saj. Këtë herë ai iu duk më i sigurtë në vetëvete, më i sigurtë në atë që thoshte. Dianës një zë i fortë sikur i foli: «Mos u pezmato...» Ajo vështroi nga Samiu me një farë indiferentizmi të shtirur; ai i buzëqeshi përsëri. Atë buzëqeshje nuk mund ta harronte Diana. Ajo i dilte parasysh deri sa gjumi ja mbërtheu qepallat.

— A do të gëzojmë? — pyeti ajo tani, për t'iu përgjigjur vështrimit të hareshëm të Samiut.

— Çdo gjë në rregull, Dianë, — foli Jani për Samiun. Kur të vij në shokët, do të bëjnë provën.

Ajo e kuptoi se ata do të kishin ardhur në repart që pa zbardhur.

— Mirë që ju ia xha Abazi — u tha. Ishte tepër e hutuar. Vetëm kur erdhën shokët dhe presa e preu për mrekulli metalin, ajo u lëshua në stolin pranë dhe e ndjeu veten të lumtur. Sytë i shkëlqenin. zemra filloi t'i rrihte fort.

Jani buzëqeshi. Takoi elektromotorin e prerja u bë një herë, pesë, shtatë, njëzet herë.

— Tashti dy ditë je e dënuar të mbyllesh në dhomë e të flesh — i tha Bukra Dianës. — Por më parë duhet të shënosh në grafik shifrën 100%.

Ato dolën nga reparti e qëndruan pranë tabelës, ku ishte shënuar shifra 2. I shtrënguan duart fort njëra tjetrës e buzëqeshën të lumtura.

* * *

Korrespondenti i radio-Tiranës, sikur të kish fluturuar me helikopter, u duk për gjysmë ore.

— Sikur ta dija — tha. — Ju lumtë, djema!

— Dhe vajza, — e korrigjoi Jani. — Kemi dhe katër vajza në brigadë.



Korrespondenti vuri buzën në gaz. Iu afrua Dianës dhe e pyeti për diçka. Ajo iu përgjegj aty për aty. Ai përsëri e pyeti. Kur Diana po bëhej gati t'i pëgjigjej, sytë i vajtën te Samiu.

— E dini? — tha — ai shoku, ja ai aty, shfaq i pari idenë për këtë maqineri. Ju duhet të bisedoni me të, patjetër.

Një lumë përshëndetjesh, përgëzimesh. Erdhën dhe ata të repartit të montimit. Diana ndjehej e lumtur. Sytë i vajtën përsëri te Samiu, të cilit mezi ja nxirrte fjalët korrespondenti i radio-Tiranës. Hekurani i zgjati dorën. Ajo buzëqehi e gëzuar. Kish ditë më të madhe se kjo? Fitorja ishte arritur. Çdo gjë ishte në vendin e vet.

Grchi një vajzë

novelë



Çmimi lekë 2,50

2